



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 186

Tiranë – E premte 22 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 729, datë 13.12.2023

Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave
të Krimit 2024–2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së
treguesve.....

Faqe

22201

VENDIM**Nr. 729, datë 13.12.2023****PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E
VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024–2030, TË
PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT DHE TË
PASAPORTËS SË TREGUESVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, të

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT
2024–2030****Tiranë, nëntor 2023****Z. ULSI MANJA**

Ministër i Drejtësisë

Të nderuar bashkëpunorë, kolegë dhe miq,

Në dy dekadat e fundit, veçanërisht në kuadër të Reformës në Drejtësi, pozita e viktimës në procesin penal ka njohur përmirësime, falë përmirësimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor, krijimit dhe përpjekjeve të konsolidimit të strukturave përgjegjëse që punojnë me dhe për viktimat, rritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve të profesionistëve dhe krijimin e aksesit në drejtësi për çdo viktимë.

Pas hapjes së negociatave për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, një nga detyrimet që duhet përbushur është përafrimi i legjislacionit vendas për viktimat me standardet e BE-së dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë.

Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, si dhe dokumentat e saj strategjik u hartuan përmes një procesi planifikimi duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të ekzekutivit në nivel vendor dhe qendror, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtarë, veprimtaria e të cilëve lidhet me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent.

Ministria e Drejtësisë garanton vijimin e frymës gjithëpërfshirëse edhe në hapat në vijim me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional në kuadër të zbatimit të mekanizmave mbrojtës dhe rehabilitues të viktimave të krimit.

Mirënjohje për të gjithë përfaqësuesit e institucioneve, Organizatave të Shoqërisë Civile, Akademikët, si dhe të gjithë aktorët e fushës, të cilët me sugjerimet dhe opinionet e tyre ishin pjesë aktive në procesin e hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030.

Falënderim i veçantë për Projektin JustAL (Asistenca Teknike e Bashkimit Evropian ofruar Ministrisë së Drejtësisë), zyrës së UNICEF Shqipëri, Prezencës së OSCE në Shqipëri, Sekretariatit Teknik pranë Ministrisë së Drejtësisë, të cilët mbështetën hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Planin e Veprimit 2024–2030.

planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në strategji, në planin e veprimit dhe në pasaportën e treguesve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

**Shkurtime**

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCK	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
QKEDH	Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaramit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHASH	Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
GREVIO	Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GRETA	Grupi i Ekspertëve mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IAL	Institucione të arsimit të lartë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
INSTAT	Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KIE	Këshilli i Evropës
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MEVPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
M&V	Monitorim dhe vlerësim
NJVV	Njësitë e vetëqeverisjes vendore
OJF	Organizata jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
OZHQ	Objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKIE	Plani Kombëtar të Integrimit Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
PMF	Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë
RSH	Republika e Shqipërisë



RTSH	Radiotelevizioni Shqiptar
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
STHCH	Save the Children
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TDH	Terre des Homes
UEM	Urdhri Evropian i Mbrojtjes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Tabela e përmbajtjes

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik
2. Kuadri ligjor, institucional dhe lidhja me dokumentet strategjike të tjera
3. Arritjet, analiza dhe sfidat
4. Parimet themelore
5. Vizioni dhe misioni i dokumentit

PJESA II. QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PARËSORE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024–2030

1. Qëllimet e politikës së SNMVK 2024–2030

PJESA III. PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, KOORDINIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

1. Përgjegjësia e institucioneve
2. Llogaridhënia dhe koordinimi
3. Monitorimi dhe raportimi
4. Vlerësimi

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

ANEKS I. MATRICA E MASAVE DHE AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024–2030

PJESA I KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Shqipëria ka ratifikuar pothuajse të gjitha aktet

ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës që përcaktojnë standardet e trajtimit, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimit, duke i bërë ato pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm.

Një nga detyrimet që duhet të përmbushet është përafrimi i legjislacionit vendës për viktimat me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, detyrim i cili rrjedh edhe nga procesi i integritetit të Shqipërisë në BE.

Në kuadër të këtij procesi, duke qenë se nënkapitulli i mbrojtjes së të drejtave themelore është pjesë e kapitullit 23 të *acquis*, për të cilin Ministria e Drejtësisë (MD) është institucion lider, një ndër çështjet është edhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtat dhe mbrojtja e viktimave të krimit. Pas analizës së kryer në kuadër të përgatitjes së prezantimeve përpara Komisionit Evropian, nëntor 2022, është konkluduar nevoja për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit (SNMVK).

Në këtë kontekst, për herë të parë MD-ja hartoi Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit si një dokument politik i shoqëruar me planin e veprimit për periudhën afatgjatë 2024–2030 dhe pasaportën e treguesve, e cila do të jetë në përputhje me strategjinë e BE-së “Për të drejtat e viktimave 2020–2025”, si dhe aktet lidhur me *acquis* e BE-së për mbrojtjen e viktimave të krimit.¹

¹ - Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe që zëvendëson vendimin kuadër të Këshillit 2001/220/JHA;

- Direktiva e Këshillit 2004/80/KE e 29 prillit 2004 lidhur me kompensimin e viktimave të krimit;

- Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale;

- Rregullorja 2013/606/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 qershor 2013 për njohjen reciproke të masave mbrojtëse në çështjet civile.

- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 për vendosjen e standardeve



MD-ja, bazuar në kuadrin ligjor vendës dhe ndërkombëtar që rregullon fushën e të drejtave të viktimave të krimit, vlerëson se të drejtat e viktimave të krimit duhet të zbatohen fillimisht në të drejtën penale, civile, procedurale, kur ka raste edhe në atë administrative.

Ndaj SNMVK 2024–2030, përfshin masa e veprime që synojnë fuqizimin e pozitës së viktimave të krimit në sistemin e drejtësisë penale, nëpërmjet angazhimit institucional në mënyrë që viktimat të informohen për të drejtat e tyre, të mund të raportojnë krimin, të marrin pjesë dhe të dëgjohen në procedurat penale, të kenë qasje pa diskriminim në sistemin e drejtësisë penale, të garantohet qasje të shërbimet për viktimat, t'u garantohet e drejta e kompensimit të dëmit nga autori dhe/ose shteti në procesin penal dhe mes procesit civil, bazuar në nevojat për mbrojtje specifike, të marrin shërbimet e nevojshme me qëllim rehabilitimin e tyre. Parandalimi i riviktimizimit dhe viktimizimi dytësor i viktimave është një nga synimet e kësaj strategjie.

Ndër të tjera, dokumenti strategjik ka në fokusin e saj edhe koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në kuadër të zbatimit të mekanizmave mbrojtës dhe rehabilitues të viktimave të krimit, krijimi i mjediseve të sigurta për viktimat, duke mbajtur në konsideratë sidomos grupet vulnerabël dhe komunitetet e marginalizuara, të cilët kanë mundësi të kufizuar të aksesit në drejtësi.

Nëpërmjet këtij dokumenti politikash do të synohet shkëmbimi i praktikave më të mira ndërmjet shteteve anëtare të BE-së për mbështetjen dhe

mbrojtjen e viktimave, vendosja e urave të bashkëpunimit dhe sigurimi i një qasjeje të koordinuar për të drejtat e viktimave ndërmjet autoriteteve ligjzbatuese, kujdesit shëndetësor dhe punonjësve socialë dhe organizatave të shoqërisë civile për të ofruar mbështetje të synuar dhe të integruar për viktimat.

Gjithashtu, vëmendje të shtuar në këtë dokument strategjik i është dhënë perspektivës gjinore (orientimit të qasjes gjinore, në mbrojtje të viktimave të krimit), e cila është integruar në hartimin dhe zbatimin e strategjisë me synim dhënien fund të gjitha formave të viktimizimit ndaj grave dhe vajzave kudo.

Duke qenë se është një dokument i hartuar për herë të parë, puna për hartimin e kësaj strategjie është mbështetur kryesisht në analizën e gjendjes aktuale të viktimave të krimit në Shqipëri (maj 2023), si dhe në gjetjet dhe rekomandimet e monitorimit të strategjive dhe planeve të veprimit, të ministrive të linjës, që adresojnë aspekte të të drejtave të viktimave të krimit.

Në hartimin e SNMVK 2024–2030 janë mbajtur parasysh gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian të dërguara nëpërmjet “Progresraportit për Shqipërinë 2022”, rekomandimet e mekanizmave monitorues të konventave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Këshillit të Evropës (KE) ku shteti shqiptar është palë, veçanërisht të GREVIO-s,² GRETA-s,³ CPT,⁴ direktivat e BE-së për mbrojtjen e viktimave, si dhe rekomandimet e partnerëve vendës dhe ndërkombëtarë që punojnë me dhe për viktimat.

minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe që zëvendëson vendimin kuadër të Këshillit 2001/220/JHA;

- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, e datës 5 prill 2011 “Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij dhe zëvendësimin”, vendimi kornizë i Këshillit 2002/629/JHA;

- Direktiva e 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 13 dhjetorit 2011 në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve;

- Direktiva (EU) 2017/541 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 15 mars 2017 Për luftimin e terrorizmit dhe zëvendësimit të vendimit kornizë 2002/475/JHA dhe ndryshimin e 2005/671/JHA;

- Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale.

Faqe | 22204

² Për më shumë shih: GREVIO's (Baseline) Evaluation Report on legislative and other measures giving effect to the provisions of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention) ALBANIA <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>; <https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/category/rekomandime-raporte-te-cedaw-grevio-dhe-upr-per-shqiperine/> <https://rm.coe.int/168046246b>

³ Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings, Evaluation Report, GRETA, 2020. Shih: <https://rm.coe.int/greta-2020-09-fgr-alb-en/1680a0b84f>. Recommendation CP/Rec(2020)06 on the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Albania. Shih: <https://rm.coe.int/cp-rec-2020-06-alb-en/1680a09acc>.

⁴ <https://www.coe.int/en/web/cpt/albania>



SNMVK 2024–2030 lidhet me Programin e Qeverisë 2021–2025, kryesisht me prioritetin “Shqipëria e së drejtës”⁵, si dhe me *Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE 2023–2030)* dhe një sërë strategjish të tjera që adresojnë të drejtat e viktimave të krimit: *Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë 2021–2025 (SND 2021–2025)*, *Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 (SKKOKR 2021–2025)* dhe *Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023*, *Strategjia Kombëtare për Barazji Gjinore 2021–2030 (SKBGJ 2021–2030)*, *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 (SKA 2021–2026)*, *Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2020–2025*; *Plani Kombëtar i Veprimit për Barazji, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025* etj. Strategjia mban parasysh orientimin dhe përmbushjen e *Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 (OZHQ)*⁶ dhe *Agjendën 2030*⁷.

Përgatitja e SNMVK 2024–2030 është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2023 dhe është në përmbushje me angazhimet e marra në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024⁸ (PKIE 2023–2025), kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, konkretisht 23.7 ku si prioritete janë: ndërmarrja e masave konkrete për përafrimin e legjislacionit të brendshëm në mënyrë të plotë me *acquis* e BE-së në të gjithë legjislacionin që prek viktimat e krimit, trajnimi i profesionistëve që punojnë me viktimat, me qëllim zbulimin e krimit dhe trajtimin e tij në mënyrën e duhur, duke iu përshtatur nevojave specifike të viktimave, fuqizimin e pozitës së viktimave të krimit në sistemin e drejtësisë penale, garantimi i barazisë gjinore dhe siguri i shërbimeve minimale sociale dhe shëndetësore, krijimin e një skeme kompensimi për viktimat e veprave penale të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila garanton kompensim të drejtë dhe të përshtatshëm ndaj viktimave, forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të siguruar aksesin e viktimave në drejtësi, si dhe është në linjë me *Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe*

Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare (MSA), neni 2 “Respektimi për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut” dhe neni 78 “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”.

2. Kuadri ligjor, institucional dhe lidhja me dokumentet strategjike të tjera

2.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Kuadri ligjor që adreson të drejtat dhe mbrojtjen e viktimave të veprave penale është i gjerë dhe përfshin ligje penale dhe jopenale. SNMVK 2024–2030 është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, dhe me konventat ndërkombëtare, si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e RSH-së”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8985, datë 23.12.2002, “Për ratifikimin e Marrëveshjes evropiane për personat pjesëmarrës në procedurat para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”;
- Ligji nr. 8705, datë 1.12.2000, “Për ratifikimin e Marrëveshjes evropiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore”;
- Ligji nr. 8882, datë 18.4.2002, “Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Marrëveshjes Evropiane për transmetimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore dhe të raportit shpjegues”;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, së bashku me protokollin shtesë;
- Ligji nr. 7510, datë 8.8.1991, “Për aderimin e RSH-së në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”;
- Ligji nr. 9725, datë 7.5.2007, “Për aderimin e RSH-së në protokollin shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”;
- Ligji nr. 9726, datë 7.5.2007, “Për aderimin e RSH-së në protokollin e dytë shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”;
- Ligji nr. 7727, datë 30.6.1993, “Për aderimin e RSH-së në Konventën kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues”;
- Ligji nr. 9094, datë 3.7.2003, “Për ratifikimin e

⁵ Faqe 36 e Programi Qeverisë 2021–2025

⁶ <https://sdgs.un.org/goals>.

⁷ <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>.

⁸ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/02/09/91>



Protokollit opsional të Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues”;

- Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, “Për ratifikimin e konventës ‘Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas’” (CEDAW);

- Ligji nr. 10 373, datë 10.2.2011, “Për një shtesë në ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 ‘Për aderimin në konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave’”;

- Ligji nr. 9052, datë 17.4.2003, “Për aderimin e RSH-së në protokollin shtesë të “Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas”;

- Ligji nr. 104/2012, datë 8.11.2012, “Për ratifikimin e konventës të Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’”;

- Ligji nr. 10 071, datë 9.2.2009, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”;

- Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007, “Për aderimin e RSH-së në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së ‘Për të drejtat e fëmijëve’, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë”;

- Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e konventës për të drejtat e fëmijës”;

- Ligji nr. 8624, datë 15.6.2000, “Për aderimin në ‘Konventën e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit’”;

- Ligji nr. 9359, datë 24.3.2005, “Për ratifikimin e ‘Konventës Evropiane për marrëdhëniet me fëmijët’”;

- Ligji nr. 10425, datë 2.6.2011, “Për ratifikimin e ‘Konventës të Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve’”;

- Ligji nr. 10398, datë 17.3.2011, “Konventa për njohjen dhe zbatimin e detyrimeve ushqimore”;

- Ligji nr. 10 424, datë 2.6.2011, “Për ratifikimin e Konventës për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesës”;

- Ligji nr. 9446, datë 24.11.2005, “Për aderimin e RSH-së në konventën ‘Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës’”;

- Ligji nr. 9443, datë 16.11.2005, “Për aderimin e RSH-së në konventën ‘Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve’”;

- Ligji nr. 86/2013, “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës ‘Për procedurën e komunikimit’”;

- Ligji nr. 10 426, datë 2.6.2011, “Për ratifikimin e protokollit të tretë shtesë të konventës evropiane ‘Për ekstradimin’”;

- Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012, “Për ratifikimin e Konventës së OKB -së ‘Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara’”;

- Ligji nr. 9265, datë 29.7.2004, “Për ratifikimin e ‘Konventës Evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme’”;

- Ligji nr. 8497, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për transferimin e procedimeve në çështjet penale’”;

- Ligji nr. 8499, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për transferimin e personave të dënuar’”;

- Ligji nr. 8498, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale’ dhe protokollin e saj shtesë”;

- Ligji nr. 9539, datë 22.5.2006, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999 ‘Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale’ dhe të protokollit të saj shtesë”;

- Ligji nr. 8642, datë 13.7.2000, “Për ratifikimin e ‘Konventës evropiane për shtypjen e terrorizmit’”;

- Ligji nr. 8865, datë 14.3.2002, “Për ratifikimin e ‘Konventës ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit’”;

- Ligji nr. 9230, datë 13.5.2004, “Për ratifikimin e ‘Protokollit ndryshues të konventës evropiane për shtypjen e terrorizmit’”;

- Ligji nr. 9641, datë 20.11.2006, Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin e terrorizmit’”;

- Ligji nr. 9646, datë 27.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës ‘Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit’”;

- Ligji nr. 9068, datë 15.5.2003, “Për ratifikimin e ‘Konventës evropiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale’”;

- Ligji nr. 8920, datë 11.7.2002, “Për ratifikimin e ‘Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar’ dhe dy protokolleve shtesë të saj”;

- Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin



e konventës së Këshillit të Evropës ‘Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore’;

- Ligji nr. 8703, datë 1.12.2000, ‘Për ratifikimin e Konventës evropiane për informimin për të drejtën e huaj’;

- Ligji nr. 45/2022, ‘Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për aksesin në dokumente zyrtare’;

- Ligji nr. 8496, datë 3.6.1999, ‘Për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve’;

- Ligji nr. 9288, datë 7.10.2004, ‘Për ratifikimin e konventës ‘Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale’ i ndryshuar’;

- Ligji nr. 9/2017, ‘Për një ndryshim në ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004, ‘Për ratifikimin e konventës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale’;

- Ligji nr. 49/2022, ‘Për ratifikimin e protokollit ndryshues të konventës ‘Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale’. Në datën e hyrjes në fuqi të protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale hyjnë në fuqi shfuqizimet e mëposhtme: (a) në ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004, ‘Për ratifikimin e Konventës ‘Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale’, i ndryshuar’, nenet 2, 3 dhe 4 shfuqizohen.

2.2 Lidhja e SNMVK-së me kuadrin ligjor kombëtar

SNMVK 2024–2030, lidhet me kuadrin ligjor në fuqi që normon të drejtat e viktimave të veprave penale. Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe nënligjor thuajse të plotë e të qartë.

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar në pjesën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut parashikon ndër të tjera detyrimin e organeve të pushtetit publik, të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe në realizimin e tyre (nenet 15 dhe 2), kontribuojnë, gëzojnë të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë nga shtetasit shqiptarë, të huaj dhe personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara (nenet 16 dhe 1), barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimi

(neni 18), ndalimi i torturës (neni 25), ndalimi i punës së detyruar (neni 26), të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë (neni 43), të drejtën që të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore (neni 44), mbrojtja e veçantë nga shteti e fëmijëve, të rinjve, grave shtatzëna dhe nënat, mbrojtja e çdo fëmije nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal (neni 54).

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar, në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme të tij parashikon një mbrojtje të veçantë të viktimave dhe një politikë penale në përgjithësi në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, pasojat e ardhura, kategoritë e personave ndaj të cilëve është kryer.

Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’ (KPP), i ndryshuar, parashikon se viktima ka të drejtat e parashikuara nga KPP-ja gjatë procedimit penal dhe se organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga Kodi (neni 9/a). Të drejtat e detajtuara të viktimës së veprës penale parashikohen në kreun VI ‘Viktima, viktima akuzuese, paditësi dhe i padituri civil’ dhe në dispozitat e tjera të kërreve të tjerë.

Ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017, ‘Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur’ (KDPM) përmban rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale. KDPM-ja përcakton rregulla të detajuara për informimin dhe aksesin e viktimës së mitur në çdo fazë të procesit penal, rregullat e pyetjes dhe mjedisin e sigurt për fëmijën, të drejtat e kategorive të veçanta të viktimave dhe shpërblimin dhe kompensimin e dëmit.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, parashikon rregullat për krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen,



mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje, parashikon masat e mbrojtjes të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, si dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse.

Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikon procedurat administrative të trajtimit të ankesave për diskriminim në sektorin publik dhe privat, format e diskriminimit, përfshirë format e rënda të diskriminimit për viktimat, të drejtën e komisionerit, i cili bazuar në kërkesën e gjykatës duhet të parashtojë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin, të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive, të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve (neni 32, germa “g”, “i”, “i/1”), si dhe dëmshpërblimin e viktimës (neni 38).

Ligji nr. 111, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka si qëllim të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë, të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike, të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive. Ligji përcakton kategoritë e personave që përfitojnë ndihmë juridike pavarësisht pasurisë dhe të ardhurave të tyre ndër të cilët janë viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal, viktimat e mitur në çdo fazë të procedimit penal, personat të cilëve iu është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji nr. 98/2017, “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, ka si qëllim përcaktimin e tarifave gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile, administrative dhe në gjykimin në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim përfitimin e shërbimeve efektive dhe cilësore të ofruara nga

gjykata. Ndër të tjera, ligji përcakton rastet e përjashtimit të palët ndërgjyqësore nga pagesa e tarifës gjyqësore bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike (neni 9).

Ligji nr. 10 173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar, rregullon masat e posaçme, të përkohshme dhe të jashtëzakonshme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e programit të mbrojtjes. Rregullat e këtij ligji janë të zbatueshme në kuadër të procedimeve penale për krime të kryera me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim jo më pak se 4 vjet, në minimum. Rrezikshmëria e këtyre krimeve dhe e autorëve të tyre duhet të jetë e tillë, që të justifikojë kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen e një ose të disa personave.

Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ndër të tjera, rregullon mekanizmat efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit ndaj tij. Ndër të tjera ligji mbron fëmijët nga të gjitha format e dhunës, shfrytëzimit ekonomik, mbrojtja nga përdorimi i alkoolit dhe duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope, mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, mbrojtja e fëmijës nga aksesit në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet, mbrojtja nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe në situata të emergjencave civile (nenet 23–28), e drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor (neni 29). Ligji parashikon masat e mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjen e posaçme për kategori të veçanta të fëmijëve, si: fëmijët e abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar, fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht, fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale (neni 62–66), si dhe rregulla dhe detyrime për raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë mbrojtjeje (neni 67–68).



Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” përcakton, ndër të tjera, kushtet dhe procedurat për dhënien e statusit të refugjatit, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e refugjatëve, të kërkuësve për mbrojtje ndërkombëtare, të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese. Ligji parashikon mbrojtje për personat që i përkasin kategorisë së veçantë ku përmenden fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e gjymtimit gjenital, LGBTI+, personat me sëmundje të rënda, personat me probleme/çrregullime të shëndetit mendor ose persona të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale (neni 3, pika 25).

Të tjera ligje me rëndësi janë:

- Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”;
- Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;
- Ligji nr. 8678 datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligji nr. 146/2014, datë 30.10.2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 98/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 115/2016, datë 3.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- Ligji nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 95, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror”;
- Ligji nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 55/2018, datë 23.7.2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”;
- Ligji nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”;
- Ligji nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Ligji nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9381, datë 28.4.2005, “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Ligji nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”;
- Ligji nr. 22, datë 3.5.2018, “Për strehimin social”;
- Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 163/2014, “Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 40/2016, “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji nr. 121/2016, datë 24.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 93/2014, datë 24.7.2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;



- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”;

- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”;

- Ligji nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”;

- Ligji nr. 62/2022, “Për regjistrin kombëtar të të dënuarve për krime seksuale”;

- Ligji nr. 157, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 15, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr. 80, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr. 75/2019, “Për rininë”;

- Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 119, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit”;

- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të tjera akte nënligjore me rëndësi janë:

- Urdhri i Kryeministrit nr. 50, datë 5.4.2023, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës Për hartimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, të planit të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”;

- Vendim i KM-së nr. 290, datë 11.4.2020, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”, i ndryshuar;

- Vendim i KM-së nr. 314, datë 15.5.2019, “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, i ndryshuar;

- Vendim i KM-së nr. 148, datë 20.3.2019, “Për procedurën që zbaton shërbimi i provës në rast të mospërmbljes së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale”;

- Vendim i KM-së nr. 149, datë 20.3.2019, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit të aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësën e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”, i ndryshuar;

- Vendim i KM-së nr. 655, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa në vendimin nr. 149, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit të aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësën e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”, i ndryshuar;

- Vendim i KM-së nr. 233, datë 17.4.2019, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”;

- Vendim i KM-së nr. 314, datë 5.5.2010, “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara dhe për përcaktimin e shpërbërimit, të personave të tretë, në administrimin e pasurisë”, i ndryshuar;

- Vendim i KM-së nr. 867, datë 10.12.2014, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” të ndryshuar;

- Vendim i KM-së nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”;

- Vendim i KM-së nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”;

- Vendim i KM-së nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit,



hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;

- Vendim i KM-së nr. 623, datë 26.10.2018, “Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”;

- Udhëzim i MD-së nr. 7640, datë 5.7.2018, i ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e formës dhe rregullave të përgatitjes së dokumentit për lirin me kusht të të miturit të dënuar”;

- Udhëzim i përbashkët i MD-së dhe MSHMS-së nr. 650, datë 13.9.2019, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal”;

- Udhëzim i MD-së, KLGJ-së nr. 9, datë 17.6.2020, “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”, i ndryshuar;

- Udhëzim i përbashkët i MD-së dhe i MFE-së nr. 8, datë 19.7.2022, “Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përktimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike”;

- Udhëzim i MSHMS-së nr. 564, datë 5.10.2022, “Për miratimin e standardeve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës”;

- Udhëzim i KDIMDP-së nr. 9, datë 15.9.2010, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në medien e shkruar, vizive dhe audiovizive, të ndryshuar;

- Urdhër i MD-së nr. 7641, datë 5.7.2018, “Për përcaktimin e elementeve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin”.

2.3 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me dokumentet strategjike

2.3.1 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim Evropian 2022–2030 (SKZHIE III)

SNMVK 2024–2030 është e lidhur ngushtësisht me qëllimet dhe objektivat e *Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim Evropian 2022–2030* (SKZHIE III) dhe është mbështetur në shtyllën kryesore të sistemit të drejtësisë “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë”. SNMVK 2024–2030 udhëhiqet nga parimi i së drejtës për

informim, parimi i mbrojtjes së të drejtave të viktimave, parimi i mbështetjes së të drejtave të viktimave, duke marrë në konsideratë, viktimat me nevoja të veçanta specifike.

SKZHIE III është një strategji ombrellë e cila siguron prioritizimin e politikave në nivel afatmesëm dhe afatgjatë, në nivel kombëtar dhe përfshin politikat dhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale të institucioneve të tjera shtetërore. Në këtë kontekst, SKZHIE III te nënfusha “Forcimi i të drejtave të njeriut”, parashikon objektiva strategjike që lidhen konkretisht me aksesin në drejtësi të viktimave me nevoja specifike, fuqizimin e të drejtave të viktimave me nevoja specifike, me drejtësi miqësore për fëmijët, me përmirësimin e qasjes në drejtësi të viktimave me nevoja të veçanta specifike, duke garantuar mbrojtje dhe mbështetje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara, me garantimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi diskriminimin dhe të drejtën për mundësi të barabarta në përgjithësi.

2.3.2 Lidhja me programin e qeverisë

SNMVK 2024–2030 lidhet me programin e qeverisë 2021–2025, kryesisht me prioritetin “Shqipëria e së drejtës”.

2.3.3 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 (SND 2021–2025)

SND 2021–2025 dhe Plani i saj i Veprimit, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 823, datë 24.12.2021. Vizioni i strategjisë është “*Sistem i drejtësisë i pavarur, llogaridhënës, i aksesueshëm, transparent dhe eficient që mbron të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane*”.

SND 2021–2025 dhe Plani i saj i Veprimit parashikon katër qëllime politike për sistemin e drejtësisë. Ky dokument strategjik bazohet në një nga fushat prioritare që është sistemi i drejtësisë penale i bazuar në parimet bazë të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe synon risocializimin, riintegrimin, rehabilitimin dhe parandalimin e veprave penale. Për konkretizim qëllimi politik 3 dhe objektivi specifik 3.3, synon një qasje për një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të tyre. Ky objektivi specifik lidhet me kapitullin 23 “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*” dhe me nenin 78 të *Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve*



Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”.

SNMVK 2024–2030 synon informim, ndërgjegjësim, krijimin e një mjedisi të sigurt për çdo viktimë, mbështetje dhe mbrojtje sipas nevojave të veçanta të viktimës, përafrim të legjislacionit kombëtar me standardet e parashikuara në direktivat e BE-së dhe me aktet e tjera ndërkombëtare, si dhe krijimin e një skeme kombëtare kompensimi, lehtësimin e aksesit viktimave të krimit në të.

Kjo strategji synon, garantimin e të drejtave të viktimave të krimit, si: informim, mbështetje, mbrojtje dhe pjesëmarrje efektive në proceset penale. Në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar synon forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit dhe koordinimit me anë të shërbimeve për viktimat e krimit.

2.3.4 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me Strategjinë Ndërsëktoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 (SDM 2022–2026)

SDM 2022–2026 është miratuar me vendimin nr. 892, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”. Kjo strategji me qasje ndërsëktoriale parashikon mbrojtje dhe garantim të të drejtave të fëmijëve, duke synuar një drejtësi sa më miqësore për çdo fëmijë bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Kjo strategji, adreson konsolidim të aksesit në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë, parandalim parësor të përfshirjes së fëmijëve në kriminalitet dhe viktimizimin e tyre, akses në ndihmën juridike falas, fuqizim të kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë, garantimin e një procesi të rregullt ligjor për çdo fëmijë në çdo kohë dhe pa vonesë, ushtrimin e të drejtave në fushën familjare, civile, administrative dhe penale, konsolidimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale ose procedimi gjyqësor, me anë të zbatimit të programeve restauruese e ndërmjetësuese, duke mbajtur fëmijët jashtë proceseve penale dhe procedimeve gjyqësore këshillimit, mbikëqyrjes së fëmijës në rastet kur familja ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk mund ta ushtrorë, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijës në shoqëri.

SNMVK 2024–2030 lidhet me SDM 2022–2026 konkretisht me qëllimin e politikës 1 “Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimi të

shoqërisë dhe fëmijëve” dhe me objektivin specifik 1.1 “Informim/edukim/ndërgjegjësim në qarqet e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë” dhe me masën 1.1.10.1 “Fushatë kombëtare ndërgjegjësuere me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimat, të fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin e të dhënave personale, në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrative)”.

Më tej, SNMVK 2024–2030 lidhet me SDM 2022–2026 konkretisht me qëllimin e politikës 2: “Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë me 2.1 objektivin specifik: “Kuadri ligjor dhe politikat institucionale garantojnë akses te një drejtësi miqësore për çdo fëmijë” me masën 2.1.7 “Përditësimi i udhëzimeve të miratuara nga prokurori i përgjithshëm në lidhje me hetimin e çështjeve të të miturve dhe trajtimin e fëmijëve viktimat”, me objektivin specifik 2.2: “Koordinimi dhe bashkërendimi mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët”, si dhe me masën 2.2.6.2 “Trajnimi vazhdues i psikologëve asistues/asistues/ trajtues të rasteve në polici, prokurori, gjykata dhe koordinatorëve të viktimave në prokurori”.

SNMVK 2024–2030 lidhet me SDM 2022–2026 konkretisht me qëllimin e politikës 3. “Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë” në mënyrë indirekte me objektivin specifik 3.1: “Qasje për çdo fëmijë në ndihmën juridike të ofruar nga profesionistë të trajnuar dhe informacioni me gjuhë miqësore për çdo fëmijë” dhe me objektivin specifik 3.3: “Shërbime mbështetëse të standardizuara, të arritshme për çdo fëmijë” dhe konkretisht lidhur me këto masa: Masa 3.3.3 “Hartimi i një programi për shpërblimin e dëmit shkaktuar fëmijës viktimë, nga autori i veprës penale ose shteti, aktiviteti 3.4.3.4 “Përgatitja e programit për kompensimin e viktimave të krimit nga autori i veprës ose shteti”, aktiviteti 3.3.3.1 “Analizë ligjore lidhur me çështjen e kompensimit të viktimave të krimit nga autori i veprës ose shteti bazuar në praktikat ndërkombëtare”.

Duke analizuar, SNMVK 2024–2030, sqarojmë se ky dokument lidhet me SDM 2022–2026



konkretisht me qëllimin e politikës 4. “Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin me objektivin specifik 4.2 “Programe të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit të mundësuar për fëmijën në konflikt me ligjin ose viktimë e krimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës” dhe me aktivitetin: 4.2.2.2 Plotësimi i vendeve vakante me ndërmjetësues të trajnuar/specializuar për të miturit autorë dhe viktima të krimit”.

2.3.5 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE)

SNMVK 2024–2030, lidhet me dy kapituj kryesorë të PKIE 2023–2025, konkretisht me kriterin politik “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, “Të drejtat e njeriut” dhe me kapitullin 23: “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, i cili është i përbërë me tri shtylla kryesore, të cilat prekin: 1) sistemin gjyqësor; 2) luftën kundër korrupsionit; 3) përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

2.3.6 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA)

SNMVK 2024–2030 lidhet me MSA-në, e miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtarë”, përkatësisht me nenet respektive: me pikën 2, të nenit 1, synimet e këtij asociimi janë të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës” me nenin 2 të MSA-së “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës, si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve dhe përbëjnë elementet thelbësore të kësaj marrëveshjeje. Duke mbetur brenda kornizave ligjore të MSA-së, një nga fushat prioritare strategjike të SNMVK 2024–2030 është përafrimi i legjislacionit të brendshëm me *acquis* dhe standardet e BE-së e bazuar në nenin 70 të MSA-së “Palët

njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis*. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet”.

Në kontekstin strategjik SNMVK 2024–2030 lidhet me nenin 78 “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës” të MSA-së, “Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme me palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera ligjzbatuese duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Gjithashtu, SNMVK 2024–2030 lidhet edhe me nenin 88 “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, “Bashkëpunimi midis palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Ky sistem duhet, gjithashtu, të mundësojë Institutin Shqiptar të Statistikës për të përmbushur më mirë nevojat e aktorëve vendës dhe ndërkombëtarë (si të administratës publike ashtu dhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga OKB-ja dhe Kodi Statistikor Evropian i Praktikës dhe parashikimet e së drejtës Statistike Evropiane, dhe duhet të zhvillohet drejt *acquis* së Komunitetit”.

2.3.7 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me dokumentet e tjera strategjike kombëtare

SNMVK 2024–2030 lidhet me *Strategjinë Kombëtare për Barazji Gjimore 2021–2030* (SKBGJ 2021–2030) konkretisht me qëllimin politik 1 “Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejtat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejtave dhe vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet



etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim”, me objektivin specifik 1.2 “Rritja e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive” me objektivin specifik 1.3 “Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuar, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) për punë të denjë edhe në sektorët jotradicionale të punësimit (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë)”.

Gjithashtu lidhet me qëllimin politik 3 “Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje” me objektivin specifik 3.1 “Mbrojtja më e mirë e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dhunuar, ndëshkimit të dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese, me objektivin specifik 3.3 “Përmirësimi i qasjes në drejtësi të grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të moshuara, azilkërkuese, të dhunuara/trafikuar, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për të mbrojtur të drejtat e tyre”, me objektivin specifik 3.4 “Përgatitja e një brezi të ri të barazisë ku gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike,

me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.)” janë agjentë të ndryshimit në lidhje me normat diskriminuese shoqërore, stereotipat gjinorë dhe parandalimin e luftimit të seksizmit dhe me objektivin specifik 3.5 “Fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuar, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.)” për të pasur kontroll të plotë, për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për çështjet që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues.

SNMVK 2024–2030 lidhet me *Ajgëndën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026* konkretisht me qëllimin politik 2 “Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme” me objektivin specifik 2.2 “Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve”. SNMVK 2024–2030 lidhet konkretisht me qëllimin politik 3 “Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët” me objektivin specifik 3.2 “Sistem i integruar i mbrojtjes sociale, i ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve” dhe me objektivin specifik 3.4 “Drejtësi miqësore për fëmijët”.

SNMVK 2024–2030 lidhet me *Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 - 2025*, konkretisht me qëllimin politik 2 “Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara” me objektivin specifik 2.1 “Rritja e numrit të individëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas” me objektivin specifik 2.3 “Garantimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e dënimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare” dhe me objektivin specifik 2.2 “Njohja e barabartë para ligjit e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht i personave me aftësi të kufizuara mendore”.

SNMVK 2024–2030 lidhet me *Planin Kombëtar të Veprimit për Barazë, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025* konkretisht me qëllimin politik 1 “Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe egjiptianët” me objektivin specifik 1.1 “Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të minoritetit romë dhe egjiptian me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë



në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile” dhe me objektivin specifik 1.2 “Garantimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për romët dhe egjiptianët”.

Gjithashtu, SNMVK 2024–2030 lidhet me qëllimin politik 7 “Antixhipsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistemike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj R&E” me objektivin specifik 7.3 “Ulja e diskriminimit ndaj R&E dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi për barazi” dhe me objektivin specifik 7.4 “Minimizimi/eliminimi i gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes ndaj R&E”.

SNMVK 2024–2030 lidhet me *Planin Kombëtar për Personat LGBTI+ 2021–2027*, konkretisht me qëllimin politik 2: “Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë” me objektivin specifik 2.2 “Zbatimi me profesionalizëm dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+” me masën 2.2.3 “Trajnimi i profesionistëve dhe profesionistëve të zyrave për ndihmë juridike falas, si dhe i OJF-ve dhe klinikave të ligjit të licencuara për ofrimin e ndihmës juridike, me qëllim ofrimin e shërbimeve të ndjeshme ndaj personave LGBTI+”, si dhe aktivitetin 2.2.3.a për përgatitjen e modulit të trajnimit dhe me aktivitetin 2.2.3.b “Trajnimi i profesionistëve në fushën e ofrimit të ndihmës ligjore, për shërbime të ndjeshme ndaj personave LGBTI+ 30 profesioniste e profesionistë të trajnuar çdo vit”.

SNMVK 2024–2030 lidhet me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023 konkretisht me objektivin strategjik C “Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale” dhe me objektivin specifik C1 “Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar”.

SNMVK 2024–2030 lidhet me *Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029* konkretisht me qëllimin politik 3 “Mirëqenia dhe përfshirja”. Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave/rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë

rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti)” me objektivin specifik 3.1 “Mbrojtja, mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale”.

SNMVK 2024–2030 lidhet me Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizimit të Dhunës me Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe planeve të veprimit 2023–2025, të miratuara me vendim nr. 81, datë 14.2.2023, të Këshillit të Ministrave, konkretisht me qëllimin politik 1 “Mbrojtja e kërcënimit terrorist në nivel të ulët” me objektivin specifik 1.1 “Parandalimi i terrorizmit” me qëllimin politik 3 “Njohja e kërcënimeve të terrorizmit në vendin tonë përmes identifikimit të hershëm të grupeve të synuara dhe metodave radikale” me objektivin specifik 3.1 “Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm”.

Në këtë kontekst, SNMVK 2024–2030 lidhet me qëllimin politik 4 “Zgjerimi i kapaciteteve operacionale të policisë dhe kapaciteteve të inteligjencës” me objektivin specifik 4.1 “Rritja e parandalimit nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për radikalizimin dhe terrorizmin”, si dhe me qëllimin e politikës 6 “Identifikimi, hetimi, zbulimi i veprave penale në fushën e terrorizmit dhe financimit të tij dhe goditja e individëve dhe grupeve terroriste” dhe me objektivin specifik 6.1 “Hetimi i terrorizmit dhe burimeve të tij”.

Më tej, SNMVK 2024–2030 lidhet me qëllimin politik 7 “Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, ruajtjes, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit” me objektivin specifik 7.2 “Vlerësimi periodik i nivelit të rrezikut/kërcënimit të faktorëve dhe fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm si derivate të terrorizmit” dhe me objektivin specifik 7.3 “Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me agjencitë inteligjente dhe ligjzbatuese në vend dhe ato të huaja me përgjegjësi në luftën kundër terrorizmit për përcaktimin e nivelit të kërcënimit terrorist në rrafshin ndërkombëtar *modus operandi* dhe ndikimit të tij në Shqipëri”.

Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025, është miratuar me vendimin nr. 81, datë 14.2.2023 të Këshillit të Ministrave.



SNMVK 2024–2030 lidhet veçanërisht me qëllimin politik 9 “Reagim nëpërmjet reduktimit dhe lehtësimit të pasojave të fenomeneve të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit”, objektivin specifik 9.1 “Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e dhënies së ndihmës viktimave të terrorizmit sipas konventës evropiane për kompensimin e viktimave të terrorizmit”; objektivin specifik 9.2 “Përmirësim i infrastrukturës dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve publike për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit”; objektivin specifik 9.3 “Fuqizimi ekonomik i personave të radikalizuar dhe familjeve të kthyer nga vendet e luftës përmes integritetit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim”; dhe objektivin specifik 9.4 “Rritja e aksesit të personave të riintegruar dhe të kthyer nga vendet e luftës në programet e strehimit social”.

Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023 është miratuar fillimisht me vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020. Ky akt ka pësuar ndryshime me VKM-në nr. 670, datë 10.11.2021 dhe me VKM nr. 54, datë 1.2.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, është miratuar Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planin e veprimit 2021–2022”, të ndryshuar.

2.3.8 Lidhja e SNMVK 2024–2030 me Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Viktimave të Krimit për periudhën 2020–2025

SNMVK 2024–2030 është përgatitur në frymën e Strategjisë së BE-së për të Drejtat e Viktimave të Krimit për periudhën 2020–2025, konventave të Këshillit të Evropës ku shteti shqiptar është palë, jurisprudencën e GJEDNJ-së, dhe me aktet e *acquis* e BE-së për mbrojtjen e viktimave të krimit.

Strategjia e BE-së bazohet në pesë fusha prioritare që garantojnë të drejtat e viktimave të veprave penale, të cilat janë: a) Komunikimi efektiv

me viktimat dhe një mjedis i sigurt për viktimat për të raportuar krimin; b) Përmirësimi i mbështetjes dhe mbrojtjes për viktimat; c) Lehtësimi i aksesit të viktimave në kompensim; d) Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjithë aktorëve përkatës; e) Forcimi i dimensionit ndërkombëtar të të drejtave të viktimave.

Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020–2025, e para në këtë fushë, synon të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe viktimave me nevoja specifike të veçanta dhe të mbështesë të drejtat e të gjitha viktimave të veprave penale, pavarësisht se ku ka ndodhur vepra penale apo në çfarë rrethanash ka ndodhur vepra penale.

Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020–2025 është e bazuar në një grup solid të direktivave që garantojnë të drejtat e viktimave, përmes direktivës për të drejtat e viktimave⁹, ku përfshihet e drejta për informacion, e drejta për mbështetje dhe mbrojtje, në përputhje me nevojat individuale të viktimave dhe një sërë të drejtash procedurale. Në këtë kuadër është miratuar gjithashtu direktiva e kompensimit¹⁰, rregullat e BE-së për urdhrat evropianë të mbrojtjes¹¹, direktiva kundër trafikimit¹², direktiva kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve¹³ dhe direktiva kundër terrorizmit¹⁴ me të drejta specifike për viktimat e terrorizmit. Shumica e shteteve anëtare ende nuk i kanë transpozuar plotësisht standardet minimale të dakorduara në rregullat e BE-së për të drejtat e viktimave.

BE-ja ka nënshkruar gjithashtu Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit). Gjithashtu, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Stambollit me ligjin nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’”.

Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020–2025 synon fuqizimin e viktimave të krimit dhe mbështetjen e të drejtave të viktimave të krimit.

⁹ Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012.

¹⁰ Direktiva e Këshillit 2004/80/KE e 29 prillit 2004.

¹¹ Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi urdhrin evropian të mbrojtjes dhe Rregullorja (BE) Nr. 606/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 qershor 2013 për njohjen reciproke të masave të mbrojtjes në çështjet civile.

Faqe | 22216

¹² Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011.

¹³ Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011.

¹⁴ Direktiva (BE) 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 mars 2017.



Elementi thelbësor i strategjisë së BE-së, konsiston në fuqizimin e viktimave të krimit, duke i krijuar një mjedis të sigurt në mënyrë të tillë që të mund të raportojnë krimin, të marrin pjesë në procedurat penale, të kërkojnë kompensim dhe të rikuperohen sa më shumë që të jetë e mundur nga pasojat e krimit.

Subjektet që përfshin Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020–2025:

- viktimat e veprave penale në tërësi;
- viktimat me nevoja specifike (viktimat e dhunës me bazë gjinore, fëmijët viktimë të veprave penale, viktimat me aftësi të kufizuara, viktimat në moshë të thyer, viktimat e krimeve të urrejtjes, racizmit dhe ksenofobisë (komunitetet fetare, komuniteti LGBTI+);
- viktimat e terrorizmit ose viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, emigrantët e parregullt që bëhen viktimë të krimit, të miturit e pashoqëruar që bëhen viktimë të krimit, viktimat e krimit të kryer në paraburgim.

Strategjia e BE-së ka pesë fusha prioritare, të cilat adresojnë çështjet si vijon:

1. Komunikimi efektiv me viktimat dhe një mjedis i sigurt për viktimat për të raportuar krimin. Kjo fushë synon krijimin dhe pasjen e një politike efektive për të luftuar krimin dhe kërkon nga autoritetet kombëtare të marrin masa për të siguruar një mjedis të sigurt për viktimat, në mënyrë që të raportojnë krimet. Me rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e viktimave dhe krijimi i një mjedisi më të sigurt për viktimat me fokus grupet vulnerabel dhe komunitetet e marginalizuara, të cilët kanë mundësi të kufizuara të aksesit në drejtësi është hapi i parë për arritjen e realizimit të kësaj fushe prioritare.

2. Përmirësimi i mbështetjes dhe mbrojtjes për viktimat e krimit është fusha prioritare e cila synon rritjen e vëmendjes ndaj viktimave me nevoja specifike për mbrojtje nga rreziqet e viktimizimit dytësor, viktimizimit të përsëritur, intimidimit dhe hakmarrjes.

3. Lehtësimi i aksesit të viktimave në kompensim sipas direktivës së Këshillit 2004/80/KE e 29 prillit 2004, është fusha prioritare, e cila konsiston në kompensimin e viktimave të krimit, në shtetet anëtare që në legjislacionin kombëtar të sigurojnë ekzistencën e një skeme për kompensimin e viktimave të veprave penale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, që garanton kompensim të drejtë dhe të përshtatshëm ndaj viktimave.

Komisioni rekomandon që shtetet anëtare t'i bëjnë skemat e kompensimit më miqësore ndaj viktimave, të lehtësojnë aksesin në kompensim, duke rritur shumat e disponueshme të kompensimit dhe parashikimin e tyre në buxhetet kombëtare.

4. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjithë aktorëve përkatës është një nga fushat prioritare, e cila synon që shtetet anëtare të krijojnë strategjitë kombëtare të të drejtave të viktimave që të garantojnë qasje të koordinuar dhe horizontale ndaj të drejtave të viktimave. Politika të tilla mund të përfshijnë caktimin e koordinatorëve kombëtarë të të drejtave të viktimave ose personave përgjegjës për të drejtat e viktimave, nisjen e fushatave kombëtare të ndërgjegjësimit për të drejtat e viktimave dhe përfshirjen e të drejtave të viktimave në politika të tjera si shëndetësia dhe arsimi. Hartimi i këtij dokumenti politikash shërben për të krijuar një urë komunikimi dhe ndërveprimi institucional në nivel kombëtar, me të gjithë profesionistët që punojnë me dhe për viktimat, sikurse mund të jenë: policia, gjykatat, stafi i gjykatave, shërbimet e mbështetjes së viktimave, si dhe autoritetet e kompensimit, personeli mjekësor, personeli arsimor, personeli i shërbimeve sociale ose personeli i paraburgimit.

5. Forcimi i dimensionit ndërkombëtar të të drejtave të viktimave është fusha që në kuadrin e negociatave të anëtarësimit dhe të Procesit të Stabilizim-Asociimit, BE-ja do të vazhdojë të punojë ngushtë me vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për të forcuar të drejtat e viktimave, duke pasur në konsideratë programet për të siguruar se viktimat në vendet partnere të marrin mbështetjen dhe mbrojtjen e nevojshme.

3. Arritjet, analiza dhe sfidat

Ministria e Drejtësisë me mbështetjen dhe asistencën teknike të Projektit JustAL (Asistenca Teknike e Bashkimit Evropian ofruar Ministrisë së Drejtësisë), zyrës së UNICEF-it Shqipëri, Prezencës së OSCE-ë në Shqipëri, si dhe gjithë institucioneve të përfshira udhëhoqën procesin e hartimit të objektivave strategjikë, masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit, duke mbajtur dhe marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, si dhe të institucioneve dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë që punojnë me dhe për viktimat.

Në dy dekadat e fundit, veçanërisht në kuadër të Reformës në Drejtësi, pozita e viktimës në proces



penal ka njohur përmirësime, në sajë të përmirësimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor, krijimit dhe konsolidimit të strukturave përgjegjëse që punojnë me viktimat dhe për ta, si dhe rritjes së fuqizimit të kapaciteteve të profesionistëve, përfshirë krijimin e aksesit në drejtësi për çdo viktimitë. Megjithatë, analiza e pozitës së viktimës së krimit në sistemin e drejtësisë penale evidentoi disa gjetje të cilat në mënyrë të përmblodhur paraqiten si më poshtë vijon:

Lidhur me kuadrin ligjor, institucional dhe politikat në mbrojtje të viktimave të krimit

Qëllimi i SNMVK 2024–2030, është të përgatisë rrugën e përafrimit të kuadrit ligjor shqiptar në lidhje me të drejtat e viktimave të krimit me direktivat e BE-së në fushë, e cila ka parashikuar masa realiste dhe të realizueshme për zbatimin e tyre për ta sjellë legjislacionin tonë në përputhje me standardet e BE-së për mbrojtjen e viktimave dhe të garantojë informim, mbështetje dhe mbrojtje efektive për viktimat e krimit në sistemin e drejtësisë penale shqiptare.

Në referim të raport-analizës për gjendjen e viktimave të krimit në Shqipëri, rezulton se nuk ka një vlerësim të plotë dhe të përditësuar të nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar për të drejtat e viktimave me direktivat e BE-së, në këtë kuadër është i rekomandueshëm parashikimi i masave konkrete për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së dhe me rekomandimet e mekanizmave monitorues të konventave ku shteti shqiptar është palë.

Me gjithë përparimet e bëra në fushën e

legjislacionit, nevoja për përmirësime të kuadrit ligjor dhe të politikave të mbrojtjes së viktimave të krimit janë vënë në dukje nga institucionet monitoruese kombëtare, si: Avokati i Popullit,¹⁵ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mekanizmat monitorues të konventave ku shteti shqiptar është palë¹⁶ dhe partnerët/organizatat vendëse dhe ndërkombëtare që punojnë me/për viktimat dhe të drejtat e tyre.

Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)¹⁷ që monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje ka adresuar një sërë rekomandime për përmirësime në Kodin Penal që lidhen me inkriminimin e veprave penale të reja, saktësimin dhe plotësimin në dispozitat ekzistuese për dhunën seksuale, qartësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, zbatimin e një politike për dënime më të rënda për martesat e detyruara, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit me format specifike të dhunës ndaj grave. GRETA¹⁸, mekanizmi monitorues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin e shfrytëzimit të fëmijës ka adresuar disa rekomandime për përmirësime ligjore në Kodin Penal për kriminalizimin e trafikimit të brendshëm të fëmijëve (neni 128/b, KP).

Studimet, analizat dhe strategjitë që adresojnë mbrojtjen e kategorive të ndryshme të viktimave përbajnë propozime për përmirësime të legjislacionit lidhur me mbrojtjen e viktimave ose nevojën e një ligji të ri për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit.¹⁹ Ende nuk ka një ligj të

¹⁵ Raport i Avokatit të Popullit mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020–shtator 2021, vep. e cituar.

¹⁶ Për më shumë shih: GREVIO's (Baseline) Evaluation Report on legislative and other measures giving effect to the provisions of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention) ALBANIA <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>; <https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/category/rekomandime-raporte-te-cedaw-grevio-dhe-upr-per-shqiperine/>; <https://www.coe.int/en/web/anti-human-trafficking/albania> Raporti i ECRI-it për Shqipërinë, raundi 5, Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i pestë monitorues) miratuar më 19 Mars 2015 botuar më 9 qershor 2015, f. 11–12. Shih: <https://rm.coe.int/fifth-report-on-albania-albanian-translation-/16808b54e9>.

Recommendation CP/Rec(2020)06 on the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Albania: <https://rm.coe.int/cp-rec-2020-06-alb-en/1680a09acc>;

¹⁷ <https://rm.coe.int/168046246b>.

¹⁸ Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings, Evaluation Report, GRETA, 2020. Shih: <https://rm.coe.int/greta-2020-09-fgr-alb-en/1680a0b84f>. Recommendation CP/Rec (2020)06 on the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Albania. Shih: <https://rm.coe.int/cp-rec-2020-06-alb-en/1680a09acc>.

¹⁹ Raport studimor mbi nevojën e hartimit të një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit në Shqipëri; botim i MSHCS-së dhe organizatës Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”. Shih: <https://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/10/Raport-Studimor-mbi-nevojen->



përgjithshëm kundër dhunës, përfshirë dhunën me bazë gjinore. Rekomandime për përmirësime ligjore janë adresuar edhe aktualisht, një grup pune po punon për hartimin e projektikut të ri penal.

Përkufizimi i nocioneve “viktimë”, “të afërm të viktimës” dhe “trashëgimtarë të viktimës” shtrirja e të drejtave dhe roli i viktimës në sistemin e drejtësisë penale, ka rëndësi për njohjen reale të viktimizimit, për pasjen e të dhënave statistikore sa më të plota dhe të sakta për viktimat, si dhe për hartimin e politikave të duhura për adresimin e nevojave të tyre.

Direktiva 2012/29/BE përkufizon nocionet “viktimë” dhe “anëtarë të familjes”²⁰. “Viktimë” është çdo person fizik i cili ka vuajtur një lëndim serioz, duke përfshirë një lëndim fizik, mendor ose emocional, ose humbje ekonomike të shkaktuar drejtpërdrejt nga një veprë penale dhe anëtarët e familjes së një personi, vdekja e të cilit është shkaktuar drejtpërdrejt nga një veprë penale dhe të cilët kanë pësuar lëndime nga vdekja e këtij personi. “Anëtarë të familjes” në kuptimin e kësaj direktive janë bashkëshortët, personi që jeton me viktimën në një marrëdhënie intime, në një shtëpi të përbashkët dhe në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të afërmit e brezit të parë, vëllezërit dhe motrat dhe personat në ngarkim të viktimës.

Referuar legjislacionit shqiptar, Kodi i Procedurës Penale nuk jep përkufizimin e termave:

e-hartimit-te-nje-ligji-te-vecante-per-mbrojtjen-e-viktimave-te-trafikimit-ne-shqiperi.pdf.

²⁰ Nenet 2 dhe 1, geramat “a” dhe “b” të direktivës 2012/29/BE së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, së datës 25 tetor 2012 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe që zëvendëson vendimin kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

²¹ Udhëzimi me karakter të përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018, i prokurorit të përgjithshëm “Garantimi i asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”, neni 35 ka parashikuar se me “viktimë” kuptohet **individ i që ka pësuar dëm, përfshirë dëm fizik, emocional ose humbje ekonomike, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve, kryerja e të cilave përbën veprë penale, pavarësisht nëse autori i veprës penale identifikohet, arrestohet, ndiqet penalisht apo dënohet dhe pavarësisht nga lidhjet e gjakut apo të krushqisë mes tij dhe autorit të veprës..**

²² Sipas udhëzimit nr. 5 të PP-së, viktimë është individ i që ka pësuar dëm, përfshirë dëm fizik, emocional ose humbje ekonomike, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve, kryerja e të cilave përbën veprë penale, pavarësisht nëse autori i veprës penale identifikohet, arrestohet, ndiqet penalisht apo dënohet dhe pavarësisht nga lidhjet e gjakut

“viktimë”, “anëtarë të familjes”. Kodi i Procedurës Penale përdor disa terma si “personi i dëmtuar”, “viktima akuzuese”, “ai që është dëmtuar nga vepra penale”, “trashëgimtarë të viktimës”. KPP i njeh të drejtën trashëgimtarëve të viktimës të ushtrojnë disa të drejta të parashikuara në Kod, por nuk e përcakton se kush është rrethi e tyre ose nuk i referohet Kodit Civil sikurse bëhet në rastin caktimit të kujdestarit të posaçëm që i referohet Kodit të Familjes. Udhëzimi i prokurorit të përgjithshëm i vitit 2018²¹ jep përkufizimin “viktimë”, në rastin kur individ i është vrarë, “anëtar i familjes” dhe “trashëgimtar i viktimës”²². Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur jep përkufizimin e “viktimës së mitur”.²³ Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë jep përkufizimin e dëshmitarit të drejtësisë që përfshin personin e dëmtuar nga vepra penale që bën deklarime ose dëshmon për fakte e rrethana që përbëjnë objekt prove në një procedim penal dhe që për shkak të këtyre deklarimeve a dëshmime, ndodhet në gjendje rreziku, si dhe të personit të lidhur.²⁴ Përkufizimet “viktimë” ose “viktimë e mundshme e trafikimit”, “viktimë e dhunës në familje” jepen në ligje të

apo të krushqisë mes tij dhe autorit të veprës. Në rastin e individit të vrarë si pasojë e një veprë penale me viktimë kuptohet anëtar i familjes së tij, i cili ka pësuar dëm për shkak të vdekjes. Anëtar i familjes është: a) prindi dhe fëmija; b) bashkëshorti ose ai që bashkëjetonte me të në kohën e vdekjes; c) motra dhe vëllai; ç) personi në ngarkim të tij, nga pikëpamja financiare. “Trashëgimtar i viktimës” është trashëgimtari ligjor ose testamentar me titull universal, në kuptim të Kodit Civil përveç personave të cituar më sipër si anëtar familje të cilët paraqiten drejtpërdrejt si viktimat. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

²³ Sipas nenit 3, pika 5 të KDPM-së i mitur viktimë është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një veprë penale.

²⁴ Neni 3, pika 2 e ligjit nr. 10 173, datë 22.10.2009, për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Sipas po këtij ligji, persona të lidhur janë personat, të cilët ndodhen në gjendje rreziku, për shkak të lidhjeve të gjakut, të martesës, të bashkëjetesës së faktit ose marrëdhënieve të ngushta personale, që kanë me dëshmitarin ose me bashkëpunëtorin e drejtësisë (neni 3, pika). Llojet e programeve të mbrojtjes, masat dhe kohëzgjatja e tyre rregullohen me ligj dhe bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj.



posaçme²⁵ ose dokumente të politikave.²⁶

Sikurse shihet, ligjet dhe udhëzimi parashikojnë përkufizime të ndryshme dhe rrethi i personave trashëgimtarë është i gjerë dhe nuk kushtëzohet me faktin se marrëdhënia mes tyre kanë qenë ose janë të ngushta.

Direktivat dhe rregulloret e BE-së në lidhje me viktimat dhe parandalimin dhe luftimin e formave të veçanta të krimeve që shkaktojnë viktimat të shumta adresojnë masa ligjore, institucionale, garanci dhe të drejta minimale që shtetet anëtare ose potenciale për të qenë anëtare të BE-së duhet të adresojnë në legjislacionin kombëtar²⁷. Disa prej tyre janë parësore në procesin e përafrimit të legjislacionit, konkretisht direktivat²⁸ që lidhen me mbrojtjen e viktimave të krimit.

Propozime për përmirësime ligjore përmbajnë direktivat që kanë në fuqi dhe propozimet për ndryshimin e direktivave ekzistuese. Organizatat e shoqërisë civile vendëse dhe partnerë ndërkombëtarë që punojnë në Shqipëri kanë adresuar rekomandime për përmirësime të ligjeve dhe praktikave të zbatimit të tyre në lidhje me kategori të veçanta të viktimave, si: gratë, fëmijët, personat LGBTI+, viktimat e krimeve seksuale, të krimeve të urrejtjes, viktimat e trafikimit, viktimat e krimeve *online*, viktimat e krimeve për qëllime terroriste.

Sa më sipër, përafrimi i plotë i legjislacionit me aktet ndërkombëtare të sipërcituara, përfshirë direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian është ende një proces i papërfunduar. Mbledhja, analizimi, vlerësimi i sugjerimeve në lidhje me përmirësimet ligjore për mbrojtjen më të mirë të viktimave të krimit, konsultimi i gjerë i tyre me profesionistët, studiues, akademik, shoqërinë civile, me përfaqësues të grupeve të viktimave, si dhe inicimi i nismave ligjore është adresuar në SNMVK.

Në kuadër të SNMVK-së, janë parashikuar masa konkrete për përafrimin e legjislacioni shqiptar me direktivat e BE-së dhe me rekomandimet e mekanizmave monitorues të konventave ku shteti shqiptar është palë.

- Evidentimi i rekomandimeve për përmirësime ligjore dhe marrja e nismave ligjore për adresimin e tyre;

- Vijimi i fushatave të informimit, sensibilizmi dhe ndërgjegjësimi të publikut, të viktimave dhe institucioneve për të drejtat e viktimave, mekanizmat dhe shërbimet mbështetëse për to;

- Konsolidimi i praktikave të mira të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizatave të të drejtave të njeriut dhe mekanizmave monitorues të konventave që

²⁵ Neni 3, pika 9 e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

²⁶ Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit; Shih: <https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/PROCEDURAT-STANDARDE-T%C3%8B-VEPRIMIT-PER-MBROJTJEN-E-VIKTIMAVE-TE-TRAFIKIMIT.pdf> “Viktimë trafikimi” (VT), ka të njëjtin kuptim sipas gërmës “e” të nenit 4, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”. 8 “Viktimë e mundshme trafikimi” (VMT), është personi, për të cilin/të cilën, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar, bazuar në treguesit/indiktorët/dritën e rrethanave të veçanta të rasteve, në të cilën, të paktën tre ose më shumë elemente përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar.

²⁷ Detyrimet që burojnë nga direktivat dhe udhëzimet e BE-së trajtohen në kërret në vijim.

²⁸ Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012, për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe që zëvendëson vendimin kuadër të Këshillit 2001/220/JHA;

Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 5 prill 2011, për parandalimin dhe

Faqe | 22220

luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij dhe zëvendësimi i vendimit kornizë i Këshillit 2002/629/JHA;

Direktiva e 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 13 dhjetorit 2011 në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve;

Direktiva (EU) 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 15 mars 2017, për luftimin e terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit kornizë 2002/475/JHA dhe ndryshimin e 2005/671/JHA;

Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale;

Direktiva e Këshillit 2004/80/KE e datës 29 prillit 2004 lidhur me kompensimin e viktimave të krimit;

Propozimi për një direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që ndryshon direktivën 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij {sec (2022) 445 final} - {SWD (2022) 425 final} - {SWD (2022) 426 final} - {SWD (2022) 427 final} - {SWD (2022) 428 final}.



adresojnë të drejtat e viktimave me nevoja specifike për mbrojtje.

Sa i takon politikave në mbrojtje të viktimave të krimit, janë hartuar disa strategji sektoriale dhe ndërsektoriale dhe dokumente politike të ndryshme që përmbajnë qëllime dhe objektiva strategjike në lidhje me të drejtat dhe garancitë për mbështetjen, mbrojtjen dhe rehabilitimin e kategorive të veçanta të viktimave, si: fëmijët, gratë, personat LGBTI+, viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e terrorizimit, viktimat e minoritetit rom dhe egjiptian.

Në strategjitë e miratuara, disa prej masave dhe aktiviteteve të parashikuara adresojnë të drejtat e viktimës, informimin e saj, aksesin në drejtësi, mbrojtjen dhe mbështetjen e grupeve të veçanta të viktimave, bazuar në nevojat e tyre. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian parashikon miratimin e një strategjie për mbrojtjen e viktimave të krimit. Gjatë hartimit të SNMVK-së në sistemin e drejtësisë penale është mbajtur në konsideratë që masat dhe veprimtaritë e parashikuara në strategjitë ekzistuese të mbahen, me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe ku ka vend të kryhet harmonizimi i masave.

Në lidhje me kuadrin institucional për mbrojtjen e viktimave të krimit, janë disa institucione në nivel qendror dhe vendor, publike dhe private, që funksionojnë në mbrojtje dhe mbështetje të viktimave të ndryshme të krimit. Në nivel qendror, Avokati i Popullit (AP) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) kontribuojnë në monitorimin e të drejtave të viktimave ose që mund të jenë viktimat të shkeljes së të drejtave të njeriut. Po ashtu, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, monitoron respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve që mund të shkaktojnë viktimat të torturës ose të formave të tjera të keqtrajtimet. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF) është krijuar dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë²⁹. Nga muajt janar 2018 në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur një strukturë e posaçme për ndihmën ndaj subjekteve me status të posaçëm me përbërje prokurorë dhe ndihmës/psikologë dhe në prokuroritë e shkallës së parë Tiranë dhe Durrës u

caktuan funksionet koordinator/psikolog i viktimave. Prej vitit 2019, janë caktuar koordinatorë/psikologë të viktimave në të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm³⁰. Koordinator i viktimës asiston kryesisht në çështjet e dhunës në familje, të miturit viktimat dhe dëshmitarë, si dhe në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, asistojnë viktimat, për të njohur të drejtat e tyre, si dhe marrin masa që viktimat të mos i nënshtrohen viktimizimit të dytë nga autori, aktorët shtetërorë ose ofruesit e shërbimeve për viktimat. Aktualisht, janë të emëruar 18 koordinatorë për viktimat pranë prokurorive, pas miratimit të hartës së re gjyqësore.³¹

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është ministria përgjegjëse për hartimin e politikave të mbrojtjes sociale dhe të shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë viktimat e krimit. Sektori i Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pranë MSHMS-së harton politikat dhe programet që kanë të bëjnë me çështjet e fëmijëve, grave, personave me aftësi të kufizuara, personave të komunitetit LGBTI+ dhe minoritetet.

Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore harton dhe miraton politika në lidhje me zbatimin e strategjisë antitrafik. Marrëveshja e Bashkëpunimit “Për funksionimin e mekanizmit kombëtar të referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave” pasi është konsultuar dhe dakordësuar me të gjitha palët, është nënshkruar më datë 26 qershor 2023. Fokusi kryesor i kësaj marrëveshjeje është viktimat dhe mbrojtja e saj, duke shqyrtuar çdo situatë rast pas rasti dhe ndërton disa standarde të pranuar nga të gjithë për mënyrën sesi zhvillohet i gjithë procesi i identifikimit, referimit dhe, më pas, i mbrojtjes së viktimës së trafikimit. Përveç viktimave të trafikimit, kjo marrëveshje merr në mbrojtje edhe viktimat e mundshme të trafikimit, duke synuar kështu ushtrimin e një mbrojtjeje parandaluese për ata persona që mund të jenë viktimat të mundshme trafikimi. Ky është instrumenti më i rëndësishëm për sa i përket identifikimit, referimit, mbrojtjes dhe

²⁹ <https://ndihmajuridike.gov.al/>

³⁰ Udhëzimi me karakter të përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018, i prokurorit të përgjithshëm “Garantimi i

asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”, neni 12.

³¹ Informacioni është përcjellë me email nga Prokuroria e Përgjithshme më datë 19.5.2023.



asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Kjo marrëveshje ka të parashikuar ndër të tjera detyrimeve edhe për MD-në/Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në referim të ligjit të tyre organik, në bashkëpunim me organizatat që ofrojnë asistencë për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, siguron këshillim ligjor, ndihmë juridike parësore dhe dytësore për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, si dhe organizatave që ofrojnë shërbime për to. Ministria e Brendshme sipas VKM-së nr. 604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme” është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës që bashkërendon punën për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit dhe riintegrimin e tyre. Strehëzat për viktimat e trafikimit kanë krijuar Koalicionin e Strehëzave dhe pranë këtij të fundit funksionon një Bord Këshillimor për Viktimat e Trafikimit i përbërë nga të mbijetuarat e trafikimit. Ky bord këshillon strehëzat për adresimin e nevojave specifike të viktimave në lidhje me identifikimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe praktikave të strehimoreve³².

Në nivel qendror, nuk ka një koordinator dhe një mekanizëm koordinues kombëtar të vetëm për viktimat e krimit, por ka koordinatorë dhe mekanizma kombëtarë për grupe të veçanta të viktimave. Në nivel qendror, funksionon Mekanizmi Kombëtar i Barazisë Gjimore³³ pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për sa u përket të drejtave të fëmijëve, Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor i krijuar për të bashkërenduar punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.³⁴ Aktualisht, ai funksionon pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë institucione përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të integruara shoqërore për viktimat e krimit nëpërmjet strukturave të posaçme të shërbimeve sociale, njësitë

e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve. Në nivel vendor, funksion Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të dhunës në familje i cili vepron në nivel bashkie, në të 61 bashkitë dhe të njërive administrative. Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë bashkive dhe njërive administrative janë përgjegjëse për fëmijët në nevojë mbrojtje, përfshirë fëmijët viktimë, gjithashtu në nivel lokal janë edhe mekanizmat ndërsektorialë për fëmijët viktimë të dhunës.

Sektori i zhvillimit të shërbimeve të integruara shoqërore, si pjesë e drejtorisë së politikave të kujdesjes sociale dhe të shërbimeve sociale të integruara, pranë MSHMS-së, është përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive dhe programeve të zhvillimit të shërbimeve shoqërore, për realizimin e aktiviteteve për parandalimin, rehabilitimin dhe integrimin e individëve dhe familjeve në nevojë, ku përfshihen dhe kategoritë fëmijët, gratë, viktimat e dhunës në familje dhe dhunës seksuale, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, LGBTI+, komuniteti rom dhe egjiptian³⁵.

Reagimi i institucioneve për mbrojtjen dhe mbështetjen e kategorive të viktimave ka njohur përmirësime.³⁵ Përfshirja e aktorëve të shumtë shtetërorë dhe joshetërorë në nivel qendror dhe vendor është rregulluar në përgjithësi me marrëveshje ose akte të tjera nënligjore. Koordinimi dhe bashkërendimi mes tyre paraqet probleme në praktikë dhe njëkohësisht është një sfidë në punën e institucioneve.

Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor është parashikuar si një ndër objektivat e strategjisë.

Sa u takon shërbimeve të kujdesjes shoqërore për viktimat e krimit, legjislacioni parashikon ofrimin e shërbimeve të integruara për viktimat e krimit. Shtrirja e tyre në të gjithë territorin dhe ofrimi i shërbimeve sipas nevojave specifike të viktimave mbetet një sfidë. Studimi “Hartëzimi i Shërbimeve

³² Shih: <https://www.state.gov/reports/2022-trafficking-in-persons-report/albania/>

³³ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030, Planin e Veprimit të Luftës kundër Terrorizmit, Raporti i monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për personat e komunitetit LGBTI (2016–2020), f. 25.

³⁴ Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 35.

³⁵ Analiza do të bazohet në vlerësimet dhe gjetjet e paraqitura në raporte të ndryshme në lidhje me qasjen e institucioneve në lidhje me trajtimin e viktimës respektimin e dinjitetit, asistencën, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimës së krimit.



Sociale në Shqipëri”³⁶, nxjerr në pah se, në një pjesë të mirë të bashkive të vendit, mungojnë shërbimet për të rinjtë e përjashtuar, për viktimat e trafikimit, për të rinjtë në konflikt me ligjin, për viktimat e dhunës në familje dhe familjet në nevojë, për personat e moshuar³⁷, si dhe grupe të tjera të viktimave të krimit.

Në lidhje me masat mbi informimin, sensibilizimin, ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve dhe shoqërisë civile në mbrojtje të viktimave të krimit, sipas raport-analizës së gjendjes së viktimave në Shqipëri, janë krijuar dhe funksionojnë disa rrjete si: rrjeti për fuqizimin e grave, rrjeti kundër trafikimit të qenieve njerëzore, koalicioni i strehëzave antitrafikim, rrjeti i organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore dhe një platformë *online*³⁸, të cilat ofrojnë informacione në lidhje me legjislacionin, rekomandime të mekanizmave monitorues në fushë. Sigurimi i ndihmës juridike falas *online* për të mbijetuarit e dhunës dhe trajnim i avancuar me studentë të drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike falas, janë aktivitete të këtij rrjeti. Publikime me interes në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së viktimave janë të botuara në këtë platformë.

Çdo vit zhvillohen fushata të ndërgjegjësimin të publikut kundër dhunës me bazë gjinore, në kuadër të 16 ditëve ndërkombëtare të aktivizimit apo dhe koordinimit të fushatave që adresojnë stereotipat gjinore dhe praktikat tradicionale të dëmshme. Në muajin shkurt 2023, për herë të parë Ministria e Drejtësisë organizoi një takim në kuadër të Ditës Evropiane të Viktimave të Krimit³⁹ dhe u lançua nisma e fillimit të hartimit të Strategjisë Ndërsëktoriale për Viktimat e Krimit. Ky takim bëri bashkë të gjithë profesionistët, ekspertët e botës

akademike, shoqërinë civile, OJF-të, mediat, grupet e viktimave, si dhe organizatat që i përfaqësojnë ato, me qëllim forcimin e bashkëpunimit për të mundësuar drejtësi për çdo viktimmë.

Drejtoria e Ndihmës Juridike ka zhvilluar aktivitete për të informuar viktimat në lidhje me ndihmën juridike, kryesisht viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit. Vrojtime kombëtare janë kryer në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, dhunën ndaj fëmijëve, gjuhën e urrejtjes.

Për të luftuar fenomenin e “gjuhës së urrejtjes” në të gjitha dimensionet që ai shfaqet në shoqërinë shqiptare, në vitin 2020 u krijua Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes në të cilin përfshihen: Avokati i Popullit (AP), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) dhe Këshilli Shqiptar i Medias.⁴⁰ Avokatit i Popullit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike hartuan udhëzuesin “Për parandalimin dhe adresimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës në institucionet e administratës shtetërore”⁴¹.

Forumi i Shqipërisë civile për komunitetin LGBTI+,⁴² është një mundësi e mirë për forcimin e bashkëpunimit mes parlamentarëve dhe organizatave që përfaqësojnë komunitetin LGBTI+.

Gjatë viteve të fundit viktimat dhe mbrojtja e tyre kanë qenë më shumë në fokus të Kuvendit të Shqipërisë. Disa komisione dhe nënkomisione parlamentare dhe grupimet parlamentare vullnetare janë të angazhuara në këtë fushë. Disa rezoluta të Kuvendit të Shqipërisë adresojnë rekomandime konkrete për institucionet dhe organet e pavarura që raportojnë në Kuvend. Referuar Raportit të Analizës, bashkëpunimi mes institucioneve është rritur dhe duhet të vijojë të konsolidohet⁴³, po ashtu

³⁶ Studimi “Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri”, botim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe PNUD, Tiranë, 2021. Shih: <https://www.undp.org/albania/publications/mapping-social-services-albania>

³⁷ Po aty, f. 22.

³⁸ Nisma e Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare. Shih: <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/projekti/>.

³⁹ Veprimtaria u zhvillua më datën 20 shkurt 2023.

⁴⁰ Memorandumi i Bashkëpunimit mbi Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes” u nënshkrua në dhjetor 2019.

⁴¹ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimtaris%20>

[C3%AB%20s%C3%AB%20institucionit%20t%C3%AB%20AP%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimtaris%20)

⁴² Shih: <https://www.parlament.al/News/Index/5095>

⁴³ Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet rezolutës së miratuar më datë 7.7.2021, i ka kërkuar institucionit të Avokatit të Popullit hartimin e një raporti mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri. Raporti i hartuar për çështjet e dhunës në familje dhe ndaj grave për periudhën janar 2020–shtator 2021, dërguar Kuvendit të Shqipërisë.

Shih: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/rep>



dhe roli i Kuvendit të Shqipërisë për monitorimin sistematik të zbatimit të rekomandimeve të mekanizmave monitorues nga institucionet të cilëve u janë adresuar.

Viktimat e krimit sipas statistikave zyrtare

Statistikat zyrtare të policisë, prokurorisë, gjykatave dhe organeve të tjera që ligji i ngarkon me përgjegjësi për menaxhim të rasteve (viktima të dhunës në familje, të fëmijëve viktimat, viktimat të trafikimit ose viktimat të mundshme të trafikimit etj.) përmbajnë të dhëna për disa kategori viktimash. Të dhënat zyrtare të publikuara nuk japin të dhëna të plota, të sakta për profilin e viktimave, marrëdhëniet e viktimës me autorin, dëmet e shkaktuara viktimës dhe kostot e veprës penale etj.

Gjatë periudhës 2018–2022, janë regjistruar 86348 viktimat të veprave penale, nga të cilat 23505 janë femra.⁴⁴ Sipas të dhënave të policisë, numri i viktimave të veprave penale ka ardhur në rënie gjatë periudhës 2016–2022, ndërsa viktimat e krimeve seksuale, të veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes janë rritur.⁴⁵ Pjesa e madhe e viktimave janë meshkuj të rritur. Gratë dhe vajzat janë më shumë viktimat të veprave penale të dhunës në familje, të krimeve seksuale dhe veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit. Në vitin 2022, 40% e personave të dëmtuar për krime kundër personit ishin femra, kryesisht viktimat të krimeve seksuale, krimeve kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, si edhe krimeve kundër moralit dhe dinjitetit.⁴⁶ Sipas të dhënave të prokurorisë,⁴⁷ gjatë vitit 2022, janë regjistruar 873 viktimat të mitur, nga të cilët 310 vajza dhe 563 djem.

INSTAT-i boton të dhëna për gratë dhe burrat në Shqipëri sipas viteve, përfshirë të dhëna më të

detajuara për gjininë dhe moshën e viktimave sipas grupeve të veprave penale⁴⁸ dhe të dhëna për fëmijët viktimat të disa veprave penale, të ndara sipas gjinisë.⁴⁹ Gjatë periudhës 2019–2021, janë regjistruar 3390 fëmijë të grup-moshës 0–17 vjeç viktimat të veprës penale. Fëmijët përbëjnë 5.8–6.7% të numrit total të viktimave të veprës penale. Numri më i madh i fëmijëve viktimat janë meshkuj. Fëmijët viktimat ose viktimat të mundshme të trafikimit zënë përqindje më të madhe në totalin e viktimave (349 viktimat)⁵⁰ dhe dy fëmijë janë viktimat të vrasjes.

Të dhënat për rastet e dhunës në familje të menaxhuara në nivelin vendor mundësohen nga sistemi REVALB. Popullimi i sistemit me të dhëna të plota në kohë, si dhe bashkërendimi me sistemet e tjera të të dhënave mbetet një sfidë. Statistikat zyrtare të Ministrisë të Drejtësisë përmbajnë të dhëna për rastet e dhunës në familje dhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.⁵¹

Statistikat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve përmbajnë të dhëna për të dënuarit për disa vepra penale që shkaktojnë viktimat, si: vjedhje, vrasje, plagosje, mashtrim, por jo vepra të tjera specifike. Numri i personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim për veprat penale të marrëdhënies seksuale me dhunë dhe shfrytëzim prostitucioni është i ulët.⁵² Mungojnë të dhënat e publikuara për viktimat e abuzimit të pushtetit, viktimat që kanë marrë dëmshpërblim ose kompensim të dëmit dhe shumat e përfituara.

Të dhënat për viktimat e krimit janë fragmentare, nuk publikohen në kohë dhe për të gjitha kategoritë e viktimave. Raportimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje bëhet me mënyra të ndryshme

[https://www.instat.gov.al/raport%20monitorim%20dhuna%20janar%202020%20-%20shtator%202022\[1164\].pdf](https://www.instat.gov.al/raport%20monitorim%20dhuna%20janar%202020%20-%20shtator%202022[1164].pdf)

⁴⁴ Shih: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/krimet-dhe-drejt%C3%ABsia-penale/#tab2>

⁴⁵ Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2022 <https://www.instat.gov.al/media/11505/statistikat-e-krimeve-dhe-drejt%C3%ABsis%C3%AB-penale-2022.pdf>

⁴⁶ Po aty, f. 4.

⁴⁷ Raporti i prokurorit të përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit, viti 2022, f. 19.

⁴⁸ Shih: <https://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

⁴⁹ Shih: <https://www.instat.gov.al/al/statistika-zyrtare-femije-dhe-te-rinj/drejt%C3%ABsia/>

Faqe | 22224

⁵⁰ Gjatë periudhës 2019–2021, fëmijët viktimat ose viktimat të mundshme të trafikimit përbënin 65%–70.4% të totalit të viktimave dhe ka shënuar një prirje në rritje.

⁵¹ Vjetari statistikor 2021, botimi i Ministrisë së Drejtësisë, f. 345–367. Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/REPUBLIKA-E-SHIQIP%C3%8BRIS%C3%8B-Vjetari-Statistikor-2021-pdf.pdf>

⁵² Në muajin prill 2023, 24 persona ishin të paraburgosur dhe 20 të dënuar për marrëdhënie seksuale dhe 1 persona të paraburgosur dhe 32 të dënuar për shfrytëzim prostitucioni. Për më shumë shih: <https://dpbsh.gov.al/te-dhena-statistikore-te-sistemit-te-burgjeve/>



dhe subjekte të ndryshme.⁵³ Të dhënat për viktimat e krimit kanë nevojë të bashkërendohen. Gjithashtu, të dhënat zyrtare për personat e dënuar ose nën mbikëqyrje tregojnë se një pjesë jo e vogël e autorëve të veprave penale me viktimë gratë, fëmijët etj. janë përjashtuar nga dënimi me burgim ose janë liruar me kushte dhe janë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës.

Shqipëria ka marrë pjesë për herë të parë në anketën ndërkombëtare të viktimave të krimit në vitin 1996⁵⁴ dhe në vitin 2000 në anketën ndërkombëtare të viktimave të krimit dhe viktimave në fushën e biznesit. Pjesëmarrja e Shqipërisë në anketa nuk është sistematike. Shqipëria kontribuon në botimin evropian për statistikat e krimit dhe sistemin e drejtësisë penale,⁵⁵ në studimet e UNODC-së për viktimat e vrasjeve, të krimeve me bazë gjinore, viktimave të trafikimit, etj.⁵⁶ Në nivel kombëtar, janë zhvilluar anketa për dhunë me bazë gjinore, dhunën ndaj fëmijëve, gjuhën e urrejtjes.⁵⁷ Studime më të shumta janë kryer për viktimat e dhunës në familje, femicidin, fëmijët viktimë, nga INSTAT-i në bashkëpunim me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë. OJF-të që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve janë më aktive në studimet dhe botime për gratë dhe fëmijët viktimë të krimit.

Mitologjia e mbledhjes, përpunimit dhe

publikimit të statistikave është e rregulluar me akte nënligjore por ato nuk janë të standardizuara. Shpesh të dhëna specifike për viktimat nuk mbledhen, nuk përpunohen ose nuk botohen në mënyrë sistematike. Të dhënat për viktimat e dhunës me bazë gjinore janë më të plota.

Policia mbledh dhe përpunon të dhëna për viktimat e krimit. Një pjesë e tyre botohen nga INSTAT-i⁵⁸. Duke filluar nga viti 2021, Prokuroria e Përgjithshme boton të dhëna për viktimat si përqindja e viktimave të grupeve të veprave penale sipas gjinisë dhe moshës (të mitur/të rritur), kostoja e hetimit, por jo profili i viktimës dhe marrëdhënien autor-viktimë, dëmet e pësuar nga vepra penale⁵⁹. Në vitin 2020, prokurori i përgjithshëm ka miratuar udhëzimin me karakter të përgjithshëm i cili parashikon detyrimin e oficerit të policisë gjyqësore të plotësojë kartelën me të dhëna të plota, përfshirë të dhënat për viktimën, formati i së cilës është miratuar si shtojcë e udhëzimit.⁶⁰ Prokuroria nuk ka një sistem kompjuterik funksional statistikor⁶¹. Urdhri i prokurorit të përgjithshëm për mbajtjen dhe raportin e dhënave për çështjet me të mitur, nuk parashikon mbledhjen e të dhënave për veprat penale me të mitur të kryera sipas motiveve⁶². Të dhënat për veprat penale të kryera për motive urrejtjeje, kur motivi është rrethanë rënduese mungojnë.

⁵³ Viktima e dhunës në familje ose formave të tjera të dhunës me bazë gjinore mund të raportojë në polici, te koordinatorët vendorë në bashki ose njësinë administrative, mes Linjës Kombëtare të Këshillimit 116 117, aplikacionin digital Bright Sky; fëmijët mund të raportojnë edhe mes linjës AALO 116, viktimat e krimeve të urrejtjes mund të raportojnë edhe mes platformës online: isigurt@crca.al ofruar nga CRCA/ECPAT.

⁵⁴

https://www.unodc.org/pdf/crime/icvs/research_codebook_ICVS.PDF.

⁵⁵ Shih: <https://wp.unil.ch/europeansourcebook/>

⁵⁶ Shih: <https://dataunodc.un.org/>

⁵⁷ Anketa “Përtej përkufizimeve thirrje kundër gjuhës së urrejtjes, Tiranë 2021. Shih: <https://rm.coe.int/beyond-definitions-alb/1680a465f8>. Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri. Shih:

<http://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf>. Byrne K., Kulluri E., Gedeshi I., 2021. Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Adoleshentëve në Shqipëri. UNICEF Shqipëri, Tiranë. Shih: [https://www.unicef.org/albania/media/4121/file/Situation%20Analysis%20of%20Children%20and%20Adolescent%20in%20Albania%20\(ALB\).pdf](https://www.unicef.org/albania/media/4121/file/Situation%20Analysis%20of%20Children%20and%20Adolescent%20in%20Albania%20(ALB).pdf). Anastasi, A, Hysi, V,

Bozo A, Vora, E, Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativa për femicid në Shqipëri (2017-2020). Shih: <https://www.qag.al.org/publikime/femicidi.pdf>

⁵⁸ Krimit dhe drejtësia: shih: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/krimet-dhe-drejt%C3%ABsia-penale/>

⁵⁹ Raport i prokurorit të përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021, f. 28.

⁶⁰ Udhëzimit me karakter të përgjithshëm i prokurorit të përgjithshëm nr. 17, datë 17.12.2020 “Hetimi dhe ndjekja penale efektive e veprave penale të dhunës në familje, të dhunës ndaj gruas dhe dhunës me bazë urrejtjeje”.

⁶¹ Informacioni i dhënë nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme në përgjigje të kërkesës për informacion në kuadër të përgatitjes së raportit.

⁶² Urdhri i prokurorit të përgjithshëm nr. 124, datë 24.9.2020, “Për përcaktimin e formës së regjistrimit dhe mënyrën e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore të çështjeve me të mitur në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”.

Shih:

https://www.pp.gov.al/Legjislacioni/Akte_Nenligjore/Urdhra_te_Prokurorit_te_Pergjithshem/



Udhëzuesi i hartimit të statistikave të Ministrisë së Drejtësisë nuk përmban udhëzime për mbledhjen e të dhënave për viktimat e veprës penale dhe as sipas motiveve. Në kushte të tilla, nuk ka të dhëna për disa viktimat të krimeve të urrejtjes, motive gjinore, femicidin etj⁶³. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) miratoi udhëzuesin⁶⁴ për mbajtjen e tabelave me të dhënat statistikore në lidhje me produktivitetin dhe eficiencën e gjykatave. Formatet e miratuara mundësojnë të dhëna për seancat, numrin e tyre, kohëzgjatjen e proceseve etj., por jo të dhëna për kriminalitetin, autorët dhe viktimat e tyre ose motivet e kryerjes së veprave penale. Një udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbledhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje, miratuar gjatë vitit 2020⁶⁵, mundëson mbledhjen dhe botimin analitik të disa të dhënave për viktimat e dhunës në familje bazuar në legjislacionin në fuqi për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Sistemi i integruar i të dhënave për çështjet e të miturve që mund të prodhojë statistika të detajuara përfshirë viktimat fëmijë është krijuar, por ende nuk është publikuar ndonjë raport vjetor⁶⁶. Nuk ka një sistem të integruar funksional të të dhënave në Shqipëri që të mundësojë të dhëna të rasteve të

menaxhuara në sistemin e drejtësisë në të gjitha fazat⁶⁷.

INSTAT-i⁶⁸ boton të dhëna vjetore për veprat penale, autorët, viktimat (të dëmtuarit) sipas veprave, në shifra dhe përqindje, sipas gjinisë dhe moshës, por jo sipas vendit ku ka ndodhur vepra penale. Të dhënat janë publike dhe në një format miqësor për publikun. Të dhënat statusore janë më të plota për veprat penale dhe viktimat e mitura, viktimat e dhunës në familje, të krimeve seksuale, për viktimat e trafikimit dhe të mundshme të trafikimit, numri i urdhrave të mbrojtjes.

Krijimi i statistikave të reja dhe publikimi periodik i të dhënave të sakta statistikore për veprat penale të dhunës në familje dhe ndaj fëmijëve është një nga rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë⁶⁹. Institucionet monitoruese⁷⁰ i kanë ftuar autoritetet shqiptare që të përmirësojnë mbledhjen e të dhënave në lidhje me dënimet e dhëna për forma të ndryshme të dhunës ndaj grave, duke i ndarë këto të dhëna në bazë të gjinisë së autorit të veprës penale dhe të viktimës, si dhe të marrëdhënies mes tyre dhe të sigurojnë që të dhënat mbi dënimet të jenë qartazi të lidhura me veprat penale specifike për të cilat janë dhënë, si dhe të përdorin këto të dhëna për të vlerësuar nëse dënimet në rastet e dhunës ndaj grave

⁶³ Udhëzuesi nr. 4, datë 15.4.2019 i ministrit të Drejtësisë “Për plotësimin e të dhënave statistikore”. Shih: <https://drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2019/04/Udh%C3%ABzim-p%C3%ABr-plot%C3%ABsimin-e-formateve.pdf>

⁶⁴ Vendimi nr. 47, datë 11.2.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor për miratimin e udhëzuesit për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe eficiencës së gjykatave”. <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-nr.-47-dat%C3%AB-11.02.2021-p%C3%8Br-miratimin-e-e2%80%9Cudh%C3%8Bzuesi-e2%80%9Cp%C3%8Br-mbajtjen-dhe-plot%C3%8Bsimin-e-tabelave-me-t%C3%8B-dh%C3%8Bna-statistikore-p%C3%8Br-efekt-t%C3%8B-matjes-dhe-monitorimit-t%C3%8B-produktivitetit-dhe-efi%C3%87enc%C3%8Bs-s%C3%8B-gjykatave-e2%80%9De2%80%9D.pdf>

⁶⁵ Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 9, datë 17.6.2020 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”; Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/UDH%C3%8BZIM-I-P%C3%8BRBASHK%C3%8BT-P%C3%8BR-P%C3%8BRCAKTIMIN-E-RREGULLAVE-P%C3%8BR>
Faqe | 22226

[KRIJIMIN-E-NJ%C3%8B-BAZE-T%C3%8B-DH%C3%8BNASH-T%C3%8B-POSA%C3%87ME-P%C3%8BR-C3%87%C3%8BSHTJET-E-DHUN%C3%8BS-N%C3%8B-FAMILJE-B%C3%8B-GJYKATA-DHE-UNIFIKIMIN-E-REGJISTRIMIT-T%C3%8B-TYRE.pdf](https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/krimet-dhe-drejt%C3%ABsia-penale/#tab3)

⁶⁶ Ligji nr. 37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, neni 136 dhe 137.

⁶⁷ Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, neni 92 parashikon krijimin e një sistemi të teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë. Ky sistem nuk është ende funksional.

⁶⁸ Shih: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/krimet-dhe-drejt%C3%ABsia-penale/#tab3>

⁶⁹ Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë datë 14.6.2021 për raportin vjetor të prokurorit të përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit 2021.

⁷⁰ Pjesë nga Raporti fillestar i Vlerësimit të GREVIO-s - Grupi i Ekspertëve për masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – për Shqipërinë, në lidhje me masat legislative dhe të tjera të ndërmarra në zbatim të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (24 Dhjetor 2017). Shih: <https://rrietikunderdhunesgjimore-monitorime.al/2018/01/14/pjesje-nga-raporti-fillestar-i-vleresimit-i-grevio-s/#more-112>



është në përpjesëtim me rëndësinë e veprës penale dhe ruan funksionin e dënimit.

Sa më sipër, metodologjia e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave ka nevojë të rishikohet, bazuar në standardet ndërkombëtare në lidhje me statistikën e krimit dhe viktimat.

Bazuar në gjetjet si më sipër të Raportit të Analizës, janë dhënë disa rekomandime, si më poshtë, të cilat janë adresuar në masa të caktuara, në Strategji:

- Është e rekomandueshme që KPP-ja të parashikojë përkufizimin e viktimës duke përfshirë anëtarët e familjes së saj në kuptimin e përcaktuara nga direktiva 2012/29/BE;

- Rishikimi, përmirësimi i metodologjisë së mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave për viktimat dhe profilin e tyre;

- Standardizimi i të dhënave zyrtare dhe pasurimi i tyre me të dhëna më të detajuara për viktimat dhe publikimi i tyre;

- Botimi i statistikave për të gjitha viktimat e krimeve, në formate miqësore dhe kuptueshme për përdoruesit e gjerë dhe kërkuesit në fushë;

- Zhvillimi i anketave kombëtare në mënyrë periodike për matjen e niveli të viktimizimit nga krimi në përgjithësi dhe për kategori të veçanta të viktimave;

- Mbledhja e të dhënave për raportimin e viktimave të adresuara në institucione të tjera, nga ato të policisë, prokurorisë dhe gjykatave;

- Publikimi i të dhënave për dënimin dhe masat alternative të dënimit me burgim të autorëve për veprat penale, si: dhuna në familje, trafikimit, dhuna seksuale, shfrytëzimi për prostitucion, keqtrajtimi i fëmijës etj., duke i ndarë të dhënat në bazë të gjinisë së autorit të veprës penale dhe të viktimës, të marrëdhënies mes tyre dhe të sigurojnë që të dhënat mbi dënimet të jenë qartazi të lidhura me veprat penale;

- Vijimi i konsolidimit të bashkëpunimit me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë në lidhje me përmirësimin e statistikave dhe për trajnimin e personelit që punon në këtë fushë;

- Vijimin i kontribuimit në studimet ndërkombëtare dhe rajonale të viktimave të krimit;

- Shkëmbimi i përvojave pozitive me

institucionet homologe të vendeve evropiane në lidhje me përmirësimin e standardeve dhe mundësinë e krahasimit të statistikave për viktimat e krimit.

Gjithashtu, statistikën dhe treguesit gjinorë sipas grup-moshave do të jenë pjesë integrale e integritetit gjinor për të gjitha fushat e politikave të kësaj strategjie. Së pari, këta tregues gjinorë do të shërbejnë për procesin e politikëbërjes dhe do të sigurojnë që ndërhyrjet t'u përgjigjen nevojave dhe prioriteteve të ndryshme të mbrojtjes së grave dhe burrave, viktimat të krimit. Së dyti, statistikën dhe treguesit gjinorë do të jenë një pjesë thelbësore e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit dhe rezultateve të politikave, masave dhe aktiviteteve.

Për këtë qëllim të dhënat e zbatimit të SNMVK 2024–2030, do të jenë:

- të mbledhura dhe të paraqitura të ndara sipas gjinisë dhe grup-moshës si klasifikim parësor dhe i përgjithshëm;

- metodat e mbledhjes së të dhënave do të marrin në konsideratë stereotipat, faktorët socialë dhe kulturorë që mund të nxisin paragjykimet gjinore në lidhje me mbrojtjen e viktimave të krimit.

Lidhur me raportimin e viktimave, procedimi penal dhe proceset gjyqësore

Lidhur me raportimin, procedimin penal dhe proceset gjyqësore, është konstatuar se, udhëzimet e miratuara në lidhje me raportimin e krimit dhe krijimin e një mjedisi miqësor për raportimin e viktimave kanë ndikuar në rritjen e raportimeve të dhunës në familje. Megjithatë, një pjesë e tyre mbeten të paraportuara. Disa viktimat, si: viktimat e dhunës në familje, të dhunës seksuale, personat LGBTI+, raportojnë në qendrat që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për viktimat. Gratë dhe fëmijët janë më shpesh viktimat të dhunës në familjes, të krimeve seksuale dhe të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime shfrytëzimi për prostitucion⁷¹. Gjatë periudhës 2016–2020, gratë përbëjnë numrin më të madh të viktimave të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare (57.9–88.1% të viktimave të vrasjeve)⁷². Pandemia COVID-19 nxori në pah rritje të dhunës nga partnerët apo pjesëtarët e tjerë të familjes dhe vështirësitë e hasura nga viktimat për të raportuar krimin, për të pasur qasje te shërbimet

⁷¹ Sipas anketës, burra dhe gra, në vitin 2020, gratë përbënin 86.4 % të viktimave të krimeve seksuale dhe 67.1%

të veprës penale të dhunës në familje, f. 94. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

⁷² Po aty, f. 97.



juridike dhe shoqërore. Të dhënat e policisë nuk mundësojnë njohjen reale të viktimave të krimit. Ndërturja mes të dhënave zyrtare të policisë dhe anketave të viktimave mund të hedhin dritë për nivelin e veprave penale të paraportuara.

Raportimi i viktimave të krimit është i ulët edhe në institucione të tjera. Gjatë periudhës 2020–2023, nga 63 raste dhune (të gjitha format e dhunës) të trajtuara nga Avokati i Popullit me viktimë të mitur, 60 raste janë me iniciativë dhe vetëm 3 raste janë trajtuar bazuar në një ankesë⁷³. Disa forma të dhunës, si: dhuna seksuale, dhuna ndaj personave të vendosur në institucionet e përkujdesjes shoqërore raportohet pak⁷⁴. Anketa dhe studime të kryera tregojnë si disa kategori viktimash, si: viktimat e dhunës në familje, dhunës seksuale ose personat LGBTI+⁷⁵ nuk raportojnë veprën penale në polici, prokurori ose gjykatë. Studim i kryer në vitin 2018⁷⁶ tregoi se anëtarët e komunitetit LGBTI+ nuk raportojnë dhunën nga frika se mos do të paragjykojnë për shkak të orientimit ose nëse do të denoncin asgjë nuk do ndryshonte. Të rinjtë transeksuale përfshihen dy deri tri herë më shumë diskriminim krahasuar me të rinjtë gejt, biseksuale ose lezbikë⁷⁷. Rrethi i gjerë i personave që mund të raportojnë dhe vënë në lëvizje institucionet dikton nevojën e informimit, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimin të tyre për të raportuar veprat penale.

Veprimtaritë informuese, ndërgjegjësuere për raportimin e veprave penale, lehtësimi i procedurave për raportimin, krijimi i një mjedisi miqësor për raportim dhe rritja e besimit të viktimave tek institucionet janë adresuar në masa konkrete, në SNMVK.

Vëmendja ndaj viktimës dhe të drejtave të saj në të gjitha fazat e procedimeve penale ka ardhur në

rritje gjatë viteve të fundit. Institucione, shoqëria civile dhe media janë më aktive në adresimin e çështjeve që lidhen me viktimat. Ndiurma ligjore e garantuar nga shteti dhe mbështetja psikologjike falas për disa kategori të viktimave është mundësuar me ligjin e vitit 2017⁷⁸ dhe me përfshirjen e koordinatorëve të viktimave pranë prokurorive dhe psikologëve mbështetës në komisaritetet e policisë dhe në gjykata. Prokuroria është më proaktive në fillimin kryesisht të procedimeve penale dhe numri i tyre ka ardhur në rritje⁷⁹.

Bazuar në rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, prokurori i përgjithshëm (PP) ka miratuar disa udhëzime me karakter të përgjithshëm për trajtimin e viktimave të veprave penale dhe hetimin e disa veprave penale që shkaktojnë viktima, si viktimat e dhunës në familje, krimet e urrejtjes. Bashkëpunimi me shoqërinë civile në lidhje me trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore është rritur.

Efektiviteti i procedimeve penale mundëson drejtësi për viktimat dhe ndikon në rritjen e besimit të saj te drejtësia. Analiza e procedimeve penale për grupe të veprave penale si krimet kundër jetës të kryera me dashje, krimet kundër personit të kryera me dashje, krimet seksuale dhe ngacmimet seksuale kundër fëmijëve, shfrytëzimi për prostitucion, trafikimi i qenieve njerëzore vë në pah një diferencë mes procedimeve penale të regjistruara dhe atyre të dërguara në gjykatë, si dhe mes numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe atyre të dënuar, sidomos në rastin e krimeve seksuale ndaj të miturve. Numri i procedimeve të pezulluara për vepra penale të sipërcituara janë relativisht të larta në vitin 2022 sidomos për grup-veprat kundër moralit dhe dinjitetit (21.2%) ose për krimet seksuale dhe

⁷³ Informacion i përcjellë me *email* nga Avokati i Popullit, maj 2023. Sipas informacionit një ankesë është paraqitur nga vetë fëmija, një ankesë nga organizatat e shoqërisë civile dhe një ankesë nga person i rritur.

⁷⁴ Nga 63 raste të dhunës ndaj fëmijëve të trajtuar nga Avokati i Popullit gjatë periudhës 2020–2023, 24 raste të ishin për abuzim ose shfrytëzimi seksual të fëmijës, 10 raste të ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare, 29 raste të ushtrimit të dhunës në institucionet e edukimit, komunitet, institucione të përkujdesjes shoqërore etj.

⁷⁵ Sipas një studimi të kryer nga Aleanca LGBTI, në vitin 2020, rezultoi se 23.5% e pjesëmarrësve në pyetësor renditën si arsye për mosdenoncimin e situatës së dhunës/diskriminimit, stepjen dhe frikën për të treguar

hapur orientimin seksual/identitetin gjinor/karakteristikat dhe zakonet seksuale, për shkak të paragjyqimeve që mund të shfaqin aktorët shtetërorë ose pasojat që ky vetekspozim mund të sjellë në jetën e tyre. Shih: <https://www.aleanca-lgbt.org/lajme/76-diskriminimi-dhe-dhuna-me-baze-orientimin-seksual-dhe-identitetin-gjinor>.

⁷⁶ Pengesat e hasura nga komuniteti LGBTI në marrjen e shërbimeve ligjore dhe aksesit në drejtësi, studim, SREHA, 2018, f. 24.

⁷⁷ Po aty, f. 32.

⁷⁸ Ligj nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

⁷⁹ Raportet vjetore të prokurorit të përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri.



ngacmimet seksuale të të miturve (11.7%)⁸⁰. Sipas të dhënave të Prokurorisë së Përgjithshme gjatë viteve 2021 dhe 2022 janë regjistruar respektivisht 10 dhe 11 procedime penale për trafikimin e personave të rritur dhe të mitur dhe janë dënuar respektivisht 12 persona në vitin 2021 dhe vetëm 1 person në vitin 2022⁸¹.

Mjedisi për pritjen dhe marrjen e kallëzimit nga viktimat jo gjithnjë është miqësor për të. Ndonëse janë krijuar disa mjedise miqësore në polici, prokurori ose gjykata, ato nuk janë të aksesueshme për çdo viktimë në të gjithë territorin. Ka disa përmirësime në lidhje me krijimin e qendrave të ofrimit të shërbimeve në një vend, veçanërisht për viktimat fëmijë të abuzimeve seksuale.

Në përgjithësi, dënimet dhe masat penale të parashikuara në KP janë proporcionale me rrezikshmërinë e veprave penale dhe pasojat e shkaktuara viktimës. Politika penale në praktikë jo gjithnjë është proporcionale me rrezikshmërinë e veprës dhe pasojat e shkaktuara viktimës. KP-ja parashikon mundësinë e përjashtimit nga dënimi për viktimën e veprave penale që lidhen me trafikimin e personit në rast të kryerjes së veprës penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë e detyruar t'i kryejë ato veprime ose mosveprime të kundërligjshme. Lirimi me kusht i autorëve të veprave penale, si: vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare ose marrëdhënieve seksuale me të mitur që kanë sjellë vetëvrasjen ose vdekjen e tij nuk përfitojnë lirim me kusht. Gjykata në dhënien e vendimit mund të vendosë një periudhë sigurie gjatë së cilës mund lejohet zbatimi i lirit me kusht. Ligjvënës i në miratimin e amnistive gjatë viteve të fundit ka treguar kujdes të shmangë amnistimin e ndjekjes penale ose të dënimit tërësisht ose pjesërisht për veprat penale që shkaktojnë disa kategori viktimash si gratë, fëmijët etj.

Studime të ndryshme analizojnë politikën penale të zbatuar nga gjykatat në rastet e viktimave të trafikimit, të dhunës në familje, të femicidit etj. Zbatimi i politikës penale në praktikë dhe drejtësia për viktimat ka nevojë të vlerësohet në mënyrë sistematike dhe të pavarur, bazuar në studime shkencore.

Rimbursimi i shpenzimeve të viktimës për

pjesëmarrje në procesin penal nuk garantohej në praktikë. Raport-analiza theksoi nevojën për përmirësime ligjore dhe garantimin në praktikë të së drejtës së rimbursimit të shpenzimeve të viktimave.

E drejta e kthimit të pasurisë së bllokuar të viktimës menjëherë dhe kur nuk është e nevojshme të mbahet për qëllime të procedimit penal vijon të jetë problem, thekson Raporti i Analizës.

Kompensimi i viktimës nga autori i veprës penale është e rregulluar me ligj, por rastet e zbatimit të saj janë shumë të pakta.

Nisur nga gjetjet e Raportit të Analizës, si më sipër, Strategjia adreson masa mbi:

- Vlerësimin periodik të nivelit të raportimit të krimit nga viktimat, të barrierave dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre;

- Promovimin e raportimeve *online* dhe përfshirjen e numrave të linjave të raportimit në fushatat informuese dhe sensibilizuese;

- Vlerësimin periodik të efektivitetit të procedimeve penale dhe politikës penale në raport me viktimat dhe pasojat e shkaktuara;

- Vlerësimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me efektivitetin e masave dhe dënimeve penale të zbatuara ndaj të dënuarve;

- Inkurajimi i prokurorëve dhe i gjyqtarëve për të zbatuar një politikë dënimi proporcionale me rrezikshmërinë e veprave penale;

- Rritjen e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimin të institucioneve dhe profesionistëve, OJF-ve që ofrojnë shërbime për viktimat për të kallëzuar veprat penale, veçanërisht rastet e dhunës për shkak të marrëdhënieve familjare dhe dhunën me bazë gjinore, abuzimet seksuale, rastet e mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit për prostitucion, punën e detyruar, keqtrajtimin e fëmijëve etj.

Lidhur me të drejtat për informimin dhe mbështetjen e viktimës

Analiza e situatës aktuale të viktimave, në Shqipëri, lidhur me të drejtat për informim dhe mbështetjen e viktimës, konstaton se, karta e të drejtave të viktimës dhe caktimi i koordinatorit të viktimës në prokurori përbëjnë zhvillime pozitive për informimin dhe për të asistuar viktimën. Karta është e hartuar në gjuhë ligjore dhe nuk është e kuptueshme nga çdo viktimë.

⁸⁰ Raport vjetor i prokurorit të përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri, 2022, faqet 87, 91, 98, 99-100 dhe 107.

⁸¹ Po aty, f. 264.



Ligji parashikon të drejta shtesë për viktimën e mitur, viktimën e shfrytëzuar seksualisht, viktimat e trafikimit dhe të dhunës në familje. Legjislacioni ka nevojë për përmirësime për të garantuar më mirë këto të drejta për kategoritë e tjera të viktimave. Garantimi në praktikë i së drejtës për informim të viktimës, bazuar në veçoritë e saj ka nevojë të përmirësohet.

Po ashtu, aksesit i viktimave të shërbimet mbështetëse, sipas nevojave specifike të saj, është e garantuar me ligj.

Programet e drejtësisë restauruese, të sigurta për viktimën zbatohen jomjaftueshëm. Ato nuk janë të shtrira në të gjithë territorin. Informimi i viktimës për to dhe zbatimi i programeve në interesin më të lartë të viktimës dhe sipas standardeve të parashikuara në ligj mbetet ende një sfidë.

Standardet dhe procedurat e shërbimeve janë miratuar. Shërbimet mbështetëse të integruara për viktimat nuk janë të shtrira në të gjithë territorin e vendit dhe ato ekzistuese kanë nevojë të forcohen me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.

Shërbimet mbështetëse në Shqipëri, publike dhe private ofrojnë informacion, këshillim ligjor, psikologjik dhe vlerësojnë nevojat specifike të viktimave. Organizatat e shoqërisë civile kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve. Ndonëse ka një rritje të buxhetit të shtetit për mbështetjen e shërbimeve të ofruara për viktimat, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në partneritet me organizatat jofitimprurëse, konstatohet nevoja për rritjen e saj. Linjat *online* të këshillimit të viktimave lehtësojnë ofrimin e shërbimeve këshilluese për viktimat. Ato kanë nevojë të njihen, të përdoren më gjerësisht nga viktimat në të gjithë territorin dhe mbështetja financiare për to nga buxheti i shtetit ka nevojë të rritet.

Forcimi i kapacitetet të profesionistëve që janë në kontakt të parë me viktimat është një sfidë.

Vlerësimi dhe identifikimi i viktimave të abuzimit seksual dhe të shfrytëzimit seksual të viktimave të trafikimit, jo gjithnjë mundëson identifikimin e viktimës dhe, për rrjedhojë, viktimat mund të mos përfitojnë nga shërbimet mbështetëse për ta.

Lidhur me pjesëmarrjen e viktimave në procedimet penale

Lidhur me pjesëmarrjen e viktimave në procedimet penale, mundësia për t'u dëgjuar, e drejta për t'u informuar për vendimet që merren, e drejta për t'u njoftuar dhe ankim në rastin e

mosfillimit të procedimit, pushimit të akuzës ose çështjes penale, e drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike kur e ka të nevojshme garantohen nga ligji. Raporti i analizës konstaton se, legjislacioni ka nevojë për disa përmirësime që të garantojë të drejtën e pjesëmarrjes të çdo viktime që ka rol në proces.

E drejta e pjesëmarrjes së viktimës jo gjithnjë garantohet për të gjitha viktimat në praktikë. Njohja e të drejtave nga viktimat dhe heqja e pengesave në ushtrimin e tyre është një sfidë është adresuar në këtë strategji.

Ligji parashikon të drejta shtesë për viktimën e mitur, viktimën e shfrytëzuar seksualisht, viktimat e trafikimit dhe të dhunës në familje. Legjislacioni ka nevojë për përmirësime për të garantuar më mirë këto të drejta për kategoritë e tjera të viktimave. Garantimi në praktikë i së drejtës për informim të viktimës, bazuar në veçoritë e saj ka nevojë të përmirësohet.

Strategjia, bazuar në gjetjet e analizës, adreson masa për të garantuar në praktikë të drejtën për rimbursimin e shpenzimeve të viktimës, për pjesëmarrje në procesin penal, po ashtu edhe lidhur me të drejtë e kthimit të pasurisë së bllokuar të viktimës menjëherë dhe kur nuk është e nevojshme të mbahet për qëllime të procedimit penal.

Kompensimi i viktimës nga autori i veprës penale është e rregulluar me ligj, por rastet e zbatimit të saj janë shumë të pakta.

Afatet procedurale, parashikimet ligjore për disa procedura penale (gykimi i shkurtuar etj.), ndërgjegjësimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve për të kompensuar viktimën gjatë procesit penal dhe lehtësuar barrën për ndjekjen e procedurave civile, janë adresuar në këtë strategji.

Garantimi i të drejtave të viktimave që janë rezidentë në një shtet tjetër është një sfidë tjetër, përmes përmirësimeve të kuadrit ligjor dhe praktikave të mira të bashkëpunimit në fushën penale.

Lidhur me mbrojtjen e viktimave dhe njohjen e viktimave me nevoja të veçanta për mbrojtje

Sa i takon mbrojtjes së viktimave dhe njohjes së viktimave me nevoja të veçanta për mbrojtje konstatohet se kuadri ligjor, në lidhje me dhunën në familje, abuzimin dhe dhunën seksuale është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit në përpjekje për ta harmonizuar me kërkesat e standardeve



ndërkombëtare. Megjithatë, ende mbeten disa problematika në lidhje me parashikimet ligjore për krimet seksuale.

KPP-ja dhe KDPM-ja parashikojnë masa për mbrojtjen e viktimave nga viktimizimi i dytë dhe i përsëritur. Mbrojtja e anëtarëve të familjes së viktimave ka nevojë të adresohet më mirë në ligj dhe në praktikë.

Mjetet dhe procedurat e shmangies së kontakteve të viktimës me autorin, sidomos gjatë pyetjes ose kur viktimat duhet të jetë e pranishme në faza të ndryshme të procesit penal, të parashikuara në ligj, duhet të vijojnë të zbatohen rregullisht.

Masat mbrojtëse për viktimat si përdorimi i teknologjisë në pyetje nuk janë gjithnjë të disponueshme për viktimat që kanë nevojë të mbrohen. Në procesin e analizës nuk janë gjetur të dhëna të sakta për numrin e mjediseve të përshtatshme për pyetjen e viktimave, të pajisura me mjetet audio dhe video në prokuroritë dhe gjykatat e përfshira në hartën e re gjyqësore ose komisariatet e policisë dhe rastet e përdorimit të tyre.

Pyetja e viktimës nga i njëjti person është një sfidë tjetër për t'u zbatuar.

Shërbimet e integruara për viktimat e abuzimeve seksuale, modeli dhe standardet tashmë të miratuara, janë shërbimet në qendrat e menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale "Lilium", si dhe qendrat e trajtimit të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës, të ngritura pranë Spitalit Rajonal në Fier dhe në Shkodër, të cilat kanë elemente të shërbimit Barnhaus. Aksesit në to për çdo viktimë dhe ndërgjegjësimi për përdorimin e tyre për çdo viktimë të abuzimit mbetet një sfidë.

Referuar Raportit të Analizës, pyetja pa vonesë e çdo viktime, përfshirë viktimat rezidentë në një shtet tjetër, numrin e limituar të pyetjeve dhe ekzaminimeve mjekësore më të nevojshme për të gjitha viktimat e krimeve të dhunshme janë probleme që hasen në praktikë.

Vetëm disa kategori të viktimave të krimeve të dhunshme kanë të drejtë të shoqërohen nga një person i besuar, i zgjedhur ose i pranuar prej saj. Konstatohet, megjithatë se ka modele pozitive për vlerësimin e riskut të viktimave dhe zbatimin e masave të mbrojtjes së tyre. Por sfidat që hasen në praktikë janë të mëdha.

Pavarësisht garantimit me ligj të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale të viktimës, ato

cenohen shpesh, sidomos në media dhe rrjetet sociale. Mbrojtja e jetës vetjake dhe të dhënave personale të viktimës dhe familjarëve të saj është një sfidë që duhet të adresohet nga të gjitha institucionet, individët, përfshirë medien. Lidhur me këtë, Strategjia parashikon masa/aktivitete të cilat do të ndihmojnë në garantimin e kësaj të drejte.

Lidhur me mbrojtjen e kategorive të veçanta të viktimave të krimit

Raporti i Analizës së situatës aktuale të viktimave të krimit në Shqipëri, ka marrë në konsideratë, gjithashtu, mbrojtjen e kategorive të veçanta të viktimave të krimit. Në këtë drejtim është konstatuar se ka përmirësime në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi seksual dhe pornografia, viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit.

Megjithatë, gjetjet e Raportit theksojnë, se institucionet kanë adresuar disa problematika, si: detyrimin e profesionistëve të vijës së parë (përfshirë personelin shëndetësor, policinë, mësuesit dhe punonjësit e tjerë), që të identifikojnë dhe raportojnë në mënyrë aktive individët e rrezikuar ndaj dhunës dhe trafikimit, sidomos viktimat e mundshme të trafikimit, të referojnë rastet dhe t'i trajtojnë ato, disponueshmëria e shërbimeve të mbrojtjes së viktimave dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, përfshirë shërbimet e specializuara të integruara për viktimat e mbijetuara nga format e rënda të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit. Disa forma të shfrytëzimit për trafikim, siç është martesë e detyruar si një formë të veçantë të dhunës ndaj grave dhe vajzave, birësimi i paligjshëm, shfrytëzimi mes përdorimit të teknologjisë, nevojiten të rregullohen më mirë në ligj.

Raporti konstaton se ka përmirësime në lidhje me krijimin e mekanizmave kombëtarë të referimit. Fuqizimi dhe efektiviteti i tyre vijon të mbetet një sfidë. Mekanizmat dhe strukturat në nivel vendor për adresimin e çështjeve të dhunës seksuale janë të pamjaftueshme dhe kanë nevojë për rritje të aftësive të tyre në këtë drejtim.

Zhvillime pozitive janë shënuar në lidhje me mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore. Mekanizmi Kombëtar kundër Dhunës bashkërendon institucionet e qeverisjes qendrore mes tyre dhe njësisë të qeverisjes vendore, si dhe institucionet e pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile.



Gjithashtu është analizuar ofrimi i ndihmës juridike, me qëllim ofrimin e shërbimeve të ndjeshme ndaj personave LGBTI+. Statistikat zyrtare përmbajnë pak të dhëna për krimet e urrejtjes, ndonëse ka udhëzime për mbledhjen dhe përpunimin e tyre. Studimet tregojnë se viktimat LGBTI+, që kanë denoncuar rastin në polici nuk kanë informacion të mëtëjshëm pas denoncimit fillestar të çështjes (50.5%), çështja e tyre nuk është zgjidhur (7.1%).

KPP-ja nuk parashikon ndonjë rregull specifik për mbrojtjen, mbështetjen dhe të drejtat e viktimave të terrorizimit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Të drejtat e përgjithshme të viktimave zbatohen edhe për to. Viktimat e terrorizimit nuk përfshihen në kategorinë e viktimave që përfitojnë ndihmë juridike falas, pavarësisht pasurisë ose të ardhurave të tyre, për rrjedhojë as përjashtim nga tarifat gjyqësore. Ligji për mbrojtjen civile përcakton sulmet terroriste nën konceptin e fatkeqësive të tjera dhe se çdo person ka të drejtën e mbrojtjes nga fatkeqësitë e tjera.

Të dhënat zyrtare në lidhje me buxhetin e kaluar në fondin e posaçëm, fondet e shpërndara OJF-ve për mbështetjen e shërbimeve për viktimat janë të publikuara, por nuk ka të dhëna për fondet e përdorura për kompensimin e viktimave.

Raporti i Analizës rekomandon që në procesin e implementimit të Strategjisë Ndersektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit të zënë vend çështje që lidhen me mbrojtjen e viktimave të abuzimit të pushtetit.

Standardet minimale të zhvilluara nga CPT-ja për parandalimin, masat mbrojtëse në rastet e keqtrajtimit dhe hetimi efektiv dhe i menjëhershëm, dëmshpërblimi i viktimës së keqtrajtuar, janë gjithashtu çështje të adresuara në Strategji.

Lidhur me skemën e kompensimit të viktimave të krimit nga shteti

Direktiva e Këshillit 2004/80/KE e 29 prillit

2004, lidhur me kompensimin e viktimave të krimit dikton nevojën e krijimit të një skeme shtetërore për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme. Ministria e Drejtësisë është përcaktuar si autoriteti qendror për zbatimin e Konventës.

Direktiva kërkon krijimin e një skeme kombëtare të kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme të qëllimshme, të kryera në territoret e tyre përkatëse, e cila garanton kompensimin e drejtë dhe të përshtatshëm për viktimat. Në aspektin e bashkëpunimit ndërkuftar emërimin e një pikë kontakti qendror që mban kontaktet dhe transmeton informacionin te komisioni, nxit bashkëpunimit dhe shkëmbimet të informacionit ndërmjet autoriteteve ndihmëse dhe vendimmarrëse në shtetet anëtare dhe dhënien e ndihmës dhe kërkimit të zgjidhjeve për çdo vështirësi.

Kompensimi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore, të abuzimit seksual, të dhunës me bazë gjinore adresohen edhe në direktiva të tjera.⁸²

Viktimat e krimit kanë të drejtë të kërkojnë shpërblimin e dëmit (neni 58 dhe 1, germa “g”). KPP-ja përcakton kushtet dhe kriteret për shpërblimin e dëmit mes padisë civile në procesin penal. KC-ja parashikohen skemat e dëmshpërblimit, mënyrat dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe dëmit jofizik, në rastet kur viktimat kërkon dëmshpërblim material dhe moral me anë të procesit civil⁸³.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme në vitin 2004.⁸⁴ Ajo parashikon detyrimin për të drejtat e kompensimit nga fondet publike, në lidhje me krimet e kryera në territorin e anëtarit ratifikues. Ministria e Drejtësisë është përcaktuar si autoriteti qendror për zbatimin e Konventës. Republika e Shqipërisë ka bërë një rezervë ligjore, në lidhje me rrethin e personave të varur nga viktimat.⁸⁵ Direktiva 2004/80/EC, për kompensimin e viktimave të krimeve adreson

⁸² Neni 17 i direktivës 2011/36/BE së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, i datës 5 prill 2011, mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij vep. e cituar; neni 24 i direktivës (BE) 2017/541 së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, i datës 15 mars 2017, për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit kornizë të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e vendimit të Këshillit 2005/671/JHA; neni 20 i direktivës 2011/92/BE së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, i 13 dhjetorit 2011, për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe Faqe | 22232

pornografisë së fëmijëve, dhe për zëvendësimin e vendimit kornizë të Këshillit 2004/68/JHA.

⁸³ Shih nenet 608, 625 dhe 640-647 të Kodit Civil, i ndryshuar.

⁸⁴ Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën me ligjin nr. 9265, datë 29.7.2004. Shih: <https://qbz.gov.al/preview/a7178f31-ea8e-4a18-bed4-4dce36790b9f>.

⁸⁵ Sipas nenit 4 të ligjit nr. 9265, datë 29.7.2004, “person i varur” nënkupton fëmijët e mitur, bashkëshorten dhe prindërit e paaftë për punë, që kanë qenë plotësisht ose



kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme të kryer me qëllim. Deri më sot, nuk është miratuar një ligj i posaçëm për të mundësuar zbatimin e Konventës.

Ka një skemë shtetërore për kompensimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit. Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera me masa parandaluese, i ndryshuar ⁸⁶ parashikon krijimin e një fondi të posaçëm një pjesë e të cilit përdoret për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor, për t'i ndihmuar dhe për nxitjen e programeve sociale për to, për mbështetjen e organizatave jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social-kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura ose të rrezikuara nga krimi, përfshirë qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore.

Të dhënat zyrtare në lidhje me buxhetit e kaluar në fondin e posaçëm, fondet e shpërndara OJF-ve për mbështetjen e shërbimeve për viktimat janë të publikuara, por nuk ka të dhëna për fondet e përdorura për kompensimin e viktimave⁸⁷. Mungesa e të dhënave mund të jetë e lidhur me mungesën e vendimeve gjyqësore për kompensimin e viktimës. Nga kërkimet e kryera nuk u arrit të mblidhen të dhëna për numrin e kërkesave të viktimave për shpërblimin e dëmit nga autori gjatë procesit penal ose procesit civil, nëse ekspertët janë përfshirë për përcaktimin e dëmit fizik, moral material të shkaktuar viktimës. Formularë të veçantë janë hartuar për përcaktimin e masës së dëmit. Sipas raportit të GRETA-s dy vendime kompensimi të viktimës së trafikimit janë evidentuar⁸⁸.

GRETA vë në pah një sërë problemesh që konstatohen në shqyrtimin e kërkesave të viktimave për kompensim në procesin penal ose civil⁸⁹, si: mospërcaktimi i plotë i dëmit të shkaktuar, procedura gjyqësore të gjata, kosto të larta në rastin e kërkesës për kompensim në një procedurë civile, koha e gjatë, pengesa për ekzekutimin e urdhrat të kompensimit, pasi autori nuk ka mjete të mjaftueshme ose zbatimin i gjerë i sekuestrimit dhe i konfiskimit të pasurive të krimit.

Përveç skemës së kompensimit të viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit, nuk ka një skemë shtetërore për kompensimin e viktimave të krimeve të tjera të dhunshme nga shteti.

Me qëllim respektimin e së drejtës së viktimës për kompensim nga shteti është i nevojshëm miratimi i një ligji të posaçëm që të përcaktojë skemën e kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme. Së pari është e nevojshme të përcaktohen krimet e dhunshme, me qëllim që të orientohen profesionistët në zbatimin e së drejtës për kompensimin e viktimave. Ligji duhet të përcaktojë subjektet përfituese, kategoritë e dëmeve që mund të kompensohen, procedurat e kompensimit të shtetasve të huaj viktimat të krimeve të dhunshme të kryera në territorin e Republikës Shqiptarisë, rastet e pakësimit ose të refuzimit të kompensimit, procedurat e informimit të viktimës dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të lidhjes së ndërsjellë.

Megjithatë, në përmirësimet e konstatuara theksohet nevoja për rritje të kapaciteteve të profesionistëve. Rekomandimet e institucioneve monitoruese vendëse dhe ndërkombëtare janë mbajtur në konsideratë në hartimin e SNMVK-së⁹⁰.

Bazuar në gjetjet si më sipër të Raportit të

pjesërisht në ngarkim të të vdekurit, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit.

⁸⁶ Ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera me masa parandaluese", i ndryshuar, neni 37. Shih: <https://qbz.gov.al/previeë/1312ee1c-8869-4e44-81c4-fac01998c96/cons/20200914>

⁸⁷ <https://aapsk.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Tabela-e-pasurive-te-sekuestruara-revokuara-e-konfiskuara-2011-2020.pdf>; <https://aapsk.gov.al/ceremonia-e-firmosjes-se-kontratave-me-ojf-te-e-shpallura-fituese-te-projekteve-qe-financohen-nga-para-te-konfiskuara-nga-krimi-me-vendim-te>

komitetit-nderinstitucional-per-masat-kunder-krimet-te-or/dhe <https://aapsk.gov.al/publikime/>

⁸⁸ Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings, Evaluation Report Albania, GRETA, 2020, f. 19. Shih: <https://rm.coe.int/greta-2020-09-fgr-alb-en/1680a0b84f>

⁸⁹ Po aty, 19.

⁹⁰ GRETA është e Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore që monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Një pjesë e rekomandimeve të adresuara në këtë pjesë të analizës janë rekomandime të GRETA-s për Shqipërinë. Për më shumë shih: Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings, vep. e cit. f. 20.



Analizës, janë dhënë disa rekomandime, si më poshtë, të cilat janë adresuar në masa të caktuara, në Strategji:

- Vlerësimi i legjislacionit dhe i praktikës së kompensimit të viktimës nga autori dhe shteti. Bazuar në gjetjet e vlerësimit, hartimi dhe miratimi i përmirësimeve ligjore në KPP, me qëllim përafrimin e legjislacionit me direktivën 2004/80/EC;

- Përcaktimi i veprave penale të dhunshme, sipas legjislacionit shqiptar, dhe subjektet që do të përfitojnë kompensim nga shteti;

- Vlerësimi i modeleve të skemës së kompensimit të viktimave të vendeve anëtare të BE-së. Bazuar në shkëmbimin e përvojave dhe në ekspertizën ndërkombëtare në fushë, diskutimi i modeleve më të përshtatshme për Shqipërinë, bazuar edhe në standardet e përcaktuara në direktivën 2004/80/EC;

- Përgatitja dhe miratimi i një plani të transpozicionit të direktivës për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme;

- Miratimi i ligjit për kompensimin e viktimave nga shteti, i cili duhet të përcaktojë kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga direktiva dhe të përcaktojë skemën e kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme nga shteti;

- Studimi sistematik i praktikës gjyqësore, në lidhje me kompensimin e viktimave të krimit të autorit dhe shtetit;

- Rritja e kapaciteteve të punonjësve të policisë, oficerëve të policisë gjyqësore, prokurorëve, ekspertëve për të siguruar mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar viktimat, përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës, si element i rëndësishëm për të mbështetur pretendimet e ardhshme për kompensim;

- Zbatimi me efektivitet të legjislacionit për ngrirjen dhe konfiskimin e pasurive dhe përdorimin e tyre për kompensimin e viktimave;

- Ngritja e kapaciteteve të avokatëve për të mbështetur viktimat në kërkimin e kompensimit;

- Inkurajimi i prokurorëve dhe i gjyqtarëve që të

përdorin të gjitha mundësitë që ligji u ofron atyre të mbështesin kërkesat e viktimave për kompensim në procesin penal;

- Përdorimi i fondit të posaçëm të krijuar nga ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera me masa parandaluese për kompensimin e viktimave të krimit të organizuar dhe trafikimit;

- Lehtësimi i viktimave nga përgjegjësia e pagesës së taksave për ekzekutimin e urdhërkompensimit;

- Zhvillimi i kapaciteteve të autoriteteve vendore për të bashkëpunuar ndërkombëtarisht në mbrojtjen e viktimat, kompensimin e tyre për dëmin që pësojnë dhe riatdhesimin e tyre të sigurt kur është e nevojshme.

Trajnimi i profesionistëve në lidhje me të drejtat e viktimave të krimit

Neni 25 i direktivës 2012/29 EU adreson trajnimin e përgjithshëm dhe të specializuar në një nivel që është i përshtatshëm për punonjësit e policisë dhe stafin e gjykatës që janë në kontakt me viktimat, për t'i pajisur me aftësitë për trajtimin e viktimave në mënyrë të paanshme, profesionale dhe me respekt; trajnim të përgjithshëm dhe të specializuar të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve të përfshirë në procedim penal për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për nevojat e viktimave, trajnimin e profesionistëve dhe respektimin e standardeve profesionale nga punonjësit e shërbimeve publike dhe jopublike, që ofrojnë mbështetje për viktimat, si dhe shërbimet e drejtësisë restauruese. Direktiva e vë theksin në pajisjen e profesionistëve me aftësinë për të identifikuar dhe për t'i trajtuar viktimat me respekt, profesionalizëm dhe në mënyrë jodiskriminuese. Kërkesa për trajnimin e profesionistëve parashikohen edhe në direktivat e tjera.⁹¹

Trajnimi i profesionistëve që janë në kontakt me viktimat adresohet në ligje dhe akte nënligjore të ndryshme.⁹² KPP-ja nuk parashikon rregulla specifike në lidhje me trajnimin dhe specializimin e profesionistëve që janë në kontakt me viktimat e

⁹¹ Direktiva e 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 13 dhjetorit 2011, në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, neni 23;

Neni 18 i direktivës 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit së datës 5 prill 2011, “Për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij dhe zëvendësimin”; vendimi Faqe | 22234

kornizë i Këshillit 2002/629/JHA; neni 19 i direktivës (BE) 2017/541 së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit së datës 15 mars 2017, për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit kornizë të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e vendimit të Këshillit 2005/671/JHA.

⁹² Nenet 25–32 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.



rritura. KDPM-ja parashikon rregulla të detajuara në lidhje specializimin e personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur, fushat e trajnimit, trajnimit dhe specializimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Programi i formimit fillestar për magjistratë i Shkollës së Magjistraturës përmban tema specifike për viktimat e krimit, viktimat në procesin penal⁹³. Nga kërkimet e kryera nuk u mundësia mbledhja e të dhënave nëse njohuritë për viktimat, të ofruara në programet e formimit fillestar dhe vazhdues dhe kalendarët vjetorë të trajnimit vazhdues janë të mjaftueshëm, nëse programet e formimit fillestar dhe vazhdues për avokatët, psikologët, mjekët ligjorë, mjekët psikiatër, punonjësit socialë, ndërmjetësues etj., përmbajnë module/tema specifike për viktimat e krimit dhe mbrojtjen e tyre. Komentarë dhe manuale për magjistratët, në lidhje me të drejtat e viktimave, mbështetjen dhe mbrojtjen e tyre, janë përgatitur, publikuar dhe janë të aksesueshëm në formatin *online*⁹⁴.

Nga ana tjetër, analiza e nevojave për trajnim, zhvillimi i kurrikulave dhe i programeve trajnuese kryhen nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë⁹⁵. Magjistratët kanë të drejtë të propozojnë tema për trajnim.⁹⁶ Për rrjedhojë, informimi dhe sensibilizimi i magjistratëve për rëndësinë e temave që lidhen me viktimat dhe trajtimin e tyre, si dhe inkurajimi i tyre për të propozuar tema të tilla është me rëndësi. Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë ka ofruar trajnime të magjistratëve dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me viktimat. Megjithatë, nevoja për trajnime theksohet në shumë raporte.

Programi i formimit fillestar për magjistratë i Shkollës së Magjistraturës përmban tema specifike për viktimat e krimit, viktimat në procesin penal⁹⁷. Nga kërkimet e kryera nuk u mundësia mbledhja e të dhënave, nëse njohuritë për viktimat, të ofruara

në programet e formimit fillestar dhe vazhdues dhe kalendarët vjetorë të trajnimit vazhdues janë të mjaftueshëm, nëse programet e formimit fillestar dhe vazhdues për avokatët, psikologët, mjekët ligjorë, mjekët psikiatër, punonjësit socialë, ndërmjetësues etj., përmbajnë module/tema specifike për viktimat e krimit dhe mbrojtjen e tyre; komentarë dhe manuale për magjistratët në lidhje me të drejtat e viktimave, mbështetjen dhe mbrojtjen e tyre janë përgatitur, publikuar dhe janë të aksesueshëm në formatin *online*⁹⁸.

Nga ana tjetër, analiza e nevojave për trajnim, zhvillimi i kurrikulave dhe i programeve trajnuese kryhen nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë⁹⁹. Magjistratët kanë të drejtë të propozojnë tema për trajnim.¹⁰⁰ Për rrjedhojë, informimi dhe sensibilizimi i magjistratëve për rëndësinë e temave që lidhen me viktimat dhe trajtimin e tyre, si dhe inkurajimi i tyre për të propozuar tema të tilla është me rëndësi. Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë ka ofruar trajnime të magjistratëve dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me viktimat. Megjithatë, nevoja për trajnime theksohet në shumë raporte.

Urdhri i Psikologut ofron trajnime për psikologët, përfshirë psikologët asistues në lidhje me të miturit, identifikimin e dhunës te fëmijët, intervistimin, hartimin e raporteve të vlerësimit psikologjik. Nga informacioni i përcjellë rezulton se ka nevojë për më shumë fokus të rritja e kapaciteteve të psikologëve në lidhje me viktimat.¹⁰¹ Detyrimi për ngritjen e kapaciteteve është përfshirë në standardet e kujdesit rezidencial. Trajnimet ofrohen nga institucionet përkatëse dhe/ose në bashkëpunim me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë që veprojnë në këtë fushë. Organizatat e shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë ofrojnë shërbime mbështetëse, ndihmë juridike, këshillime, strehim etj., dhe për viktimat me nevoja të veçanta, trajnime

⁹³ <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programe-and-formime>.

⁹⁴ Për më shumë shih:

<https://www.magjistratura.edu.al/sq/botime-nder-vite>.

⁹⁵ Neni 5, paragrafi 6, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁹⁶ Neni 272 i ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

⁹⁷ <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programe-and-formime>.

⁹⁸ Për më shumë shih:

<https://www.magjistratura.edu.al/sq/botime-nder-vite>.

⁹⁹ Neni 5, paragrafi 6, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁰⁰ Neni 272 i ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

¹⁰¹ Trajnimi është realizuar gjatë periudhës maj–dhjetor 2018 dhe ka qenë i përbërë nga 120 orë, në lidhje me drejtësinë penale për të mitur, kryesisht për të miturin në konflikt me ligjin.



për profesionistët në fushën e mbrojtjes së tyre. Të dhëna të plota dhe përditësuara për numrin e profesionistëve të trajnuar për të drejtat e viktimat dhe nevojat janë të dobishme.

Bazuar në gjetjet si më sipër të Raportit të Analizës, janë dhënë disa rekomandime, si më poshtë, të cilat janë adresuar në masa të caktuara, në Strategji:

- Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues të të gjithë profesionistëve që janë në kontakt me viktimat;

- Inkurajimi i KLGJ-së dhe KLP-së, prokurorit të përgjithshëm, Shkollës së Magjistraturës, magistratëve, avokatëve, ndërmjetësuesve për vijimin e trajnimeve vazhduese për viktimat dhe nevojat e tyre;

- Vijimi i forcimit të kapaciteteve të të gjithë profesionistëve të tjerë, në lidhje me viktimat, nevojat dhe trajtimin e tyre;

- Zgjerimi në territor të shërbimeve për viktimat e krimit dhe forcimi i bashkëpunimit me OJF-të, si dhe rritja e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit;

- Zgjerimi i zbatimit të programeve të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit, sipas kushteve dhe kriterëve ligjore;

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për profesionistët e trajnuar dhe të specializuar për të drejtat viktimës, nevojat dhe trajtimin e tyre;

- Inkurajimi i Urdhrit të Psikologut dhe i Punonjësit Social, fuqizuar trajnimet e psikologëve asistues dhe psikologëve ekspertë, në lidhje me viktimat, vlerësimin, intervistimin etj.;

- Forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes trajnimeve të vazhdueshme. Trajnimet e vazhdueshme të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinatorëve të viktimave i ndihmon ato në rritjen e njohurive;

- Zhvillimi i treguesve të performancës për të monitoruar kënaqësinë e viktimave dhe dëshmitarëve, përvoja e tyre me sistemin e drejtësisë penale.

Lidhur me bashkëpunimin institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e viktimave e krimit

Lidhur me bashkëpunimin institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e viktimave të krimit, nga analiza e situatës aktuale evidentohet nevoja e një strukture koordinuese kombëtare për viktimat, pasi ka mekanizma kombëtarë dhe vendorë për kategori të ndryshme të viktimave, por jo për të gjitha kategoritë. Në nivel kombëtar nuk ka një koordinim të mekanizmave të ndryshëm kombëtarë, që adresojnë të drejtat e kategorive të ndryshme të viktimave.

Bashkërendimi i punës mes institucioneve në referimin e rasteve konkrete të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të viktimave të abuzimit seksual, viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit rregullohen në mënyrë të detajuar me akte nënligjore.¹⁰² Standardet e shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave mbështetëse për viktimat janë të miratuara.¹⁰³

Bashkëpunimin dhe koordinimin i shërbimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përcaktohen në nenin 26 të direktivës 2012/29 EU, e cila rekomandon shkëmbimin e praktikave më të mira, konsultimin në raste individuale dhe asistencë për rrjetet evropiane që punojnë për çështje që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e viktimave.

Akresi i çdo viktime të krimit në shërbimet e integruara, ka nevojë për informim të publikut dhe të viktimat për shërbimet dhe mënyrën sesi mund të qasen ato. Nga kërkimet në faqen zyrtare të institucioneve dhe organizatave, që ofrojnë shërbime për viktimat, partnerëve vendës dhe ndërkombëtarë rezulton se ka informacione, raporte, botime, publike, video informuese etj. Qasja e viktimave në to nuk është e lehtë, nëse nuk janë të informuar për shërbimet në territor, mënyrën e kontaktimit dhe lehtësimin e qasjes në këto shërbime.

Bashkëpunimi mes institucioneve dhe OJF-ve në fushën e ofrimit të shërbimeve për viktimat, të rritjes së kapaciteteve të strukturave dhe profesionistëve, si

¹⁰² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 2.6.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”; udhëzimi i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Brendshëm nr. 912, datë Faqe | 22236

27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”.

¹⁰³ Udhëzimi nr. 816, datë 27.11.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”.



dhe përmirësimin e statistikave vijon të konsolidohet, por është e nevojshme të forcohen në nivel vendor, sidomos në fushën e shërbimeve për viktimat jashtë Tiranës. Konsolidimi i këtij bashkëpunimi është adresuar me masa në Strategji, si dhe vijimi i fushatave të informimit, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të publikut, të viktimave dhe institucioneve për të drejtat e viktimave, mekanizmat dhe shërbimet mbështetëse për to.

- Vijimi i forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimi ndërinsitucional;

- Koordinimi dhe bashkërendimi mes gjithë mekanizmave ekzistues në nivel kombëtar dhe rajonal;

- Përfshirja e sektorit privat në rrjetet kombëtare dhe në nivel vendor dhe inkurajimi i tyre për të parandaluar viktimizimin;

- Zhvillimi i veprimtarive informuese dhe ndërgjegjëse për parandalimin e viktimizimit dhe shfrytëzimit të grupeve më të rrezikuara për të qenë viktimë;

- Mbështetja e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë mbrojtje dhe shërbime mbështetëse për viktimat e krimit;

- Organizimi i takimeve periodike me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe me organizatat jofitimprurëse për të diskutuar problematikën dhe për të ndarë përvojat pozitive;

- Zbatimi me korrektesë i procedurave dhe i standardeve të bashkëpunimit mes institucioneve dhe monitorimi sistematik i respektimit të tyre;

- Shkëmbimi i përvojave të mira me agjencitë e vendeve të tjera;

- Përfshirja e viktimave në rrjetet e OJF-ve që ofrojnë shërbime për viktimat dhe dëgjimi i mendimit të tyre;

- Inkurajimi i parlamentarëve për monitorimin e masave të marra për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Konventat, zbatimin e rekomandimeve të mekanizmave monitorues të konventave, dhe vlerësime të rregullta mbi zbatimin të tyre;

- Krijimi i një portali *online* për të drejtat e viktimave dhe aksesin i informacionit nga viktimat vendëse dhe të huaja.

Lidhur me Urdhrin Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale

Lidhur me forcimin e dimensionit ndërkombëtar të të drejtave të viktimave, SNMVK 2024–2030 synon të forcojë disa mekanizma të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sigurimit të aksesit optimal në drejtësi të viktimave, në kuadër të rritjes së mobilitetit, si dhe në kontekstin e negociatave të anëtarësimit dhe të procesit të stabilizim-asociimit.

Njohja e Urdhrit Evropian të Mbrojtjes, do të jetë një masë që do të kontribuojë në përmbushjen e objektivit për forcimin e dimensionit ndërkombëtar. Nëpërmjet tij synohet, që “mbrojtja që rrjedh nga masa të caktuara mbrojtëse për viktimat e krimit, të miratuara sipas ligjit të një shteti anëtar” mund të shtrihen në një shtet tjetër anëtar, në të cilin personi i mbrojtur vendos të banojë ose të qëndrojë. Njohja e Urdhrit Evropian të Mbrojtjes do të kontribuojë në përafrimin e plotë të direktivave të BE-së mbi të drejtat e viktimave dhe më konkretisht të direktivës 2011/99/BE, “Mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes”, e cila do të realizohet nëpërmjet ndryshime ligjore¹⁰⁴.

Pak elemente të direktivës janë të rregulluara në legjislacionin shqiptar, pikërisht ato që kanë të bëjnë me rolin e Ministrisë së Drejtësisë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar penal dhe komunikimet me autoritetet e vendeve të tjera.

Bazuar në gjetjet si më sipër të Raportit të Analizës, janë dhënë disa rekomandime, si më poshtë, të cilat janë adresuar në masa të caktuara, në Strategji:

- Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe marrja e nismës ligjore për përafrimin e legjislacionit me direktivën 2011/99/BE;

- Hartimi dhe miratimi i formatit të kërkesës;

- Përgatitja e udhëzuesve për procedurat e zbatimit të Urdhrit Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale;

¹⁰⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;

Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8984, datë 23.12.2002, “Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”;

Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8498, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”;

Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”.



- Trajnimi i profesionistë në lidhje me Urdhrin Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale;

- Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i profesionistëve për zbatimin e Urdhrit Evropian të Mbrojtjes;

- Fushata informuese për viktimat në lidhje me të drejtat dhe procedurat për përdorimin e Urdhrit Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale.

4. Parimet themelore

SNMVK 2024–2030, udhëhiqet nga disa parime bazë, si: *parimi i ligjshmërisë, parimi i konfidencialitetit, parimi i proporcionalitetit, parimi i mbrojtjes nga diskriminimi, parimi i së drejtës për informim, parimi i mbrojtjes së të drejtave të viktimave, parimi i mbështetjes së të drejtave të viktimave, duke marrë në konsideratë, viktimat me nevoja specifike*, të cilat janë të sanksionuara në Konventat Ndërkombëtare, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, si edhe në legjislacionin në fuqi.

Krahas parimeve, strategjia mban parasysht të drejtat e viktimës, konkretisht:

- E drejta për të kuptuar dhe t'u kuptuar;
- E drejta për të marrë informacion që në kontaktin e parë me autoritetet kompetente;
- E drejta e viktimës kur paraqet ankesë;
- E drejta për informim për çështjen;
- E drejta për interpretim dhe për përkthim;
- E drejta për të pasur akses në shërbimet mbështetëse për viktimat;
- E drejta për t'u dëgjuar;
- Të drejtat në rastet e vendimit të mosfillimit ose pushimit të gjykimit;
- E drejta për ndihmë juridike;
- E drejta për rimbursimin e shpenzimeve;
- E drejta për kthimin e pasurisë;
- E drejta për kompensimin e viktimës nga autori gjatë procedimeve penale;
- Të drejtat e viktimës rezidentë në një shtet tjetër;
- E drejta për mbrojtje;
- E drejta e shmangies së kontaktit mes viktimës dhe të pandehurit;
- E drejta e mbrojtjes së viktimave gjatë hetimeve penale;
- E drejta e mbrojtjes së privatësisë;
- E drejta e mbrojtjes së viktimave me nevoja të veçanta gjatë procedimeve penale;
- E drejta e mbrojtjes së fëmijës gjatë procedimeve penale;

Hartimi i këtij dokumenti do të synojë krijimin e sinergjive mes sektorëve të ndryshëm për mbrojtjen e viktimave të krimit mes ndërtimit të një sistemi drejtësie penale të drejtë, efektiv dhe efikas, si dhe do të mundësojë përmbytjen e një prej detyrimeve, në kuadër të procesit të anëtarësimit të shtetit tonë në BE.

SNMVK 2024–2030 dhe plani i veprimit është hartuar duke u bazuar në bashkëpunimin midis ministrive përgjegjëse të linjës, institucioneve të pavarura, organizatat e shoqërisë civile që punojnë për mbrojtjen e viktimave të krimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, partnerë ndërkombëtarë, grupimet që përfaqësojnë viktimat, si dhe aktorë të tjerë.

Gjithashtu, rekomandimet e mekanizmave monitorues vendës dhe ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile që kanë të bëjnë me politikat dhe objektivat specifike të SNMVK 2024–2030 janë reflektuar në këtë dokument. Zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të përfshirjes së viktimave dhe për viktimat do të krijojë një bazë të mirë të të dhënave socio-ekonomike, të cilat do të mblidhen rregullisht.

Përfshirja e shoqërisë civile ka qenë e rëndësishme në hartimin e SNMVK 2024–2030. Bashkëpunimi me OJF-të, partnerë socialë, akademikë/studiues ka qenë i rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e SNMVK 2024–2030. Këta aktorë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e planit të veprimit dhe do të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij. OJF-të, ekspertë të botës akademike kanë jo vetëm ekspertizë të vlefshme për të ofruar, por ato gjithashtu do të jenë aktorë të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit të tjetër.

Buxhetimi për zbatimin është parimi që ka udhëhequr hartimin e kësaj strategjie. Ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura kanë identifikuar buxhetet përkatëse për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministrinë kanë identifikuar hendeqet e financimit ku mund të kërkohet ndihmë nga donatorë e partnerë vendës dhe ndërkombëtarë.

5. Vizioni dhe misioni i dokumentit

VIZIONI

Një sistem drejtësie penal efektiv, që garanton pa diskriminim të drejtat e viktimave në të gjitha fazat e procesit penal dhe që mban

MISIONI

Të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor, në bashkëpunim me shoqërinë civile, do të punojnë bashkërisht për të fuqizuar pozitën e

parasysh nevojat e veçanta të tyre.

viktimave në sistemin e drejtësisë penale, mundësuar zbatimin e të drejtave të viktimave të krimit, veçanërisht të viktimave me nevoja të veçanta, duke mundësuar gëzimin e së drejtës për qasje në një sistem drejtësie efikas, profesional që mundëson informim, mbështetje, mbrojtje, kompensim të dëmeve të shkaktuar nga krimi, si dhe bashkëpunim dhe koordinim më të mirë të shërbimeve për viktimat në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

PJESA II

QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PARËSORE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024–2030

Qëllimet e politikës së SNMVK 2024–2030
SNMVK 2024–2030 përmban 4 (katër) qëllime kryesore:

- Qëllimi i parë** → Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.
- Qëllimi i dytë** → Një kuadër ligjor i përafëruar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit.
- Qëllimi i tretë** → Garantimi i së drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë.
- Qëllimi i katërt** → Forcimi i bashkëpunimit dhe I koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Qëllimi politik 1

Fuqizimi i parandalimit dhe i raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.

Ky qëllim politik synon ndërmarrjen e fushatave kombëtare ndërgjegjëse, për të drejtat e viktimave, duke përfshirë mbështetjen për viktimat me nevoja specifike, si dhe krijimin e mjediseve të sigurta për viktimat, duke mbajtur në konsideratë, sidomos grupet vulnerabël dhe komunitetet e marginalizuara, të cilat kanë mundësi të kufizuara aksesit në drejtësi.

Referuar raport-analizës së mbrojtjes së viktimave të veprave penale në sistemin e drejtësisë penale, rezulton se shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në informimin, sensibilizimin, ndërgjegjësimin dhe ofrimin e shërbimeve për kategori të ndryshme të viktimave. Disa rrjete janë krijuar dhe funksionojnë siç është rrjeti për fuqizimin e grave, rrjeti kundër trafikimit të qenieve njerëzore, koalicioni i strehëzave antitrafikim, rrjeti i organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore dhe një platformë *online*¹⁰⁵ me informacione, në lidhje me legjislacionin, rekomandime të mekanizmave monitorues në fushë. Sigurimi i ndihmës juridike falas *online* për të mbijetuarit e dhunës dhe trajnimi i avancuar me studentë të drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike falas janë aktivitete të këtij rrjeti. Publikime me interes në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së viktimave janë të botuara në këtë platformë.

Në këtë kuadër strategjia, parashikon një objektiv specifik, vetëm për këtë qëllim, i cili synon të arrihet nëpërmjet informimit të viktimave mbi të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve, ndërmarrja e fushatave kombëtare ndërgjegjëse për të drejtat e viktimave, duke përfshirë mbështetjen për viktimat me nevoja specifike, përgatitjen e programeve specifike, me qëllim përfshirjen e shoqërisë civile në forcimin e të drejtave të viktimave, sigurimi i linjave ndihmëse për viktimat e veprave penale, duke forcuar përfshirjen e shoqërisë civile në mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave, zhvillimi i programeve informuese dhe edukuese në media audio- dhe

¹⁰⁵ Nisma e Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare.

Shih: <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/projekti/>.



audiovizive për të drejtat e viktimave dhe aksesimin e shërbimeve në institucione.

Ministria e Drejtësisë me mbështetje e Projekti JustAL po punojnë për zhvillimin e portalit “Qasja në drejtësi”. Portali synon të bashkojë informacionin në lidhje me aksesin në drejtësi për të gjithë, duke iu ofruar të gjitha grupeve të shoqërisë informacionin përkatës dhe duke iu mundësuar atyre të përdorin më mirë ligjin dhe shërbimet ligjore në mbrojtje të të drejtave të tyre. Njohuria se cilat shërbime ekzistojnë dhe si të aksesohen ato, është një element kyç për të siguruar që qasja në drejtësi të mos pengohet.

Në portalin “Qasja në drejtësi”, vend të rëndësishëm do të zërë edhe informacioni për të drejtat e viktimës dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtjen e tyre, ndaj dhe SNMVK 2024–2030 ka të parashikuar te qëllimi 1 i politikës, një masë vetëm për kategorinë e viktimave të krimit që do të informohen nëpërmjet këtij portal.

Viktimat e krimit mund të raportojnë krimin në polici, prokurori ose gjykatë, sipas rregullave të parashikuara në KPP, ndaj dhe ky qëllim politik synon edhe krijimin e një mjedisi miqësor për raportimin nga viktimat në këto institucione, me qëllim raportimin e krimeve nga ana tyre. KPP-ja parashikon vënien në lëvizje të procedimit penal nga prokuroria mbi bazën e kallëzimit të viktimës, ose të personave të tretë ose kryesisht kur policia ose prokuroria marrin dijeni për veprën penale. E drejta dhe/ose detyrimi për të vënë në lëvizje prokurorinë për një vepër penale është mundësi për të mos lënë disa kategori veprash penale pa u raportuar.

Ligji parashikon mënyra të ndryshme për shmangien e kontakteve të viktimës, përfshirë viktimën e mitur me autorin, sidomos gjatë pyetjes kur viktimat duhet të jetë e pranishme në fazë të ndryshme të procesit penal. Është pozitive që mjediset miqësore për fëmijët janë krijuar në disa komisarate, prokurori dhe gjykata të vendit. Lidhur me viktimat e abuzimit seksual, modeli dhe standardi tashmë i miratuar po gjen zbatim në praktikë. Është më rëndësi të vlerësohet vendi i krijimit të mjediseve miqësore për viktimat dhe mundësia e ofrimit të shërbimeve në një vend. Nuk ka të dhëna nëse në gjykatat dhe prokuroritë e miratuara, sipas hartës së re gjyqësore ka mjedise të veçanta të dedikuara për qëndrimin e viktimave. Zbatimi i hartës së re gjyqësore kërkon vlerësimin e pasjes ose jo të mjediseve pritëse për viktimat dhe krijimin e tyre aty ku këto nuk ekzistojnë.

Referuar raport-analizës së mbrojtjes së viktimave të veprave penale në sistemin e drejtësisë penale, Strategjia ka adresuar këtë problematikë, për krijimin e mjediseve të sigurta dhe të aksesueshme për çdo viktimë të krimit në polici, prokurori dhe gjykatë, e cila është planifikuar të realizohet fillimisht duke përcaktuar standardet për ambientet, të përshtatshme për viktimat në përputhje me direktivat e BE-së, vlerësimin e nevojave për mjedise të posaçme për viktimat në godinat e prokurorive dhe të gjykatave, dhe më pas rristur strukturimin e ambienteve, për pritjen e viktimave të krimit, sipas standardeve të përcaktuara.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse, në bashkëpunim me institucione, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë, do të fokusohen në përmbytjen e dy objektivave specifikë.

Objektivi specifik 1.1: Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe i viktimave të krimit për raportimin e krimit, të drejtat dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtëse të tyre.

Objektivi specifik 1.2: Ndërtimi/fuqizimi i mekanizmave të raportimit të krimit nga viktimat mes rritjes së besimit, sigurisë dhe ofrimit të shërbimeve nga profesionistë të trajnuar për të drejtat dhe nevojat e viktimave.

Lidhja midis qëllimit politik 1 dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 1 lidhet me OZHQ 16, i cili promovon shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, ky qëllim lidhet me nënobjektivin 16.10, i cili synon: “Të sigurojë aksesin e publikut në informacion dhe të mbrojë liritë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.

Objektivi specifik 1.1: Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe i viktimave të krimit për raportimin e krimit, të drejtat dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtëse të tyre



Gjatë periudhës 2019–2021¹⁰⁶, institucionet dhe OJF-të kanë zhvilluar veprimtari informuese dhe ndërgjegjëse, botuar dhe shpërndarë botime për të drejta të kategorive të viktimave, veçanërisht viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit, të dhunës me bazë gjinore, fëmijët, të huajt, personat LGBTI+ dhe viktimat e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Drejtorja e Ndihmës Juridike ka zhvilluar aktivitete, për të informuar viktimat në lidhje me ndihmën juridike, kryesisht viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit. Studime kombëtare janë kryer në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, dhunën ndaj fëmijëve, gjuhën e urrejtjes.

Çdo vit, zhvillohen fushata të ndërgjegjësimi të publikut kundër dhunës me bazë gjinore, në kuadër të 16 ditëve ndërkombëtare të aktivizimit, apo dhe koordinimit të fushatave, që adresojnë stereotipat gjinorë dhe praktikatat tradicionale të dëmshme.

Në këtë kuadër, me qëllim rritjen e sensibilizimit të shoqërisë në luftën dhe në mbrojtjen e viktimave të krimit, në strategji është parashikuar një masë posaçërisht, për organizimin e javës së dedikuar të mbrojtjes së viktimave të krimit, e cila është parashikuar të realizohet nëpërmjet disa aktiviteteve të cilat lidhen me dizenjimin e fushatës, vendosjen e sloganit, organizimin e ditëve të hapura, udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë.

Një platformë *online* “Njohligjin.al”¹⁰⁷ është një formë e edukimit ligjor të publikut, që ofron informacion qytetarëve për jetën e tyre të përditshme. Platforma përmban informacion të përgjithshëm, në formë pyetje-përgjigje, që kanë interes për viktimat, si: shpërblimi i dëmit në rastin e

vdekjes së një personi, për fëmijët viktimë, informacion në rastet e aksidenteve automobilistike, si dhe ndihmë juridike falas të ofruar nga shteti. Një nga sfidat e informimit *online* është përditësimi në kohë reale i informacionit, formati dhe gjuha miqësore e platformave *online* për çdo përdorues.

Për të luftuar fenomenin e “gjuhës së urrejtjes” në të gjitha dimensionet që ai shfaqet në shoqërinë shqiptare, në vitin 2020 u krijua Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes, në të cilin përfshihen: Avokati i Popullit (AP), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) dhe Këshilli Shqiptar i Medias¹⁰⁸. Avokatit i Popullit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike (DAP) hartuan udhëzuesin “Për parandalimin dhe adresimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës në institucionet e administratës shtetërore”¹⁰⁹.

OJF-të e grave kanë krijuar Rrjetin e Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe kanë krijuar një *website*¹¹⁰, që përmban informacione të dobishme në fushë për legjislacionin dhe viktimat e krimit. Gjatë viteve të fundit viktimat dhe mbrojtja e tyre kanë qenë më shumë në fokus të Kuvendit të Shqipërisë. Disa komisione dhe nënkomisione parlamentare dhe grupimet parlamentare vullnetare janë të angazhuara në këtë fushë. Disa rezoluta të Kuvendit të Shqipërisë adresojnë rekomandime konkrete për institucionet dhe organet e pavarura që raportojnë në Kuvend. Bashkëpunimi mes institucioneve është rritur dhe duhet të vijojë të konsolidohet¹¹¹.

¹⁰⁶ Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit 2020–2023 të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut, janar–dhjetor 2020, f. 93–150. Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-Vjetor-2020-n%C3%AB-zbatim-t%C3%AB-SELP.pdf>. Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit 2020–2023 të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021, botim i Ministrisë së Drejtësisë, f. 100–166. Shih: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Draft-Raporti-Vjetor-2021-SELP.pdf>

¹⁰⁷ Nismë e prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Shih: <http://www.njohligjin.al/rreth-faqes/>

¹⁰⁸ Memorandumi i Bashkëpunimit mbi Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes u nënshkrua në dhjetor 2019.

¹⁰⁹ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimitaris%C3%AB%20s%C3%AB%20institucionit%20t%C3%AB%20AP%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf> avokati popullit.gov.al

¹¹⁰ <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/>

¹¹¹ Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet rezolutës së miratuar më datë 7.7.2021, i ka kërkuar institucionit të Avokatit të Popullit hartimin e një raporti mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri. Raporti i hartuar për çështjet e dhunës në familje dhe ndaj grave për periudhën janar 2020–shtator 2021, dërguar Kuvendit të Shqipërisë.

Shih: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20MONITORIM%20DHUN>



Forumi i Shqipërisë civile për komunitetin LGBTI+ 2018¹¹² është një mundësi e mirë për forcimin e bashkëpunimit mes parlamentarëve dhe organizatave që përfaqësojnë komunitetin LGBTI+.

Në këtë kontekst, referuar rekomandimeve të direktivës 2012/29/BE, ka dalë si domosdoshmëri konsolidimi i bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe institucioneve ligjzbatuese, me qëllim forcimin e të drejtave të viktimave të krimit. Ndaj dhe strategjia ka të parashikuar vijimin e fushatave të informimit, sensibilizmit dhe ndërgjegjësimi të publikut, të viktimave dhe institucioneve për të drejtat e viktimave, mekanizmat dhe shërbimet mbështetëse për to, në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030, 100% e publikut shqiptar është informuar dhe ndërgjegjësuar mbi të drejtat që ka çdo kategori, viktimë e krimit, e përfshirë në këtë strategji.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekti i specifik 1.1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe të shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

1.11 Informimi i viktimave të krimit për të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve;

1.1.2 Përdorimi nga publiku i portalit *online* me informacion për të drejtat e viktimës dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtjen e tyre;

1.1.3 Informimi i publikut mbi të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve për viktimat e krimit.

1.1.4 Organizimi i javës së dedikuar të mbrojtjes së viktimave të krimit (14–22 shkurt, çdo vit, dizenjimi i fushatës, slogani etj.).

Treguesit kryesorë:

- Përqindja në rritje e publikut shqiptar të

informuar dhe të ndërgjegjësuar mbi të drejtat që ka çdo kategori viktimë e krimit e përfshirë në Strategjinë për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit;

Portali *online*, me informacion për të drejtat e viktimës dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtjen e tyre i krijuar dhe funksional;

- Numri i fushatave të organizuara në kuadër të javës së dedikuar, të mbrojtjes së viktimave të krimit.

Objekti i specifik 1.2: Ndërtimi/fuqizimi i mekanizmave të raportimit të krimit nga viktimat mes rritjes së besimit, sigurisë dhe ofrimit të shërbimeve nga profesionistë të trajnuar për të drejtat dhe nevojat e viktimave

Gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e raportimit të dhunës në familje nga viktimat e krimit dhe pranë të gjithë mekanizmave të referimit të koordinuara dhe të ngjitur në nivel vendor. Megjithatë, një pjesë e krimeve nuk raportohen. Disa viktima, si viktimat e dhunës në familje, të dhunës seksuale, personat LGBT+, raportojnë në qendrat që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për viktimat.

Mjedisi për pritjen dhe marrjen e kallëzimit nga viktima jo gjithnjë është miqësor për të. Ndonëse janë krijuar disa mjedise miqësore në polici, prokurori ose gjykata, ato nuk janë të aksesueshme për çdo viktimë në të gjithë territorin. Ka disa përmirësime në lidhje me krijimin e qendrave të ofrimit të shërbimeve në një vend, veçanërisht për viktimat fëmijë të abuzimeve seksuale.

Gjatë 5 vjetëve të fundit, kallëzimet e veprave penale në prokurori që ndiqen mbi ankimin e viktimës janë në nivele të ulëta (888 në total) dhe vetëm dy kallëzime janë bërë nga personeli mjekësor;

Ka një rritje të vëmendjes për të drejtat e viktimave dhe të drejtat e tyre në të gjitha fazat e procedimeve penale. Megjithatë, ka një diferencë mes procedimeve penale të regjistruara dhe atyre të dërguara në gjykatë, si dhe mes numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë dhe atyre të dënuar, sidomos në rastin e krimeve seksuale ndaj të miturve.

Ndonëse KP-ja, parashikon dënime penale të rënda, kur vepra penale kryhet ndaj disa kategorive të viktimave, si: gratë, fëmijët, për shkak të urrejtjes, për shkak të marrëdhënieve familjare, statistikat



zyrtare mundësojnë të dhëna të pakta për zbatimin e politikave penale ndaj disa kategorive të viktimave.

Veprimtaritë informuese, ndërgjegjësuere për raportimin e veprave penale, lehtësimi i procedurave për raportimin, krijimi i një mjedisi miqësor për raportim dhe rritja e besimit të viktimave te institucionet janë adresuar në SNMVK 2024–2030.

Ky objektiv specifik synon edhe komunikim efektiv me viktimat e krimit, bazuar në nevojat specifike të tyre, në përputhje me direktivën 2012/29/BE, e cila parashikon garancitë për komunikimin e viktimës, dhënien e një informacioni të bazuar në nevojat e saj dhe të drejtën e viktimës për t'u shoqëruar në kontaktin e parë nga një person të zgjedhur prej saj ose që pranohet me qëllim për ta mbështetur moralisht.

Ligji për Policinë e Shtetit nuk parashikon rregulla të veçanta për teknikat e komunikimit me viktimat ose mundësinë e shoqërimit të viktimës nga një person i zgjedhur ose i pranuar prej saj. Manuale të hartuara për policinë përmbajnë udhëzime, në lidhje me teknikat e komunikimit me viktimat, veçanërisht viktimat e dhunës në familje, personave LGBTI+, krimet e urrejtjes dhe fëmijët viktimë.

KPP-ja parashikon të drejtën e personit (përfshirë viktimën) të komunikojë në gjuhën e vet dhe të drejtën të ndihmohet nga një përkthyes, nëse nuk kupton gjuhën shqipe. Personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar kanë të drejtë të përdorin gjuhën e shenjave dhe të asistohen nga interpretues të gjuhës së shenjave. KPP-ja (neni 58) nuk shprehet qartë në lidhje me të drejtën e komunikimit në një gjuhë të kuptueshme për çdo viktimë, për shembull me personat që kanë një nivel arsimor dhe intelektual të tillë, që nuk mund të kuptojnë ligjin dhe procedurat ligjore.

Sa më sipër, strategjia ka adresuar nevojën për përmirësime të KPP-së, ligjin për Policinë e Shtetit ku të parashikohet qartë e drejta e viktimës për të komunikuar me një gjuhë që kupton dhe kuptohet gjatë gjithë ndërveprimeve të saj me institucionet e ndryshme dhe për të garantuar të drejtën e shoqërimit nga një person i besuar, në rastet kur viktimë kërkon ndihmë dhe rastet e përjashtimit të një personi për të qenë shoqërues.

Në këtë kontekst, janë parashikuar aktivitete për rishikimin e deklaratës së të drejtave të viktimës dhe hartimi i saj në një gjuhë miqësore, bazuar në nevojat specifike të viktimave të krimit, sigurimi 24 orë në 7 ditë të javës, të paktën të një numri të caktuar të profesionistëve të trajnuar për viktimat e krimit në prokurori dhe polici, rritja në mënyrë progresive e numrit të interpretëve të gjuhës së shenjave dhe sigurimi i një grupi interpretësh të mjaftueshëm dhe të disponueshëm për të garantuar respektimin e së drejtës për interpretim¹¹³, krijimi i një grupi përkthyesish të trajnuar për teknikat e komunikimit me viktimat dhe sigurimi i shërbimeve të disponueshme për viktimat që flasin ose nuk kuptojnë gjuhën shqipe¹¹⁴, krijimi i një grupi psikologësh asistues të disponueshëm për viktimat e krimit në polici dhe gjykatë.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030, çdo kategori viktime e krimit ka mundësi të raportojë krimin në institucionet përgjegjëse, si dhe të marrë shërbimet mbështetëse dhe mbrojtëse të tyre.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekivi specifik 1.2 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

1.2.1 Krijimi i mjediseve të sigurta dhe të aksesueshme për çdo viktimë të krimit në polici, prokurori dhe gjykatë;

1.2.2 Komunikim efektiv me viktimat e krimit, bazuar në nevojat specifike të tyre;

1.2.3 Përmirësime ligjore, të nevojshme, për mirëfunksionimin e përfaqësuesve proceduralë për viktimat e krimit, në procesin penal.

Treguesit kryesorë:

- Numri i mjediseve të sigurta dhe të

¹¹³ Neni 58 i KPP-së, i ndryshuar “Të drejtat e viktimës së veprës penale. Viktimë ka drejtë të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar”.

¹¹⁴ Neni 58 i KPP-së, i ndryshuar “Të drejtat e viktimës së veprës penale. Viktimë ka drejtë të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar”.



aksesueshme për çdo viktimë të krimit të krijuara në polici, prokurori dhe gjykatë;

- Përqindja në rritje e viktimave të krimit të cilët janë të kënaqur nga shërbimet në lidhje me komunikimin dhe informimin efektiv të tyre që në kontaktin e parë.

Qëllimi politik 2

Një kuadër ligjor i përafuar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit.

Të drejtat e viktimave të krimit në drejtësinë penale ishin pjesë e Reformës në Drejtësi. Standardet minimale të të drejtave të viktimave u parashikuan në KPP, të ndryshuar dhe në KDPM. Mekanizma kombëtarë dhe vendorë për referimin dhe menaxhimin e rasteve të viktimave janë krijuar dhe funksionojnë. Megjithatë, përkufizimi i termit “viktimë e krimit”, “të afërm të viktimës”, dhe “trashëgimtarë të viktimës”, të drejtat dhe përparësitë e tyre janë të nevojshme të përkufizohen dhe sipas standardeve të përcaktuara në direktivat e BE-së.

Në referim të raportit të analizës për gjendjen e viktimave të krimit në Shqipëri, rezulton se nuk ka një vlerësim të plotë dhe të përditësuar të nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar për të drejtat e viktimave me direktivat e BE-së. Në këtë kuadër janë parashikuar masa konkrete për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së dhe me rekomandimet e mekanizmave monitorues të konventave, ku shteti shqiptar është palë.

Gjithashtu, ky qëllim politik synon edhe krijimin e një skeme kompensimi të viktimave të krimit, sipas rekomandimeve të direktivës së Këshillit 2004/80/KE e 29 prillit 2004, ku referuar gjetjeve të raportit të analizës për viktimat e krimit rezulton se duhet miratuar një ligj i posaçëm për të mundësuar zbatimin e kësaj konvente. Ndaj dhe Strategjia ka adresuar nevoja për miratimin e një ligji për kompensimin e viktimave nga shteti, i cili duhet të përcaktojë kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga direktiva dhe të përcaktojë skemën e kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme nga shteti.

Gjatë viteve të fundit janë shënuar përparime në lidhje me trajnimet e policisë, të prokurorëve, gjyqtarëve, avokatëve, ndërmjetësuesve, psikologëve etj., për trajtimin e viktimave në përgjithësi, viktimat

me nevoja specifike në veçanti. Është për t'u vlerësuar që, trajnimet ofrohen nga institucionet përkatëse dhe/ose në bashkëpunim me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë që veprojnë në këtë fushë. Të dhëna të plota dhe të përditësuara për numrin e profesionistëve të trajnuar për të drejtat e viktimat dhe nevojat e tyre, nuk u mundësuan. Sensibilizimi, ndërgjegjësimi dhe trajnimi i profesionistëve në lidhje me të drejtat e viktimave dhe trajtimin e tyre sipas nevojave vlerësohet si garanci për të parandaluar riviktimizimin dhe viktimizimin dytësor të viktimave të krimit.

Në këtë kontekst, Strategjia ka adresuar masa konkrete për trajnimin dhe specializimin e punonjësve të policisë, mjekët ligjore, psikiatër, psikologët, punonjësit socialë, punonjësit e shërbimit të provës dhe institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale (burgjet), shërbimet mbështetëse të tjera dhe administrative në kontakt me viktimat.

Statistika të konsoliduara për viktimat e krimit, të mbledhura, përpunuara dhe publikuara sipas standardeve ndërkombëtare, në këtë strategji kanë marrë një fokus të veçantë për faktin se nga studimet e zhvilluara nga organizatat vendëse dhe ndërkombëtare, janë vërejtur mangësi në këtë fushë. Në vendin tonë janë zhvilluar anketa kombëtare periodike për viktimat e krimit, por nuk kemi ende një praktikë të konsoliduar. Një pjesë e akteve nënligjore, në fuqi, që lidhen me metodologjinë e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të krimit, nuk përmbajnë rregulla në lidhje me statistikën e viktimave të krimit. Nevoja për përmirësime të metodologjisë, sistemeve dhe praktikave në lidhje me statistikën për viktimat e krimit, është adresuar.

Objektivi specifik 2.1: Përafrimi i legjislacionit penal, procedural penal dhe ligjeve të tjera që adresojnë të drejtat e viktimave me *acquis* e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera;

Objektivi specifik 2.2: Krijimi i një skeme kompensimi të drejtë dhe të përshtatshëm për viktimat e krimit;

Objektivi specifik 2.3: Politika efektive për mbrojtjen e viktimave të krimit bazuar në statistika të hartuara sipas standardeve ndërkombëtare;

Objektivi specifik 2.4: Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për viktimat e krimit për respektimin e të drejtave të tyre.



Lidhja midis qëllimit politik 2 dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 2, lidhet me OZHQ 16, i cili promovon shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, ky qëllim lidhet me nënobjektivin 16.10, i cili synon: *“Të sigurojë aksesin e publikut në informacion dhe të mbrojë liritë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”*.

Objekti i specifik 2.1: Përafrimi i legjislacionit penal dhe procedural penal dhe ligjeve të tjera që adresojnë të drejtat e viktimave me *acquis* e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera

Ky objektivi, synon përmirësimet e kuadrit ligjor dhe të politikave të mbrojtjes së viktimave të krimit, nevojë e vënë në dukje edhe nga institucionet monitoruese kombëtare, si: AP-ja¹¹⁵, KMD-ja, mekanizmat monitorues të konventave ku shteti shqiptar është palë¹¹⁶ dhe partnerët/organizatat vendëse dhe ndërkombëtare që punojnë me dhe për viktimat dhe të drejtat e tyre.

Direktivat dhe rregulloret e BE-së në lidhje me viktimat, parandalimin dhe luftimin e formave të veçanta të krimeve që shkaktojnë viktimat të shumta, adresojnë masa ligjore, institucionale, garanci dhe të drejta minimale që shtetet anëtare ose potenciale për të qenë anëtare të BE-së duhet të adresojnë në legjislacionin kombëtar¹¹⁷.

Disa prej tyre janë parësore në procesin e përafrimit të legjislacionit, konkretisht:

- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 25 tetor 2012, për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe

që zëvendëson vendimin kuadër të Këshillit 2001/220/JHA;

- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 5 prill 2011, për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij dhe zëvendësimi i vendimit kornizë i Këshillit 2002/629/JHA;

- Direktiva e 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 13 dhjetor 2011 në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve;

- Direktiva (EU) 2017/541 e Parlamentin Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 15 mars 2017 Për luftimin e terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit kornizë 2002/475/JHA dhe ndryshimin e 2005/671/JHA;

- Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 13 dhjetor 2011 mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale;

- Direktiva e Këshillit Evropian 2004/80/KE e datës 29 prilli 2004 lidhur me kompensimin e viktimave të krimit;

- Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij.

Në referim të raportit të analizës për gjendjen e viktimave të krimit në Shqipëri, rezulton se nuk ka një vlerësim të plotë dhe të përditësuar të nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar për të drejtat e viktimave me direktivat e BE-së, në këtë kuadër është i rekomandueshëm parashikimi i masave konkrete për përafrimin e legjislacioni shqiptar me direktivat e BE-së dhe me rekomandimet e mekanizmave monitorues të konventave, ku shteti shqiptar është palë.

¹¹⁵ Raport i Avokatit të Popullit mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020–shtator 2021, vep. e cituar.

¹¹⁶ Për më shumë shih: GREVIO's (Baseline) Evaluation Report on legislative and other measures giving effect to the provisions of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention) ALBANIA <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>; <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/category/rekomandime-raporte-te-cedaw-grevio-dhe-upr-per-shqiperine/>; <https://www.coe.int/en/web/anti-human>

[trafficking/albania](https://rm.coe.int/trafficking/albania) Raporti i ECRI-it për Shqipërinë, raundi 5, Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i pestë monitorues) miratuar më 19 mars 2015 botuar më 9 qershor 2015, f. 11–12. Shih: <https://rm.coe.int/fifth-report-on-albania-albanian-translation-/16808b54e9>

Recommendation CP/Rec(2020)06 on the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Albania: <https://rm.coe.int/cp-rec-2020-06-alb-en/1680a09acc>

¹¹⁷ Detyrimet që burojnë nga direktivat dhe udhëzimet e BE-së trajtohen në krerët në vijim.



Në këtë objektiv janë adresuar disa masa, me qëllim transpozimin në legjislacionin shqiptar, të direktivave të BE-së, të cilat priten të realizohen nëpërmjet aktiviteteve konkrete ku fillimisht do të bëhet vlerësimi i nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së (TOC), hartimi i vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA), hartimi i propozimeve për nisma ligjore për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivat dhe miratimi i tyre, hartimi i komentareve për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar, vlerësime periodike të shkallës së zbatimit të legjislacionit të miratuar (*Expost*).

Rezultati i pritshëm:

- Qeveria shqiptare ka siguruar një kuadër ligjor që ofron mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit të përafruar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera deri në fund të vitit 2030.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 2.1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 2 dhe nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e progresraportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

2.1.1 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2012/29/EU;

2.1.2 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/36/EU;

2.1.3 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/92/EU;

2.1.4 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2017/541/EU.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e ligjeve/akteve nënligjore, të hartuara në përputhje me direktivat e BE-së për

çështje që lidhen me mbrojtjen e viktimave të krimit.

Objektivi specifik 2.2: Krijimi i një skeme kompensimi të drejtë dhe të përshtatshëm për viktimat e krimit

Ky objektiv specifik konsiderohet si një nga risitë e kësaj strategjie pasi synon krijimin e një skeme të re kombëtare kompensimi të viktimave të veprave penale dhe garantimi i një kompensimi të drejtë e të përshtatshëm për viktimat, në përputhje me standardet më të mira sipas direktivës 2004/80/EC¹¹⁸ të BE-së.

Kjo direktivë përcakton standardet në lidhje me kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme të kryera në një shtet tjetër anëtar, si: e drejta e viktimës të paraqesë kërkesën në vendin ku viktimat është rezident, pagesa e kompensimit nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar në territorin e të cilit është kryer krimi, e drejta e aplikuesit për të pajisur me informacion thelbësor për kompensimin dhe mundësitë për të aplikuar për kompensim, afrimi i asistencës për mundësinë e aplikimit sipas formatit të përcaktuar nga direktiva, dërgimi i aplikimit dhe dokumentacionit mbështetës sa më shpejt të jetë e mundur tek autoriteti vendimmarrës në gjuhën e përcaktuar nga direktiva, e drejta për të kërkuar konfirmimin e marrjes së aplikimit; dëgjimi i aplikantit si dëshmitar ose dëgjimi i ekspertit nga autoriteti vendimmarrës, ose nga autoriteti ndihmës, me baza vullnetare.

Direktiva përcakton detyrimin e krijimit ose emërimit të një ose disa autoriteteve vendimmarrëse që do të vendosin për kompensimin e viktimës, parashikimi i sa më pak formaliteteve administrative që duhet të përmbushë aplikanti për kompensim, transmetimi i aplikimit sa më shpejt të jetë e mundur tek autoriteti vendimmarrës, informimi i autoritetit ndihmës dhe aplikantit në lidhje me personin e kontaktit ose departamenti përgjegjës për trajtimin e çështjes, informimi i kohës së përafërt kur mund të merret një vendim mbi aplikimin, nëse është e mundur, detyrimi për autoritetin ndihmës, nëse është e nevojshme, duhet t'i ofrojë aplikantit udhëzime të përgjithshme për të plotësuar çdo kërkesë për informacion shtesë nga autoriteti vendimmarrës dhe përcjellja e dokumentacionit të autoritetit vendimmarrës, shërbimet falas të ofruara nga autoriteti ndihmës. Direktiva parashikon që ligji

¹¹⁸ Sqarim: të shtetasve të shteteve palë në këtë Konventë dhe të shtetasve të të gjitha shteteve anëtare të Faqe| 22246

Këshillit të Evropës, që janë me banim të përhershëm në shtetin, në territorin e të cilit është kryer krimi



mund të përcaktojnë rregulla më të favorshme për të mirën e viktimave të krimit ose çdo personi tjetër të prekur nga krimi.

Direktiva kërkon krijimin e një skeme kombëtare të kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme të qëllimshme të kryera në territoret e tyre përkatëse, e cila garanton kompensimin e drejtë dhe të përshtatshëm për viktimat. Në aspektin e bashkëpunimit ndërkufitar emërimin e një pike kontakti qendrore që mban kontaktet dhe transmeton informacionin te komisioni, nxit bashkëpunimit dhe shkëmbimet të informacionit ndërmjet autoriteteve ndihmëse dhe vendimmarrëse në shtetet anëtare dhe dhënien e ndihmës dhe kërkimit të zgjidhjeve për çdo vështirësi.

Ministria e Drejtësisë është përcaktuar si autoriteti qendror për zbatimin e Konventës. Republika e Shqipërisë ka bërë një rezervë ligjore në lidhje me rrethin e personave të varur nga viktima. Direktiva për kompensimin e viktimave të krimeve adreson kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, të kryera me qëllim. Deri më sot, nuk është miratuar një ligj i posaçëm për të mundësuar zbatimin e konventës.

Me qëllim respektimin e së drejtës së viktimës për kompensim nga shteti, është i nevojshëm miratimi i një ligji të posaçëm që të përcaktojë skemën e kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme. Së pari është e nevojshme të përcaktohen krimet e dhunshme me qëllim që të orientohen profesionistët në zbatimin e së drejtës për kompensimin e viktimave. Ligji duhet të përcaktojë subjektet përfituese, kategoritë e dëmeve që mund të kompensohen, procedurat e kompensimit të shtetasve të huaj viktima të krimeve të dhunshme të kryera në territorin e Republikës Shqipërisë, rastet e pakësimit ose refuzimit të kompensimit, procedurat e informimit të viktimës dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të lidhjes së ndërsjellë.

Nga ana tjetër, kompensimi i viktimës në bazë të vendimit të marrë në procesin penal kërkon një ndërgjegjësim të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Raporte të ndryshme përmbajnë të dhëna për trajnime të kryera nga Shkolla e Magjistraturës në lidhje me viktimat si aksesit në drejtësi, mbështetja e viktimës para, gjatë dhe pas procedimit penal, identifikimin e viktimave të trafikimit, hetimin e veprave penale të trafikimit, kompensimin e viktimave të trafikimit, konfiskimin e pasurive dhe keqtrajtimit dhe shfrytëzimit e

fëmijëve. Megjithatë përmirësimet e konstatuara, theksohet nevoja për rritje të kapaciteteve të profesionistëve.

Rekomandimet e institucioneve monitoruese vendëse dhe ndërkombëtare janë adresuar në SNMVK 2024–2030, të cilat kanë parashikuar masa/aktivitete për këtë qëllim.

Rezultati i pritshëm:

- Skema kombëtare e kompensimit për viktimat e veprave penale, të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë, është aprovuar dhe është funksionale, deri në fund të vitit 2030.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekti specifik 2.2 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 2 dhe nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e progresraportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

2.2.1 Krijimi i një skeme të re kombëtare kompensimi të viktimave të veprave penale dhe garantimi i një kompensimi të drejtë e të përshtatshëm për viktimat, në përputhje me standardet më të mira evropiane sipas direktivës 2004/80/EC;

2.2.2 Inkurajimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve që të përdorin të gjitha mundësitë që ligji u ofron atyre të mbështesin kërkesat e viktimave për kompensim;

2.2.3 Funksionimi i organeve/strukturave ndihmëse dhe përgjegjëse vendimmarrëse për aplikimet e mundshme për kompensim dhe ofrimin e shërbimeve të tjera mbështetëse;

2.2.4 Sigurimi i aksesit në informacion të viktimave të veprave penale lidhur me mundësitë për aplikim për kompensim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

2.2.5 Krijimi i aksesit të viktimave të veprave penale, shtetasve rezidentë në një shtet të huaj, në një kompensim të drejtë nga shteti.

Treguesit kryesorë:

- Skema e re kombëtare e kompensimit të viktimave për veprat penale e krijuar dhe funksionale;



- Numri i viktimave të krimit të kompensuar në mënyrë të drejtë dhe të përshtatshme.

Objektivi specifik 2.3: Politika efektive për mbrojtjen e viktimave të krimit bazuar në statistika të hartuara sipas standardeve ndërkombëtare

Referuar raportit të analizës për gjendjen e viktimave të krimit në Shqipëri, rezulton se, metodologjia e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për viktimat e krimit nuk është e standardizuar. Një pjesë e akteve nënligjore në fuqi, në lidhje me metodologjinë e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të krimit, nuk përmbajnë rregulla në lidhje me statistikat e viktimave të krimit. Edhe nëse një detyrim i tillë është parashikuar, ato nuk zbatohen në praktikë për shkak të mungesës së sistemit të integruar të të dhënave ose të mosfunksionimit të tyre, mungesës së infrastrukturës dhe burimeve njerëzore. Pasja e një përkufizimi të standardizuar të viktimës së krimit, anëtarëve të familjes, krimeve të dhunshme do të mundësojë mbledhjen, përpunimin dhe botimin e statistikave më të krahasueshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Legjislacioni shqiptar parashikon rregulla të detajuara për mbrojtjen e të dhënave personale të viktimave të krimit gjatë procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Nevoja për përmirësime të metodologjisë, sistemeve dhe praktikave të lidhje me statistikat për viktimat e krimit është adresuar në këtë strategji.

Studime dhe anketa kombëtare janë kryer për të studiuar viktimat dhe nivelin e viktimizimit në vendin tonë. Shqipëria është pjesë e studimeve rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e studimit të krimit dhe të viktimave. Megjithatë përmirësimet e kryera gjatë viteve të fundit, statistikat zyrtare të policisë, prokurorisë, gjykatave dhe të institucioneve të tjera përmbajnë të dhëna të pjesshme për viktimat. Të dhënat për viktimat e krimit janë fragmentare, nuk publikohen në kohë dhe për të gjitha kategoritë e viktimave dhe kanë nevojë të bashkërendohen.

Raportimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje bëhet me mënyra të ndryshme dhe për subjekte të ndryshme¹¹⁹. Rezulton se të dhënat për

viktimat e krimit kanë nevojë të bashkërendohen.

Metodologjia e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave ka nevojë të rishikohet, bazuar në standardet ndërkombëtare në lidhje me statistikat e krimit dhe viktimat.

Perspektiva gjinore do të integrohet në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e SNMVK 2024–2030, si dhe programeve të shpenzimeve, me synimin për të promovuar barazinë midis grave dhe burrave dhe luftimin e diskriminimit, si dhe adresimin e çështjes së përfaqësimit të grave dhe burrave në çështjet që lidhen me mbrojtjen e viktimave të krimit.

Rezultati i pritshëm:

- Statistika të përmirësuara për mbrojtjen e viktimave të krimit, deri në fund të vitit 2030, që ndihmojnë profesionistët të ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 2.3 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 2 dhe nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e progresraportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

2.3.1 Statistika të konsoliduara për viktimat e krimit, të mbledhura, përpunuara dhe publikuara sipas standardeve ndërkombëtare.

Treguesit kryesorë:

- Numri i raporteve statistikore të publikuara çdo vit nga çdo institucion që punon për mbrojtjen e viktimave të krimit.

Objektivi specifik 2.4: Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për viktimat e krimit për respektimin e të drejtave të tyre

Trajnimi i profesionistëve që janë në kontakt me viktimat adresohet në ligje dhe akte nënligjore të ndryshme¹²⁰. KPP-ja nuk parashikon rregulla

¹¹⁹ Viktima e dhunës në familje ose formave të tjera të dhunës me bazë gjinore mund të raportojë në polici, të koordinatorët vendorë në bashki ose njësinë administrative, mes Linjës Kombëtare të Këshillimit 116 117, aplikacionin digital Bright Sky; fëmijët mund të raportojnë edhe mes Faqe | 22248

linjës AALO 116, viktimat e krimeve të urrejtjes mund të raportojnë edhe mes platformës online: isigurt@crca.al ofruar nga CRCA/ECPAT.

¹²⁰ Nenet 25–32 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.



specifike në lidhje me trajnimin dhe specializimin e profesionistëve që janë në kontakt me viktimat e rritura.

Gjatë viteve të fundit janë shënuar përparime në lidhje me trajnimet e punonjësve të policisë, prokurorëve, gjyqtarëve, avokatëve, ndërmjetësuesve, psikologëve dhe të tjerë punonjës të kësaj fushe, për trajtimin e viktimave në përgjithësi, viktimat me nevoja specifike në veçanti, si: viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat fëmijë, viktimat e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, viktimat e dhunës seksuale, viktimat e krimeve të urrejtjes dhe personat LGBTI+.

Gjatë periudhës 2020–2023 janë trajnuar 1234 punonjës policie për aspekte të ndryshme që lidhen me viktimat¹²¹. Profesionistët që ofrojnë shërbime për viktimat janë trajnuar nga institucionet përkatëse dhe/ose në bashkëpunim me partnerë vendës dhe ndërkombëtarë, që operojnë në këtë fushë. Organizatat e shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë ofrojnë shërbime mbështetëse, ndihmë juridike, këshillime, strehim etj., dhe për viktimat me nevoja të veçanta, trajnime për profesionistët në fushën e mbrojtjes së tyre.

Direktiva që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, adreson trajnimin e përgjithshëm dhe të specializuar në një nivel që është i përshtatshëm të punonjësve të policisë dhe stafit të gjykatës që janë në kontakt me viktimat për t'i pajisur me aftësitë për trajtimin e viktimave në mënyrë të paanshme, profesionale dhe me respekt, trajnimin e përgjithshëm dhe të specializuar të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve të përfshirë në procedim penal për rritjen e ndërgjegjësimin të tyre për nevojat e viktimave, trajnimin e profesionistëve dhe respektimin e standardeve profesionale nga punonjësit e shërbimeve publike dhe jopublike që ofrojnë mbështetje për viktimat, si dhe shërbimet e

drejtësisë restauruese. Direktiva e vë theksin në pajisjen e profesionistëve me aftësinë për të identifikuar dhe për t'i trajtuar viktimat me respekt, profesionalizëm dhe në mënyrë jodiskriminuese. Kërkesa për trajnimin e profesionistëve parashikohen edhe në direktivat e tjera¹²².

Ky objektiv adreson disa sfida: vlerësimin dhe përditësimin e programeve të formimit fillestar dhe vazhdues të të gjithë profesionistëve që janë në kontakt me viktimat. Inkurajimi i KLGJ-së dhe KLP-së, PP-së, SHM-së, magistratëve, avokatëve, ndërmjetësuesve, për vijimin e trajnimeve vazhduese për viktimat dhe nevojat e tyre. Vijimi i forcimit të kapaciteteve të të gjithë profesionistëve të tjerë në lidhje me viktimat, nevojat dhe trajtimet e tyre. Zgjerimi në territor të shërbimeve për viktimat e krimit dhe forcimi i bashkëpunimit me OJF-të, si dhe rritja e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të viti 2030, 100% e profesionistëve që punojnë me dhe për viktimat e krimit janë të trajnuar në lidhje me të drejtat e viktimave të krimit.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objekivi specifik 2.4 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, nenin 2 dhe nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e progresraportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

2.4.1 Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues nga çdo institucion që punon me dhe për viktimat;

2.4.2 Krijimi/përditësimi i regjistrave të

parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij dhe zëvendësimin”; vendimi kornizë i Këshillit 2002/629/JHA; neni 19 i direktivës (BE) 2017/541 së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit së datës 15 mars 2017 për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit kornizë të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e vendimit të Këshillit 2005/671/JHA.

¹²¹ Informacion mbi modulet e trajnimit të formimit fillestar dhe vazhdues me fokus mbrojtjen e viktimave të veprave penale, i përcjellë me email, më datë 19.5.2023 nga Akademia e Sigurisë, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit.

¹²² Direktiva e 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 13 dhjetorit 2011 në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, neni 23.

Neni 18 i direktivës 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit së datës 5 prill 2011 “Për



profesionistëve, të trajnuar/specializuar për të drejtat e viktimave;

2.4.3 Sigurimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike për të garantuar akses në shërbime cilësore për çdo viktimë;

2.4.4 Trajnimi i punonjësve të policisë, policisë gjyqësore, në lidhje me të drejtat e viktimave të krimit, për përdorimin e teknologjisë audio-video, teknikat e komunikimit dhe intervistimit dhe aspektet psikologjike, vlerësimin individual etj.;

2.4.5 Forcimi i kapaciteteve të mbrojtësve ligjore, të zgjedhur ose të caktuar, lidhur me të drejtat, teknikat e mbrojtjes dhe të komunikimit me viktimat e krimit;

2.4.6 Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve (psikologëve ndihmës, koordinatorë të viktimave, ekspertë dhe punonjës socialë).

Treguesit kryesorë:

- Regjistri i profesionistëve të trajnuar/specializuar për të drejtat e viktimave të krimit i krijuar dhe përditësuar;

- Numri i punonjësve të policisë, policisë gjyqësore, mbrojtësve ligjorë, psikologë, punonjës socialë, koordinatorë të viktimave të trajnuar, në lidhje me të drejtat e viktimave të krimit, për përdorimin e teknologjisë audio-video, teknikat e komunikimit dhe intervistimit dhe aspektet psikologjike, vlerësimin individual etj.

Qëllimi politik 3

Garantimi i së drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucione, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e tre objektivave specifike:

- **objektivi specifik 3.1:** Garantimi i së drejtës për informim dhe mbështetje të viktimave në procedimet penale;

- **objektivi specifik 3.2:** Garantimi i pjesëmarrjes së viktimave në procedimet penale;

- **objektivi specifik 3.3:** Garantimi i mbrojtjes së viktimave dhe njohja e viktimave me nevoja të veçanta.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i politikës III lidhet me objektivin 16 të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili promovon shoqëri

paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet me nënobjektivin 16.1 “Ulja në mënyrë të ndjeshme e të gjitha formave të dhunës dhe niveleve përkatëse të vdekjeve kudo” me nënobjektivin 16.2: Dhënia fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturimit të fëmijëve, me nënobjektivin 16.3: Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë, me nënobjektivin 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet, me nënobjektivin 16.10: Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Ky qëllim politik lidhet me objektivin 5: “Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i gjithë grave dhe vajzave” me nënobjektivin 5.1: “Dhënia fund të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave kudo” dhe me nënobjektivin 5.2: “Zhdukja e të gjitha formave të dhunës kundër të gjitha grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin dhe llojet e tjera të shfrytëzimit”, si dhe me nënobjektivin 5.3: “Zhdukja e praktikave të dëmshme, të tilla si martesat e hershme të fëmijëve dhe ato me detyrim, dhe gjymtimi gjenital i femrave” dhe me nënobjektivin 5.c: “Miratimi dhe forcimi i politikave të shëndosha dhe legjislacionit detyrues për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, në të gjitha nivelet”.

Gjithashtu SNMVK lidhet me objektivin 10. “Ulja e pabarazive brenda dhe ndërmjet shteteve” dhe me nënobjektivin 10.2: “Deri në vitin 2030, fuqizimi dhe promovimi i përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive të kufizuara, racës, përkatësisë etnike, origjinës, fesë, gjendjes ekonomike ose ndonjë gjendjeje tjetër”, si dhe me nënobjektivin 10.3: “Sigurimi i mundësive të barabarta dhe zvogëlimi i pabarazive në rezultate, duke përfshirë shfuqizimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjislacionit, politikave dhe veprimeve përkatëse në këtë drejtim”.

Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës e datës 25 tetor 2012, për



vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, ka për qëllim të sigurojë që viktimat e krimit të marrin informacionin, mbështetjen dhe mbrojtjen e duhur dhe të jenë në gjendje të marrin pjesë në një procedurë penale. Kjo direktivë respekton të drejtat themelore dhe parimet e njohura nga Karta e Themelore e të drejtave të Bashkimit Evropian. Në veçanti, promovon të drejtën për dinjitet, integritet fizik dhe mendor, lirinë dhe sigurinë, respektimin e privatësisë dhe jetës familjare, të drejtën e pronës, parimin e mosdiskriminimit, parimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të drejtat e fëmijës, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtën për një gjykim të drejtë.

Objekti i specifik 3.1: Garantimi i së drejtës për informim dhe mbështetje të viktimave në procedimet penale

Bazuar në rekomandimet e direktivës 2012/29 dhe gjetjeve të raport-analizës për situatën e viktimave të krimit, rezulton se në funksion të një procesi penal, viktimave duhet t'i garantohen teknika të posaçme komunikimi, të standardizohen procedura komunikimi, midis një punonjësi të policisë dhe viktimës¹²³ dhe të zhvillohen udhëzues me objekt ndërgjegjësimin e viktimave për të drejtën e zgjedhjes dhe të shoqërimit nga një person i besuar, i zgjedhur ose i pranuar prej saj. Në rastin kur, viktimat është e huaj, nuk e njeh gjuhën shqipe, ajo duhet të pajiset me deklaratën e të drejtave ose me konfirmimin e ankimit, të përkthyer në gjuhën që kupton viktimat ose me një kopje procesverballi, kur është bërë me gojë. Spektri i mbështetjes dhe mbrojtjes të të drejtave të viktimave në procedimet penale, shtrihet deri në krijimin e një rrjeti aktiv të përkthyesve dhe interpretëve, që mundësojnë asistencë gjuhësore të viktimave.

Nisur nga roli i të gjitha viktimave në procesin penal, ato kanë të drejtë të informohen rreth procedimit penal, me gojë, me shkrim ose me komunikim elektronik, në rastin kur viktimat e kërkon. E drejta për informim, përshin statusin e gjykimit, vendimin përfundimtar (nëse e kërkon), dhe njoftimin e viktimave, kur personi i arrestuar, i ndjekur penalisht ose i dënuar për veprën penale, lirohet ose arratiset nga burgu dhe përbën rrezik për të. Sipas rekomandimeve të direktivës

2012/29, lind nevoja për unifikimin e standardeve për njoftimin e viktimës, ku parashikohen arsyet për mosfillim ose pushim të procedimit penal, informimin e viktimave kur ndryshon mendim lidhur me të drejtën për informim, si dhe unifikimin e procedurave standarde të regjistrimit të njoftimit të viktimave, duke përcaktuar institucionin përgjegjës dhe rolin e shtuar në rastet e njoftimeve të viktimave në çështjet ndërkufitare.

Risia që sjell për herë të parë kjo Strategji, konsiston te përdorimi i teknologjisë së komunikimit, si videokonferenca, telefon ose internet, kur nuk nevojitet prania fizike e interpretuesit ose përkthyesit, me qëllim që viktimave t'i garantohet një proces i rregullt gjyqësor. Në përmbushje të këtij objekti, çdo institucion, paraprakisht vlerëson nevojat financiare, përditëson listën me kontaktet e personave që marrin përkthim ose interpretim, harton modele njoftimi të viktimave¹²⁴ dhe përditëson të dhëna për shtetasit e huaj, në kontakt me sistemin e drejtësisë, në veçanti viktimat që kanë nevojë për përkthim dhe interpretim.

Përgjatë viteve 2024–2030, synohen të ofrohen shërbime të specializuara mbështetëse, mbrojtje ligjore duke marrë parasysh nevojat specifike të viktimave, duke i trajtuar të gjitha viktimat me dinjitet, respekt dhe me ndjeshmëri. Me gjithë progresin e bërë, për ofrimin e programeve specifike për integrimin afatgjatë të viktimave të dhunës në familje, të trafikimit, këshillimin ligjor, psikologjik, banesa të specializuara, mbetet ende punë për të bërë lidhur me përmirësimin e shërbimeve mbështetëse, për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Ky objektiv vizionar synon gjithashtu të rrisë kapacitetet e punonjësve për identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, të viktimave të shfrytëzimit të prostitucionit, duke vlerësuar nevojat specifike, duke promovuar linjat e këshillimit *online* të viktimave, vlerësimin e shërbimeve, si dhe forcimin e programeve mbështetëse të viktimave edhe pas denoncimit të rastit.

Rezultati i pritshëm:

- 100% e viktimave të krimit deri në fund të vitit 2030 iu është garantuar e drejta për informim e mbështetje në proceset penale.

¹²³ Viktimat e dhunës në familje, personat LGBTI dhe viktimat e krimeve të urrejtjes, fëmijët viktimat.

¹²⁴ Për ditën, orën dhe vendin e gjykimit në gjuhë të ndryshme.



Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së “*Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut*”, me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane, të shteteve të tyre anëtare. Ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2022.

Masat:

3.1.1 Sigurimi i së drejtës së viktimës për të/t’u kuptuar dhe për t’u shoqëruar (neni 3 i direktivës 2012/29/EU);

3.1.2 Sigurimi i së drejtës së viktimës për të marrë informacion që në kontaktin e parë (neni 4 i direktivës 2012/29/EU);

3.1.3 Sigurimi i së drejtës së viktimës kur paraqet ankim (neni 5 i direktivës 2012/29/EU);

3.1.4 Sigurimi i së drejtës së viktimës për të marrë informacion për çështjen e saj/tij (neni 6 i direktivës 2012/29/EU);

3.1.5 Sigurimi i së drejtës së viktimës për përkthim dhe interpretim (neni 7 i direktivës 2012/29/EU);

3.1.6 Sigurimi i së drejtës së viktimës për qasje në shërbimet mbështetëse (neni 8 i direktivës 2012/29/EU);

3.1.7 Sigurimi i së drejtës së viktimës në shërbimet mbështetëse (neni 9 i direktivës 2012/29/EU);

3.1.8 Parandalimi i pengesave për raportimit e krimit nga viktimat dhe subjektet e tjera duke ofruar drejtësi për viktimat.

Treguesit kryesorë:

- Numri i viktimave të krimit për të cilët/cilat janë siguruar: e drejta për t’u kuptuar dhe shoqëruar, informacion që në kontaktin e parë, e drejta kur paraqet ankim, informacion për çështjen e saj/tij, përkthim/interpretim, shërbime mbështetëse.

Objektivi specifik 3.2: Garantimi i pjesëmarrjes së viktimave në procedimet penale

Ky objektivi specifik synon të garantojë të drejtën e viktimës për t’u dëgjuar, gjatë procedimit penal e të paraqesë prova. Në rastin kur viktimat është

fëmijë, dëgjohej duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e saj. Çdo viktimitë në sistemin e drejtësisë penale, disponon të drejtën për t’u njoftuar për mosfillim ose pushim të çështjes, përfundim të gjykimit. Ajo ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit, për mosfillim të procedimit dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake, për të pushuar akuzën ose çështjen, sipas garancive procedurale të përcaktuara në KPP.

Në këtë objektivi janë parashikuar programet e drejtësisë restauruese, mbrojtja e viktimës nga viktimizimi i dytë, i përsëritur, kanosja dhe hakmarrja dhe lehtësimi i procedurave për referimin e çështjeve në shërbimet e drejtësisë restauruese. Viktima ka të drejtë të përfitojë, që shërbimet e drejtësisë restauruese t’i marrë pa pagesë dhe marrëveshja të jetë lidhur me miratimin e saj dhe me vullnet të lirë. Bazuar në gjetjet e raport-analizës mbi gjendjen e viktimave, rezultojnë se programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit zbatohen pak. Prandaj, përmbushja e këtij objektivi synon shtrirjen e shërbimeve të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit, vlerësim të kuadrit ligjor lidhur me ndërmjetësimin, përmirësim të standardeve të shërbimeve të ndërmjetësimit, trajnim/specializim të ndërmjetësve dhe rishikim të programit të formimit fillestar/vazhdues të ndërmjetësuesve, si dhe moduleve përkatëse.

Viktimat me statusin e palëve në procedimet penale përfitojnë ndihmë juridike, sipas ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe përjashtohen nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë¹²⁵. Me gjithë progresin e bërë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, duhet të shtrijë shërbimet e ndihmës juridike falas, në të gjithë territorin e vendit, të vlerësojë programet e formimit fillestar/vazhdues, të rrisë kapacitetet e ofruesve të ndihmës juridike parësore/dytësore, sipas nevojave specifike të viktimave të krimit. Duhet gjithashtu, të mbledhë e të përpunojë të dhëna dhe të organizojë fushata informuese/ndërgjegjësuere për viktimat.

Direktiva 2012/29, parashikon se në këtë Strategji duhet të adresohen elemente të tilla që të informojnë viktimitë për të drejtën e kthimit të

¹²⁵ Neni 25 i ligjit nr. 111/2017.



pasurisë, kohën dhe procedurën e të inkurajohen prokurorët dhe gjykatësit për garantimin e kësaj të drejte. Një vëmendje të veçantë në këtë Strategji e zë dhe kompensimi i viktimës, nga autori i veprës penale, gjatë një procesi penal. Megjithatë, e drejta për kompensim e viktimës nga autori i veprës nuk ka gjetur zbatim, mbetet ende punë për të bërë në nxitjen e autorëve të veprave penale për kompensimin e viktimave dhe inkurajimin e gjyqtarëve, lidhur me vendimet e kompensimit të viktimës nga autori dhe informimin e lidhur me lehtësitë ligjore.

Risia që sjell kjo Strategji, synon respektimin e të drejtave të viktimave, rezidentë në një shtet tjetër. Kjo Strategji, me vizion të gjerë, është e mbështetur veçanërisht në rekomandimet e lëna në direktivën 2012/29 EU, e cila synon të adresojë të drejtat e një viktime rezidente në një shtet tjetër. Ajo ka të drejtën të marrë deklaratën dhe të komunikojë me anë të teknologjisë, të paraqesë ankesë, e cila duhet t'i përcillet autoriteteve të vendit ku është kryer vepra penale. Forcimi i bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike, është një tjetër komponent kryesor i kësaj Strategjie. Në përmbushjen e këtij objektiv, duhet të inkurajohen prokurorët dhe gjyqtarët, të nënshkruajnë marrëveshjet bilaterale midis shteteve për kompensimin e viktimave rezidente, të bëjnë trajnime për të drejtat e viktimës ndërkufitare dhe vlerësime të nevojave financiare për përdorim të teknologjisë në rastin kur viktimat banon në një shtet tjetër.

Rezultati i pritshëm:

- 100% e viktimave të krimit, deri në fund të vitit 2030, iu është garantuar e drejta për pjesëmarrje në procedimet penale.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.2 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” me nenin 2 të MSA-së “*Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut*”, me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian

për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

3.2.1 E drejta e viktimës për t'u dëgjuar gjatë procedimit penal dhe në marrjen e vendimeve për mosprocedimin (nenet 10–11 të direktivës 2012/29/EU);

3.2.2 E drejta e mbrojtjes së viktimës në kontekstin e shërbimeve të drejtësisë restauruese (direktiva 2012/29/EU);

3.2.3 Ofrimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për viktimat në përputhje me standardet evropiane;

3.2.4 Sigurimi i së drejtës së viktimës nëpërmjet dhënies së shërbimeve nga ndihma juridike falas. (neni 13, direktiva 2012/29/EU);

3.2.5 Sigurimi i së drejtës së viktimës për kthimin e pasurisë së viktimës dhe kompensimi i viktimës gjatë procesit penal nga autori (neni 16 i direktivës 2012/29/EU);

3.2.6 Sigurimi i së drejtës së viktimës rezident në një shtet tjetër (neni 17 i direktivës 2012/29/EU).

Treguesit kryesorë:

- Numri i viktimave të krimit që përfitojnë ndihmë juridike falas nga të gjithë ofruesit e saj, publikë dhe jopublikë dhe në gjithë format e ofrimit;
- Numri i viktimave të krimit të cilët janë kompensuar gjatë procesit penal nga autori i krimit.

Objektivi specifik 3.3: Garantimi i mbrojtjes së viktimave dhe njohja e viktimave me nevoja të veçanta

Ky objektivi specifik synon garantimin e mbrojtjes të të drejtave të viktimave dhe të anëtarëve të familjes¹²⁶, si dhe njohjen e viktimave me nevoja të veçanta. Bazuar në raportet vjetore të AMA-s, tregojnë se ankesat për shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe të dhënat e personave zënë një përqindje të konsiderueshme në totalin e ankesave të adresuara në Këshillin e Ankesave.¹²⁷ Në kuadër të këtij objektiv, duhet monitoruar kuadri ligjor i zbatuar nga prokurorët dhe gjykatat, të garantohet mbrojtja e së drejtës së privatësisë gjatë procedimit penal, të merren masa për parandalimin e publikimit të informacionit që identifikon një fëmijë viktimë dhe të nxisë median për masat vetërregulatore në kuadër të respektimit të lirisë së fjalës, informimit, lirisë dhe pluralizmit të medias. Kjo Strategji synon të adresojë përmirësimin e kapaciteteve të

¹²⁶ viktimizimi i dytë dhe i përsëritur, kanosja dhe hakmarja, duke përfshirë kundër rrezikut të lëndimit emocional ose psikologjik dhe për mbrojtjen e dinjitetit të viktimave

¹²⁷ Shih: <http://ama.gov.al/raport-vjetor-2/>



profesionistëve që punojnë me dhe për viktimat me qëllim që të parandalojë publikimin e të dhënave personale të viktimave dhe anëtarëve të familjes së saj dhe të promovojë Kodin e Transmetimit, të rishikuar. Gjatë regjistrimit audio dhe video të seancave me pjesëmarrjen e viktimave, duhet të zbatohen rregullat procedurale lidhur me publikimin e vendimeve.

Strategjia adreson garantimin e një vlerësimi individual dhe në kohë, dhe identifikimin e nevojave për mbrojtje specifike të viktimës, duke marrë parasysh karakteristikat personale, llojin ose natyrën e krimit dhe rrethanat e krimit. Është bërë progres, për sa u takon modeleve pozitive lidhur me vlerësimin e riskut të viktimave të dhunës në familje¹²⁸. Megjithatë, Avokati i Popullit rekomandon përmirësime për vlerësimin e riskut të viktimave të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore¹²⁹. Sidoqoftë, ky objektivi synon vlerësim individual për ato kategori ku mungojnë, rishikimin e procedurave ekzistuese të vlerësimit të nevojave të viktimave në të gjithë territorin e vendit dhe zbatimin e tyre.

Gjithashtu, një vëmendje të veçantë i është kushtuar mbrojtjes së viktimave me nevoja të veçanta, gjatë procedurës penale. Në këtë kuadër, intervistat me viktimën duhet të kryhen në ambiente të përshtatura, me profesionistë të trajnuar dhe nga i njëjti person. Intervistat e viktimave të dhunës seksuale, të dhunës me bazë gjinore ose të dhunës në marrëdhëniet e ngushta, nëse nuk mund të kryhen nga prokurori ose gjykatësi, kryhen nga një person i të njëjtës gjini kur viktimë e kërkon.

Gjatë procedurave gjyqësore/dhënies së dëshmisë, dëgjimit të viktimës në sallën e gjyqit me anë të përdorimit të teknologjisë së komunikimit, duhet të merren masa mbrojtëse për shmangien e kontaktit vizual midis viktimave dhe autorëve të veprave. Shmangia e kontaktit duhet të aplikohet edhe në rastin kur viktimë merret në pyetje për jetën private e cila nuk lidhet me veprën penale. Në praktikë, rezulton se jo gjithmonë përdorimi i teknologjisë është efikas dhe pyetja nga i njëjti person është një sfidë tjetër e cila duhet adresuar për t'u zbatuar në këtë Strategji. Gjatë viteve të ardhshme, duhet të ketë sa më shumë profesionistë

të drejtësisë, të trajnuar për përdorimin e teknologjisë dhe të gjitha prokuroritë e gjykatat duhet të pajisen me teknologjinë për pyetjen e viktimave e dëshmitarëve në nevojë mbrojtje specifike dhe të fëmijëve në kontakt me ligjin. Përmeshja e këtij objekti, synon vlerësim të programeve të formimit fillestar/vazhdues lidhur me modulet e trajtimit të viktimave, teknikave të komunikimit, intervistimit nga të gjithë profesionistët dhe përditësimin të në mënyrë periodike dhe rritje të kapaciteteve të të gjithë profesionistëve që punojnë me dhe për viktimat e krimit.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030, 100% e viktimave të krimit me nevoja të veçanta u është garantuar e drejta e mbrojtjes dhe njohja e tyre.

Lidhja e objektiut specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektiivi specifik 3.1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” me nenin 2 të MSA-së “*Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut*”, me nenin 78 të MSA-së “*Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Masat:

3.3.1 Sigurimi i së drejtës së viktimës për mbrojtje dhe njohja e viktimave me nevoja specifike mbrojtjeje gjatë procedimeve penale (nenet 18,19, 20, 21 të direktivës 2012/29/EU);

3.3.2 Sigurimi i së drejtës së viktimës për vlerësim individual të viktimës për të identifikuar nevojat specifike të mbrojtjes në përputhje me kërkesat e nenit 22 të direktivës 2012/29/EU;

3.3.3 Sigurimi i së drejtës për mbrojtje të viktimave me nevojave të veçanta gjatë procedimeve penale (neni 23 i direktivës 2012/29/EU).

Treguesit kryesorë:

- Numri i profesionistëve që punojnë me dhe për viktimat e krimit të trajnuar në lidhje me të drejtat e viktimës, trajtimin e rreziqeve të viktimave dhe

¹²⁸ Shih: <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2019/06/03/vleresimi-i-riskut-per-rastin-e-dhunes-ne-familje-te-raportuar-prane-komisiariatit-te-policise-nr-2-tirane/>
Faqe | 22254

¹²⁹ Raport i Avokatit të Popullit mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020-shtator 2021, vep. e cituar, f. 21.



zbatimin e mbrojtjes së viktimave me nevojë për mbrojtje specifike;

- Numri i viktimave me nevoja të veçanta për të cilët është zbatuar masa specifike e mbrojtjes.

Qëllimi politik 4

Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar

Ky qëllim politik synon forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të siguruar aksesin e viktimave në drejtësi. Në nivel kombëtar është thelbësore të bashkohen të gjitha strukturat që janë në kontakt me viktimat, përfshirë dhe shoqërinë civile. Ato përfshijnë policinë, autoritetet gjyqësore, stafin e gjykatës, shërbimet e mbështetjes së viktimave, autoritetet e kompensimit. Për disa viktima, është gjithashtu e rëndësishme përfshirja e personelit mjekësor, personelit arsimor, personelit të shërbimeve sociale dhe aktorëve të tjerë në nivel vendor.

Lidhur me forcimin e dimensionit ndërkombëtar të të drejtave të viktimave, ky qëllim synon të forcojë disa mekanizma të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sigurimit të aksesit optimal në drejtësi të viktimave, në kuadër të rritjes së mobilitetit dhe në kontekstin e negociatave të anëtarësimit dhe të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucionet e tjera, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e dy objektivave specifike:

Objektivi specifik 4.1: Konsolidimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve në nivel lokal dhe qendror;

Objektivi specifik 4.2: Forcimi i dimensionit ndërkombëtar të të drejtave të viktimave;

Lidhja midis qëllimit politik 4 dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 4 lidhet me objektivin nr. 16 (OZHQ), i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ngritjen e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse, në të gjitha nivelet. Në veçanti lidhet me nënobjektivin 16.3 “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të

gjithë”, nënobjektivi 16.6 “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”. Gjithashtu, qëllimi politik 4 lidhet edhe me objektivin nr. 10 (OZHQ) “Ulja e pabarazive brenda dhe ndërmjet shteteve”.

Objektivi specifik 4.1: Konsolidimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve në nivel lokal dhe qendror

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi në një kohë sa më të shpejtë, për të menaxhuar rastin konkret, vijon të jetë një sfidë. Shërbimet e integruara për viktimat e krimit ofrohen nga institucione të ndryshme, publike dhe jopublike, përfshirë organizatat e shoqërisë civile. Raportet e monitorimit të strategjive që adresojnë të drejtat e viktimave dhe raportet e partnerëve vendës dhe ndërkombëtarë, që mbështesin dhe ofrojnë shërbime për viktimat, vënë në dukje nevojën e forcimit të bashkëpunimit mes institucioneve të ndryshme dhe mekanizmave në nivel qendror dhe vendor. Bashkërendimi i punës mes institucioneve në referimin e rasteve konkrete, të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të viktimave të abuzimit seksual, viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit është i nevojshëm të vijojë dhe adresohet me disa masa në Planin e Veprimit.

Në Shqipëri ka mekanizma kombëtarë dhe vendorë për kategori të ndryshme të viktimave. Në nivel kombëtar nuk ka një koordinim të mekanizmave të ndryshëm kombëtarë që adresojnë të drejtat e kategorive të ndryshme të viktimave. Në nivel vendor, operojnë mekanizma të ndryshëm vendorë ndonëse në përbërjen e tyre përfshihen institucione dhe/ose përfaqësues të njëjtë.

Koordinimi mes gjithë mekanizmave në nivel qendror dhe vendor dhe mes tyre dhe agjencive të ndryshme është i nevojshëm, gjë që është adresuar, gjithashtu, me masa konkrete në planin e veprimit.

Gjithashtu, dy aspekte të tjera janë trajtuar në SNMVK 2024–2030: së pari, identifikimi i gjithë partnerëve të sektorit jopublik që mund të kontribuojnë në parandalimin e viktimizimit (sektori i hotelieri-turizmit, agjencitë e udhëtimit, agjencitë e punësimit) dhe OJF-ve që ofrojnë shërbime për viktimat, së dyti, përfshirja e shërbimeve konsullore, ambasadat dhe partnerëve ndërkombëtarë që punojnë në nivel ndërkufitar, rajonal, me shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.

Përfshirja dhe dëgjimi i mendimit të viktimave në lidhje me nevojat dhe shërbimet mbështetëse për to



janë vlerësuar të nevojshme. Në këtë kuptim strategjia parashikon masa që promovojnë modelet e angazhimit të viktimave, si për shembull viktimat e trafikimit dhe kategori të tjera të viktimave.

Gjithashtu, është parashikuar që, strukturat tashmë të konsoliduara në njësitë e vetëvrasjes vendore, si: NJMF-ja, GTN-ja, ETN-ja, të bashkëpunojnë dhe të kenë takime të përbashkëta, qoftë për trajtimin e rasteve të cilat janë objekt i punës së tyre, qoftë për të trajtuar rastet me grupet e tjera me nevoja specifike (si të moshuarit, personat që i përkasin komunitetit LGBTI+ etj.), kur ato janë viktimat të krimit. Këto masa, janë parashikuar si një projekt pilot, në Bashkinë e Tiranë dhe duke parë ecurinë e zbatimit të Strategjisë, do të shtrihet edhe në njësi të tjera vendore.

Rezultati i pritshëm:

- Struktura e koordinatorit kombëtar për mbrojtjen e viktimave të krimit, është ngritur dhe do jetë funksionale deri në fund të vitit 2030.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.1 lidhet me dy kapituj kryesorë të PKIE 2023–2025, konkretisht me kriterin politik “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, “Të drejtat e njeriut” dhe me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë respektin për të drejtat themelore dhe të drejtat e qytetarëve të BE-së, siç garantohej nga *acquis* dhe nga Karta e të Drejtave Themelore. Përafrimi i parimeve dhe *acquis* të BE-së për kapitullin 23 përbëjnë një detyrim që rrjedh nga neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.

Masat:

4.1.1 Harmonizimi dhe krijimi i një modeli pilot të bashkëpunimit të të gjitha grupeve dhe mekanizmave të referimit të rasteve të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, mekanizmit të referimit të grave dhe fëmijëve viktimat të dhunës në familje, fëmijëve viktimat të krimit etj.;

4.1.2 Inkurajimi i shoqërisë civile dhe i të gjithë partnerëve të sektorit jopublik të kontribuojnë në parandalimin e viktimizimit dhe për të reduktuar rrezikun e viktimizimit dytësor dhe të përsëritur;

4.1.3 Konsolidimi i praktikave të mira të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, si: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizatave të të drejtave të njeriut dhe mekanizmave ndërkombëtarë monitorues të

konventave që adresojnë të drejtat e viktimave me nevoja specifike për mbrojtje dhe rritja e nivelit të zbatimit të tyre;

4.1.4 Rritja e rolit promovues dhe monitorues të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të grave, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, nëpërmjet funksionimit të mekanizmit të Observatorit për Femicidet;

4.1.5 Ngritja dhe funksionimi i një strukture për koordinimin në nivel kombëtar, për mbrojtjen e viktimave të krimit;

Treguesit kryesorë:

- Struktura për koordinimin në nivel kombëtar për mbrojtjen e viktimave të krimit është ngritur dhe është funksionale.

Objektivi specifik 4.2: Forcimi i dimensionit ndërkombëtar të të drejtave të viktimave

Përafrimi i legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së viktimave me standardet e direktivës 2011/99/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 dhjetor 2011, mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes, në çështjet penale, është një objektivi tjetër më rëndësi në kuadër të hartimit të SNMVK 2024–2030. Transpozimi i kësaj direktive në legjislacionin shqiptar kërkon një vlerësim të disa ligjeve që rregullojnë aspekte që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale.

Direktiva përcakton rregullat që lejojnë një autoritet gjyqësor ose të barasvlershëm me të në një shtet i cili ka miratuar një masë mbrojtjeje për mbrojtjen e një personi nga aktet kriminale të një personi tjetër, të cilat mund të rrezikojnë jetën, integritetin fizik ose psikologjik, dinjitetin, lirinë personale ose integritetin seksual të tij, të lëshojë një Urdhër Evropian Mbrojtjeje dhe autoriteti kompetent në një shtet tjetër anëtar të vazhdojë mbrojtjen e personit në territorin e tij.

KPP-ja, në kapitullin X të tij “Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja” nuk përmend Urdhrin Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale, konceptet bazë të direktivës, masat e mbrojtjes, kërkesën, transferimin dhe komunikimet mes autoriteteve, kohëzgjatjen e urdhrin evropian, autoritetit kompetent që do të mbajë të gjitha komunikimet zyrtare, kushtet e njohjes dhe të mosnjohjes së tij etj. Ligi “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar, rregullon letërporositë dhe kërkesat në fushën penale dhe procedurat e njohjes së vendimeve të huaja, por nuk përmend Urdhrin



Evropian të Mbrojtjes. Urdhri Evropian i Mbrojtjes duhet të rregullohet në mënyrë të detajuar sikurse është rregulluar ekstradimi.

Në këtë objektiv janë adresuar disa masa, me qëllim transpozimin në legjislacionin shqiptar pjesë të kërkesave të direktivës 2011/99/BE, të cilat nuk janë të transpozuar. Ministria e Drejtësisë, si institucioni që ndjek bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale dhe civile, realizon marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, si dhe me organizma ndërkombëtare dhe kryen funksione të tjera në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, është parashikuar si institucioni përgjegjës për realizimin e këtyre masave.

Rezultati i pritshëm:

- 100% e viktimave janë të informuar në lidhje me të drejtat dhe procedurat për përdorimin e Urdhrit Evropian të Mbrojtjes në çështjet penale, deri në fund të vitit 2030.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.2 lidhet me dy kapituj kryesorë të PKIE 2023–2025, konkretisht me kriterin politik “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, “Të drejtat e njeriut” dhe me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë respektin për të drejtat themelore dhe të drejtat e qytetarëve të BE-së, siç garantohet nga *acquis* dhe nga Karta e të Drejtave Themelore. Përafrimi i parimeve dhe *acquis* të BE-së për kapitullin 23, përbëjnë një detyrim që rrjedh nga neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.

Masat:

4.2.1 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/99 EU (Njohja e Urdhrit Evropian të Mbrojtjes);

4.2.2 Ndërgjegjësimi dhe informimi i profesionistëve dhe publikut mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes;

4.2.3 Bashkëpunimi me vendet evropiane për të siguruar që shtetasit shqiptarë viktimë të krimit të marrin mbështetjen dhe mbrojtjen e nevojshme në vendet partnere;

Treguesit kryesorë:

- Numri i fushatave, dedikuar viktimave të krimit, të organizuara në nivel kombëtar për ndërgjegjësimin dhe informimin e tyre mbi Urdhrin Evropian të Mbrojtjes.

PJESA III

PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, KOORDINIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

1. Përgjegjësia e institucioneve

Për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsëktoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030 “SNMVK 2024–20230”, do të angazhohen një tërësi institucionesh, duke filluar nga ministritë e linjës, institucionet e pavarura, akademja, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Strategjia përcakton Ministrinë e Drejtësisë, si institucionin përgjegjës kryesor të raportimit për progresin e saj edhe pse pjesa më e madhe e aktiviteteve do të kërkojë bashkëpunim ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile, kryesisht në mbrojtje të viktimave të krimit. Institucionet përgjegjëse për çdo masë sipas objektivave specifikë dhe fushave të politikës janë të përcaktuara në matricën e logjikës së ndërhyrjes në aneksin 1 të këtij dokumenti.

Institucionet të cilat janë angazhuar në hartimin dhe konsultimin e Strategjisë dhe do të jenë përgjegjëse për zbatimin e saj, janë:

Institucionet e pavarura:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Struktura e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit;
- Avokati i Popullit;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Radiotelevizioni shqiptar;
- Autoriteti i Medies Audiovizive;
- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve;
- Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë;
- Urdhri i Psikologut;
- Urdhri i Punonjësit Social;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë;
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë.

Ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë:

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;



- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- Departamenti i Administratës Publike;
- Akademia e Sigurisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- Instituti i Mjekësisë Ligjore;
- Drejtoria e Shërbimit të Provës;
- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

2. Llogaridhënia dhe koordinimi

Kuadri monitorues do të shërbejë për orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e burimeve të vendit.

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, mekanizmi i menaxhimit ndërsektorial të integruar do të veprojë përmes grupeve të menaxhimit të integruar të politikave dhe të ekipeve tematike si më poshtë vijon:

a) Grupi i menaxhimit të integruar të politikave për bashkëveprimin në nivel drejtues për qasjen e integruar ndërsektoriale në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit. Bazuar në po këtë urdhër, do të ngrihet dhe funksionojë Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) “Demokracia, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë”;

b) Ekipet tematike për bashkëveprimin në nivel sektorial dhe me partnerët për zhvillim për reformat

dhe bashkërendimin ndërinstitucional brenda sektorëve specifikë të fushë së mbrojtjes së viktimave të krimit.

Në mbledhjet e GMIP-së dhe të ekipit tematik në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit, në varësi të tematikës së diskutimit, ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga partnerët e zhvillimit, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Shqipëri. Në këto mbledhje mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e pavarura, akademia, shoqëria civile dhe organizatat e biznesit në vend.

GMIP-i do të sigurojë udhëheqjen për ndjekjen e zbatimit të bashkërenduar të politikave prioritare dhe reformave, përmes raportimit dhe monitorimit për masat e lidhura me synimet dhe objektivat prioritare (prioritetet) në lidhje me Strategjinë për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, reformat dhe sektorët e rëndësishëm të veçantë, si dhe detyrimet që burojnë nga angazhimet në kuadër të integritetit evropian, përmes qasjes së jetësimit të prioritetëve dhe masave organizative e strukturave të ngarkuara për këtë qëllim, raporteve periodike të progresit, raporteve të monitorimit etj.:

GMIP dhe Ekipi Tematik do të sigurojnë shqyrtimin, diskutimin, konsultimin dhe miratimin paraprak të “SNMVK 2024–2030”.

Mekanizmi i menaxhimit sektorial/ndërsektorial të integruar për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale dhe ndërsektoriale do të përdorë instrumentet e menaxhimit të politikave dhe financave publike, si dhe të bashkërendimit të ndihmës së huaj. Aktiviteti i GMIP-së do të jetë pjesë përbërëse e sistemit IPSIS.

Ekipi tematik do të diskutojë çështje të ecurisë së zbatimit të objektivave dhe masave të “SNMVK 2024–2030” dhe ku do të realizohet bashkëpunimi ndërinstitucional me grupet e interesit. Ky grup do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe do të ketë në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet e tjera ligjzbatuese, që janë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e treguesve në kompetencën e tyre, duke krahasuar objektivat e treguesve të performancës së planifikuar me ata aktualë.

Ekipi Tematik për zbatimin dhe monitorimin e strategjisë “SNMVK 2024–2030” mbledh dhe analizon raportet periodike të masave për zbatimin e Planit të Veprimit të këtij dokumenti strategjik, vlerësimin e ecurisë së treguesve të performancës, propozon rekomandime, bazuar në gjetjet e raporteve periodike etj.



Objekti i mbledhjeve do të jetë kryesisht:

a) vlerësim i progresit të arritur dhe niveli i zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për përmbushjen e objektivave strategjike të parashikuara;

b) identifikimin e problematikave të hasura, me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohën e duhur për të siguruar realizimin, pajtueshmërinë dhe koordinimet e duhura në lidhje me Planin e Veprimit/aktivitetet/rreziqet/pasaporta e treguesve etj. deri në fund të vitit kalendarik;

c) miratimin në parim të raporteve të monitorimit të përgatitura nga Sekretariati Teknik.

Ekipi Tematik do të mbështetet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik (ST), i cili do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

Sekretariati Teknik krijohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, duke siguruar përfshirjen e strukturave të duhura. Struktura që është përgjegjëse për monitorimin e strategjive në Ministrinë e Drejtësisë do të ushtrojë funksionin e ST-së, të rrjetit ndërinstitucional në nivel qendror për çështjet e mbrojtjes së viktimave të krimit.

Sekretariati Teknik do të ketë këto detyra:

a) mbledh, analizon dhe vlerëson kontributin për çdo aktivitet dhe çdo tregues nga institucionet raportuese;

b) komunikon tek institucionet vendimet e Ekipit Tematik së bashku me udhëzimet e lëna nga ky i fundit;

c) harton raportin e zbatimit të integruar çdo gjashtë muaj dhe në bazë vjetore;

d) publikon vendimet e marra dhe dokumentet e miratuara;

e) përgatit agjendat dhe dokumentacionin e duhur për mbledhjet që do të zhvillohen sipas rregullores së brendshme për monitorimin e Strategjisë dhe Grupin e Punës;

f) harton minutat e mbledhjeve dhe e shpërndan te të gjithë anëtarët e Ekipit tematik.

Në aspektin cilësor të monitorimit, ST-ja mund të sugjerojë të përdorë metodat e mëposhtme për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë:

a) përditësimin e përmbushjes apo jo të masave, sipas Planit të Veprimit dhe në bazë të vetëvlerësimit të institucioneve;

b) vlerësime tematike (sipas objektivave specifike të “SNMVK 2024–2030”), sipas udhëzimeve të mekanizmit vlerësues, lidhur me efektivitetin e veprimeve të ndërmarra;

c) komunikimin me palë të treta dhe shoqërinë civile për vlerësimin e masave të zbatuara;

Çdo institucion i përfshirë në Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, raporton çdo 6 muaj dhe në bazë vjetore për nivelin e zbatimit të çdo objekti strategjik dhe aktiviteti, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të Strategjisë në tërësi. Një raport përmbledhës i rezultateve të arritura nga zbatimi i “SNMVK 2024–2030”, analiza e performancës në 7 vjet e treguesve, mësimet e nxjerra, histori suksesi etj., do të finalizohet pas përfundimit të afatit kohor të këtij Plani, në muajin mars të vitit 2031.

Ministria e Drejtësisë ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit vjetor. Organizatat e shoqërisë civile luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve, në zbatimin dhe në mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave, ofrimit të shërbimeve dhe zbatimit të legjislacionit e politikave në tërësi, për avancimin drejt mbrojtjes së viktimave të krimit.

Grupi koordinues i partnerëve ndërkombëtarë që do të mbështesin zbatimin e “SNMVK 2024–2030” do të jetë një mekanizëm i fuqishëm, i cili do të kontribuojë në shmangien e mbivendosjeve dhe mospërputhjeve gjatë zbatimit të masave të “SNMVK 2024–2030”. Ky grup do të mbledhet në mënyrë të rregullt, ku partnerët do të diskutojnë masat e implementuara, rezultatet e arritura dhe projektet e ardhshme në mbështetje të “SNMVK 2024–2030”.

3. Monitorimi dhe raportimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky dokument, konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tij, me qëllim përmbushjen e objektivave në mënyrë sa më efektive.

Më konkretisht do të ndërmerren këto masa:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;

- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet, si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progresraporteve të Bashkimit Evropian dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare;



- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;

- do të kryhet monitorim dhe do të hartohen raporte vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikatat e vendit, të lidhura me avancimin drejt rezultateve për mbrojtjen e viktimave të krimit.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportim dhe monitorimin në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020 *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), i ndryshuar”*, për përgatitjen e raporteve të monitorimit do të ndiqen fazat e mëposhtme.

Faza 1 ➡ Marrja e të gjitha kontributeve nga institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit.

Faza 2 ➡ Dërgimi i paketës së plotë për vlerësim pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), në Kryeministri në përputhje me standardet e sistemit. Paketa e plotë do të duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:

2.1 Raport-Progresin e konsoliduar në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e agjendës së mirëqeverisjes;

2.2 Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e agjendës së mirëqeverisjes;

2.3 Pasaportën e treguesve në përputhje me standardet e sistemit IPSIS për periudhën referuese;

2.4 Bazën e të dhënave për vitin referues në zbatim të raportimit të treguesve të strategjisë.

Faza 3 ➡ Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), në Kryeministri.

Faza 4 ➡ Organizimi i mbledhjes së Ekipit Tematik për konsultimin e paketës së konsoliduar dhe marrjen e komenteve nga aktorët.

Faza 5 ➡ Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së Raportit të Monitorimit.

Faza 6 ➡ Publikimi i raporteve të monitorimit.

Ministria e Drejtësisë do të jetë institucioni udhëheqës, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor, përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatit Teknik.

Përfaqësuesit në ministrinë e linjës do të punojnë me përfaqësuesit në nivel rajonal dhe vendor për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha institucionet shtetërore përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të “SNMVK 2024–2030”, duke pasur në fokus mbrojtjen e viktimave të krimit.

4. Vlerësimi

Për shkak të kohëzgjatjes shtatëvjeçare të zbatimit të strategjisë kombëtare dhe përputhjes së saj me OZHQ-të, është menduar që përveç monitorimeve 6-mujore dhe vjetore të zbatimit të kësaj Strategjie, të ketë edhe një proces vlerësimi në vitin e katërt të zbatimit të saj me fokus matjen e efikasitetit dhe efektshmërisë së masave. Bazuar mbi këtë vlerësim mund të ndryshohen/hiqen (nëse janë realizuar plotësisht) dhe shtohen, jo vetëm veprime e masa, por edhe objektiva specifike nën qëllimet strategjike bazë të dokumentit.

PJESA IV ANALIZA E BUXHETIT

Në këtë kapitull të strategjisë paraqitet shpërndarja e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030. Kostimi i Strategjisë u realizua mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, ndërsa vlerësimi i kostove indikative është mbështetur gjithashtu në objektivat dhe treguesit e



përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në masat, aktivitetet dhe produktet e identifikuar për secilin aktivitet. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS-ja, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Procesi i kostimit u mbështetet gjithashtu në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2023–2025 (faza III), në konsultimet me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i strategjive të ngjashme. Në disa raste janë marrë në konsideratë dhe kostot e produkteve të PBA-së ose projekte të ngjashme.

Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i mbështetur në një detajim të hollësishëm të shpenzimeve për çdo aktivitet.

Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet dhe ato janë

klasifikuar në kategori shpenzuese të paracaktuara, sipas formatit IPSIS mbi metodologjinë e kostimit. Për kategori të caktuara shpenzimesh si: pagat, shpenzimet e trajnimit, seminarët, shpenzimet e udhëtimeve, shpenzimet e ekspertëve dhe disa kategori pajisjesh janë përdorur kostot standarde të paracaktuara në metodologjinë e kostimit. Përlllogaritja e kostove është bërë sipas viteve financiare.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030 është mbi 2 miliardë lekë, ose rreth 18.4 milionë euro. Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 110 lekë për 1 euro.

Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 7 viteve të zbatimit të Planit të veprimit 2024–2030.

Nevojat (në Lek)					
Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2024-2030	Kostot e Planifikuara PBA 2024-2026 Buxheti & Donator	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2027-2030	Hendeku Financiar 2024-2030
Qëllimi i Politikës 1: Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.	Korente	481,111,850	159,889,443	219,243,295	101,979,112
	Kapitale	184,000,000	36,800,000	147,200,000	
Qëllimi i Politikës 2: Një kuadër ligjor i përfshirë me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit	Korente	749,139,713	199,628,431	394,773,613	154,737,669
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 3: Garantimi i të drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë	Korente	489,928,107	177,481,880	232,194,694	80,251,553
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 4: Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar	Korente	122,480,114	36,241,414	74,658,700	11,580,000
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Lekë]		2,026,659,784	610,041,148	1,068,070,302	348,548,334
TOTALI [Euro]					
1 euro 110 Lekë		18,424,180	5,545,829	9,709,730	3,168,621


Tabela: Kostot indikative të SNMVK 2024–2030

Për periudhën afatmesme 2024–2026, kostoja është vlerësuar rreth 610,04 milionë lekë, të cilat janë planifikuara në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2023–2025, të institucioneve përgjegjëse për realizimin e masave.


Për periudhën 2027–2030, kostoja indikative për zbatimin e Strategjisë është mbi 1 miliardë lekë. Për këtë periudhë është supozuar që për aktivitete të caktuara në Planin e Veprimit do të jenë në dispozicion fondet nga Buxheti i Shtetit për shpenzime korente dhe investime.

Hendeku financiar për të gjithë periudhën 2024–2030 është 348.5 milionë lekë ose 17.2% e kostove indikative. Për periudhën 2024–2026, buxheti i shtetit pritet të financojë 29.5% të kostove indikative totale të zbatimit të planit, ndërsa 52.7% janë shpenzimet e planifikuara për periudhën 2027–2030.


NDARJA E SHPENZIMEVE



Shpenzimet kapitale përbëjnë 9.0% të kostove indikative, ndërsa kostot korrente 91.0%.

NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË
Planit të Veprimit

Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë. Qëllimi i politikës II, pritët të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e PV-së, përkatësisht 37.0 %. Qëllimi i politikës I arrin në vlerën 32.8%, qëllimi i politikës III 24.2%, ndërsa qëllimi IV 6.0% të kostos së përgjithshme të planit.



Plani i veprimit do të rishikohet çdo 2–3 vjet për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform nevojave dhe shpenzimeve buxhetore afatmesme. Për masat e planit që janë të pambuluara financiarisht, MD-ja dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.



ANEKSI 1
MATRICA E MASAVE DHE E AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT
2024–2030

LOGJIKA E NDËRHYRJES, INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE, AFATET KOHORE

Qëllimi politik 1:	Fuqizimi i parandalimit dhe i raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.			
Objektivi specifik 1.1:	Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe viktimave të krimit për raportimin e krimit, të drejtat dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtëse të tyre.			
Rezultatet e pritshme:	- Deri në fund të vitit 2030, 100% i publikut shqiptar është informuar dhe ndërgjegjësuar mbi të drejtat që ka çdo kategori viktime e krimit e përfshirë në këtë strategji.			
MASA	AKTIVITETE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1.1 Informimi i viktimave të krimit për të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve.	1.1.1.1 Shtrirja e aksesit të sistemeve/platformave <i>online</i> të informimit dhe raportimit të krimit, duke përfshirë dhe linjat telefonike të komunikimit ¹³⁰ .	MSHMS, MB, MD	OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024–2030
	1.1.1.2 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për informimin mbi shërbimet dhe linjat telefonike të këshillimit për viktimat e krimit ¹³¹ .	MSHMS	OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024–2030
	1.1.1.3 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve audio/video për mënyrën e raportimit të krimit dhe të drejtat e viktimave të krimit në kontakt me sistemin e drejtësisë penale për çdo viktimgë (titime, audio, alfabeti braj).	DPPSH, PP, DNJF, KLGJ, MSHMS	OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024–2030
	1.1.1.4 Veprimtari informuese dhe ndërgjegjëse me viktimat e krimit.	Avokati i Popullit, KMD, RTSH		2024–2030
	1.1.1.5 Përditësimi i faqeve zyrtare të prokurorive dhe gjykatave me informacione për aksesin e viktimave të shërbimet që këto institucione ofrojnë.	PP, gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm	Prokuroritë e rretheve, gjykata e juridiksionit të përgjithshëm.	2024–2030
1.1.2 Përdorimi nga publiku i portalit <i>online</i> me informacion për të drejtat e viktimës dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtjen e tyre.	1.1.2.1 Fushatë informuese për publikun e gjerë dhe për viktimat e krimit në veçanti mbi portalin <i>online</i> për të drejtat e viktimës dhe shërbimet mbështetëse dhe mbrojtjen e tyre.	MD	JustAL	2024
	1.1.2.2 Publikimi i linkut të portalit në faqet e bashkive dhe të institucioneve që punojnë me viktimat e krimit.	MD	NJVV-ja dhe institucionet që punojnë me viktimat e krimit	6M II 2024
1.1.3 Informimi i publikut mbi të drejtat, mbrojtjen dhe aksesimin e shërbimeve për viktimat e krimit.	1.1.3.1 Zhvillimi i programeve informuese dhe edukuese në media audio dhe audiovizive për të drejtat e viktimave dhe aksesimin e shërbimeve në institucione.	RTSH	OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024–2030
	1.1.3.2 Përdorimi i rrjeteve sociale për informimin	Çdo institucion që merret me		

¹³⁰ MSHMS-ja ka financuar tashmë ngritjen e dy linjave kombëtare “helpline”, të mbështetura me fond social, të ngritura në qarkun e Tiranës, por që referojnë të gjitha rastet e raportuara nga individë, pavarësisht vendbanimit.

¹³¹ Fëmijët, gratë, viktimat e dhunës në familje dhe dhunës seksuale, viktimat e krimeve të urrejtjes, personat e moshuar, viktimat e krimeve *online*, personat me aftësi të kufizuara lëvizje.



	e publikut mbi të drejtat e viktimave dhe aksesimin e shërbimeve në institucione.	mbrojtjen e viktimave të krimit	OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024–2030
	1.1.3.3 Fushata ndërgjegjësuese në komunitet dhe në shkolla në zona me risk më të lartë në nivel kombëtar për të rënë pre e krimit;	MAS, DNJF	NJVV, OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024–2030
	1.1.3.4 Takime me organizatat rinore, për të rinjtë që punojnë në fushën e mbrojtjes, mbështetjes dhe rehabilitimitin e viktimave të krimit.	MSHRF	AKR	2025-2029
	1.1.3.5 Mbështetja e aktiviteteve të organizatave rinore/për të rinjtë që punojnë në fushën e mbrojtjes, mbështetjes dhe rehabilitimit të viktimave të krimit.	MSHRF	AKR	2025–2029
1.1.4 Organizimi i javës së dedikuar të mbrojtjes së viktimave të krimit (14–22 shkurt, çdo vit, dizenjimi i fushatës, sloganit etj.).	1.1.4.1 Brandimi dhe strategjia e komunikimit të javës së dedikuar të mbrojtjes së viktimave të krimit.	MD	OSHC, partnerë ndërkombëtarë, biznese lokale	2024–2030
	1.1.4.2 Zhvillimi i ditëve të hapura dhe takimeve informuese për raportimin, të drejtat e viktimave në sistemin e drejtësisë penale, për viktimat me nevoja specifike, në kuadër të javës së dedikuar, si dhe pasqyrimi në medien lokale dhe kombëtare.	MD	RTSH, OSHC, partnerë ndërkombëtarë, biznese lokale	2024–2030
Objektivi specifik 1.2:	Ndërtimi/fuqizimi i mekanizmave të raportimit të krimit nga viktimat mes rritjes së besimit, sigurisë dhe ofrimit të shërbimeve nga profesionistë të trajnuar për të drejtat dhe nevojat e viktimave.			
Rezultatet e pritshme:	- Deri në fund të vitit 2030, çdo kategori viktime e krimit ka mundësi të raportojë krimin në institucionet përgjegjëse, si dhe të marrë shërbimet mbështetëse dhe mbrojtëse të tyre.			
MASA	AKTIVITETE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.2.1 Krijimi i mjediseve të sigurta dhe të aksesueshme për çdo viktimë të krimit në polici, prokurori dhe gjykatë.	1.2.1.1 Përcaktimi i standardeve për ambientet, e përshtatshme për viktimat në përputhje me përcaktimet me direktivat e BE-së.	DPPSH, gjykata dhe prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, SPAK	PP, KLGJ, Partnerë ndërkombëtarë	2024–2025
	1.2.1.2 Vlerësimi i nevojave për mjedise të posaçme për viktimat në godinat e prokurorive dhe gjykatave.	DPPSH, gjykata dhe prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, SPAK	PP, KLGJ, Partnerë ndërkombëtarë	2025
	1.2.1.3 Paraqitja e nevojave për burimet financiare dhe investimet në infrastrukturë.	DPPSH, gjykata dhe prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, SPAK	PP, KLGJ	2026
	1.2.1.4 Ristrukturimi i ambienteve për pritjen e viktimave të krimit, sipas standardeve të përcaktuara.	DPPSH, gjykata dhe prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, SPAK	PP, KLGJ	2026–2030
1.2.2 Komunikim efektiv me viktimat e krimit, bazuar në nevojat specifike të tyre.	1.2.2.1 Rishikimi i deklaratës së të drejtave të viktimës dhe hartimi i saj në një gjuhë miqësore bazuar në nevojat specifike të viktimave të krimit.	PP, DPPSH; SPAK	OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024
	1.2.2.2 Sigurimi 24/7 ditë të javës të paktën të një numri të caktuar të profesionistëve të trajnuar për viktimat e krimit në prokurori dhe polici.	DPPSH, PP	Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Komisaritet e policisë së shtetit	2024–2030
	1.2.2.3 Rritja në mënyrë progresive e numrit të			



	interpretëve të gjuhës së shenjave dhe sigurimi i një grupi interpretësh të mjaftueshëm dhe të disponueshëm për të garantuar respektimin e së drejtës për interpretim ¹³² .	MD	OSHC, partnerë ndërkombëtarë	2024–2030
	1.2.2.4 Krijimi i një grupi përkthyesish të trajnuar për teknikat e komunikimit me viktimat e krimit dhe sigurimi i shërbimeve të disponueshme për viktimat që nuk flasin ose nuk kuptojnë gjuhën shqipe ¹³³ .	MD	OSHC, Partnerë Ndërkombëtarë	2024
	1.2.2.5 Krijimi i një grupi psikologësh asistues të disponueshme, të trajnuar për viktimat e krimit në polici dhe gjykatë.	DPPSH, gjykata e juridiksionit të përgjithshëm, SPAK	UP	2025–2030
	1.2.2.6 Vlerësimi periodik i kënaqësisë së shërbimit të ofruar viktimave në lidhje me komunikimin dhe informimin efektiv të tyre që në kontaktin e parë.	OSHC	DPPSH, PP, gjykata e juridiksionit të përgjithshëm, SPAK, UP	2024–2030
1.2.3 Përmirësime ligjore të nevojshme për mirëfunksionimin e përfaqësuesve proceduralë për viktimat e krimit në procesin penal.	1.2.3.1 Hartimi i VKM-së/udhëzimit i përbashkët për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për viktimat e krimit në procesin penal.	PP, KLGJ, DPPSH	MD, MSHMS, UP, UPS, Organizatat ndërkombëtare,	2025
	1.2.3.2 Informimi i institucioneve përgjegjëse, në lidhje me detyrimet që kane në krijimin e listës së përfaqësuesve procedurale për viktimat e krimit në procesin penal.	PP, KLGJ, DPPSH	MD, UP, UPS NJVV, organizatat ndërkombëtare	2026–2030
	1.2.3.3 Ofrimi i shërbimit të përfaqësuesve proceduralë të gjitha viktimave të krimit.	PP, KLGJ, DPPSH	NJVV, organizata lokale, ndërkombëtare	2026–2030
Qëllimi politik 2:	Një kuadër ligjor i përafuar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit.			
Objektivi specifik 2.1:	Përafrimi i legjislacionit penal, procedural penal dhe ligjeve të tjera që adresojnë të drejtat e viktimave me <i>acquis</i> e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera¹³⁴.			
Rezultatet e pritshme:	- Qeveria shqiptare ka siguruar një kuadër ligjor që ofron mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit të përafuar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera deri në fund të vitit 2030.			
MASA	AKTIVITETE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.1.1 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2012/29/EU.	2.1.1.1 Vlerësimi i nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet e direktivës 2012/29/EU dhe amendamentit të propozuar më	MD		2024

¹³² Neni 58 i KPP-së, i ndryshuar “Të drejtat e viktimës së veprës penale. Viktima ka drejtë të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar”.

¹³³ Neni 58 i KPP-së, i ndryshuar, “Të drejtat e viktimës së veprës penale. Viktima ka drejtë të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar”.

¹³⁴ Kodi penal, Kodi i Procedurës Penale, ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifat gjyqësore, ligji për kompensimin e viktimave të krimit, ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, ligji antimafia, ligji për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.



	datë 12 korrik 2023 ¹³⁵ (TOC)			
	2.1.1.2 Hartimi i vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA)	MD	Institucionet kontribuese, OSHC, tryeza të konsultimit publik (kostoja administrative)	2026
	2.1.1.3 Hartimi i propozimeve për nisma ligjore për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2012/29/EU dhe miratimi i tyre;	MD		2026–2027
	2.1.1.4 Hartimi i komentareve për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar;	MD	SHM, IAL, ekspertë	2028
	2.1.1.5 Vlerësime periodike të shkallës së zbatimit të legjislacionit të miratuar. (Expost)	MD	Kuvendi i Shqipërisë, IAL, ekspertë	2030
2.1.2 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/36/EU.	2.1.2.1 Vlerësimi i nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet e direktivës 2011/36/EU (TOC)	MD		2024
	2.1.2.2 Hartimi i vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA)	MD	Institucionet kontribuese, OSHC, tryeza të konsultimit publik (kostoja administrative)	2026
	2.1.2.3 Hartimi i propozimeve për nisma ligjore për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/36/EU dhe miratimi i tyre;	MD		2028
	2.1.2.4 Hartimi i komentareve për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar;	MD	SHM, IAL	2028
	2.1.2.5 Vlerësime periodike të shkallës së zbatimit të legjislacionit të miratuar. (Expost)	MD	Kuvendi i Shqipërisë, IAL, ekspertë	2030
2.1.3 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/92/EU.	2.1.3.1 Vlerësimi i nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet e direktivës 2011/92/EU (TOC)	MD		2024
	2.1.3.2 Hartimi i vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA)	MD	Institucionet kontribuese, OSHC, tryeza të konsultimit publik (kostoja administrative)	2026
	2.1.3.3 Hartimi i propozimeve për nisma ligjore për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/92/EU dhe miratimi i tyre.	MD		2026–2027
	2.1.3.4 Hartimi i komentareve për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar.	MD	SHM, IAL	2028
	2.1.3.5 Vlerësime periodike të shkallës së zbatimit të legjislacionit të miratuar. (Expost)	MD	Kuvendi i Shqipërisë, IAL, ekspertë	2030
2.1.4 Përmirësime ligjore për të garantuar përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2017/541/EU.	2.1.4.1 Vlerësimi i nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet e direktivës 2017/541/EU (TOC)	MD		2024
	2.1.4.2 Hartimi i vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA)		Institucionet kontribuese, OSHC, tryeza të konsultimit publik (kostoja administrative)	

¹³⁵ Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL amending Directive 2012/29/EU establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA {SEC (2023) 270 final} - {SWD (2023) 246 final} - {SWD(2023) 247 final} Brussels, 12.7.2023 COM(2023) 424 final. Shih: https://commission.europa.eu/system/files/2023-07/COM_2023_424_1_EN_ACT_part1_v7.pdf



	2.1.4.3 Hartimi i propozimeve për nisma ligjore për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2017/541/EU dhe miratimi i tyre.	MD		2026
	2.1.4.4 Hartimi i komentareve për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar.	MD	SHM, IAL	2028
	2.1.4.5 Vlerësime periodike të shkallës së zbatimit të legjislacionit të miratuar. (Expost)	MD	Kuvendi i Shqipërisë, IAL, ekspertë	2030
Objektivi specifik 2.2:	Krijimi i një skeme kompensimi të drejtë dhe të përshtatshëm për viktimat e krimit.			
Rezultatet e pritshme:	- Skema kombëtare e kompensimit për viktimat e veprave penale të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë është aprovuar dhe është funksionale deri në fund të vitit 2030.			
MASA	AKTIVITETE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.2.1 Krijimi i një skeme të re kombëtare kompensimi të viktimave të veprave penale dhe garantimi i një kompensimi të drejtë e të përshtatshëm për viktimat, në përputhje me standardet më të mira evropiane sipas direktivës 2004/80/EC. ¹³⁶	2.2.1.1 Vlerësimi i nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet e direktivës 2004/80/EC (TOC)	MD		2024
	2.2.1.2 Hartimi i vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA)	MD	Institucionet kontribuese, OSHC, tryeza të konsultimit publik (kostoëja administrative)	2026
	2.2.1.3 Hartimi i propozimeve për nisma ligjore për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2004/80/EC dhe miratimi i tyre.	MD		2026–2027
	2.2.1.4 Hartimi i komentareve për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar.	MD	SHM, IAL	2028
	2.2.1.5 Vlerësime periodike të shkallës së zbatimit të legjislacionit të miratuar (Expost).	MD		2030
	2.2.1.6 Lehtësimi i viktimave nga përgjegjësia e pagesës së taksave për ekzekutimin e urdhrat të kompensimit përmes ndryshimeve ligjore dhe procedurave të thjeshtëzuara.	MD	Grup pune ndërsektorial, ekspertë lokalë	2024–2030
	2.2.1.7 Studimi periodik të praktikës gjyqësore, në lidhje me kompensimin e viktimave të krimit nga autori dhe shteti.	MD	OSHC, IAL, ekspertë, SHM	2026–2030
	2.2.1.8 Rritja e kapaciteteve të punonjësve të policisë, oficerëve të policisë gjyqësore, prokurorëve, ekspertëve për të siguruar mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar viktimat, përfshirë përfitim financiar nga shfrytëzimi i viktimës, si element i rëndësishëm për të mbështetur pretendimet e ardhshme për kompensim.	SHM, AS	Eksperte lokale dhe ndërkombëtarë, parterë ndërkombëtarë	2025–2030
2.2.2 Inkurajimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve që të përdorin të gjitha	2.2.2.1 Monitorimi, vlerësimi i procesit të	PP, KLGJ	Partnerë ndërkombëtarë, OSHC	2024–2030

¹³⁶ Sqarim. Të shtetasve të shteteve palë në këtë Konventë dhe të shtetasve të të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, që janë me banim të përhershëm në shtetin, në territorin e të cilit është kryer krimi.



mundësitë që ligji u ofron atyre të mbështesin kërkesat e viktimave për kompensim.	kompensimit të viktimave në praktikë dhe përgatitja e raporteve vlerësuese ¹³⁷ .			
	2.2.2.2 Ndarja e gjetjeve të studimit përmes tryezave me pjesëmarrje të gjyqtarëve, prokurorëve, grupeve të interesit, përfaqësues të KLP-së, PP-së, KLGJ-së, përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë.	PP, KLGJ	KLP, Kuvendi i Shqipërisë, prokurorë dhe gjyqtarë të juridiksionit të përgjithshëm	2024–2030
	2.2.2.3 Përdorimi i fondit të posaçëm dhe të përshtatshëm me nevojat për kompensimin e viktimave të trafikimit.	Agjencia e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara		2024–2030
2.2.3 Funksionimi i organeve/strukturave ndihmëse dhe përgjegjëse vendimmarrëse për aplikimet e mundshme për kompensim dhe ofrimin e shërbimeve të tjera mbështetëse.	2.2.3.1 Krijimi i strukturave përgjegjëse për kompensimin e viktimave nga shteti.	MD	MFE, DAP	2026
	2.2.3.2 Trajnimi i punonjësve të policisë, oficerëve të policisë gjyqësore, prokurorëve, ekspertëve për të siguruar mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar viktimja, përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës, si element i rëndësishëm për të mbështetur pretendimet e ardhshme për kompensim;	SHM, PP, AS	Partnerë vendës dhe ndërkombëtarë	2026–2030
	2.2.3.3 Ngritja e kapaciteteve të avokatëve për të mbështetur viktimat në kërkimin e kompensimit duke përdorur të gjitha mundësitë që ligji u ofron.	DHASH	OSHC, Partnerë vendës dhe ndërkombëtarë	2026–2030
2.2.4 Sigurimi i aksesit në informacion të viktimave të veprave penale lidhur me mundësitë për aplikim për kompensim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	2.2.4.1 Fushatë kombëtare informuese për ligjin e kompensimit të viktimave nga shteti;	MD	Struktura përgjegjëse për kompensimin, Partnerë vendës dhe ndërkombëtarë	2026–2030
	2.2.4.2 Hartimi i udhëzuesve praktikë me gjuhë të thjeshtë për aplikimin për kompensim.	MD	Struktura përgjegjëse për kompensimin, Partnerë vendës dhe ndërkombëtarë	2026–2030
2.2.5 Krijimi i aksesit të viktimave të veprave penale, shtetasve rezident në një shtet të huaj, në një kompensim të drejtë nga shteti ¹³⁸ .	2.2.5.1 Përcaktimi i strukturave përgjegjëse për kompensim të viktimave shtetas të huaj;	MD	Struktura përgjegjëse për kompensimin, MFE	2027
	2.2.5.2 Miratimi i praktikave procedurave administrative të kompensimit dhe të komunikimit mes institucioneve dhe shteteve homologe;	MD	Struktura përgjegjëse për kompensimin, MFE	2027
	2.2.5.3 Lehtësimi i procedurave të kompensimit të viktimave të krimeve në një shtet të huaj, mbrojtja e tyre nga dëmtimi me të njëjta të drejta si ajo e shtetasve rezident;	Strukturat homologe përkatëse që merren me kompensimin e viktimave		2028–2030
	2.2.5.4 Bashkëpunim efikas me autoritetet për lehtësimin e dhënies së informacionit viktimave të krimit lidhur me aplikimin për kompensim.	Të gjitha institucionet që punojnë me dhe për viktimat		2028–2030

¹³⁷ Studime vjetore, në lidhje me tendencën e % së vendimeve për kompensim të viktimave karshi totalit të kërkesave të viktimave, me qëllim përdorimin maksimalisht të fondit të posaçëm për kompensimin e viktimave të trafikimit.

¹³⁸ Duke përfshirë krimet e dhunshme, të qëllimshme, përfshirë viktimat e terrorizmit.



Objektivi specifik 2.3:	Politika efektive për mbrojtjen e viktimave të krimit, bazuar në statistika të hartuara sipas standardeve ndërkombëtare.			
Rezultatet e pritshme:	- Statistika të përmirësuara për mbrojtjen e viktimave të krimit deri në fund të vitit 2030, që ndihmojnë profesionistët të ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit.			
MASA	AKTIVITETE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.3.1 Statistika të konsoliduara për viktimat e krimit, të mbledhura, përpunuara dhe publikuara sipas standardeve ndërkombëtare.	2.3.1.1 Rishikimi, përmirësimi i metodologjisë së mbledhjes, përpunimit dhe publikimit i të dhënave për viktimat dhe profilin e tyre.	INSTAT, MD, PP, DPPSH, DPB	KL Gj, NJVV	2025–2030
	2.3.1.2 Standardizimi i të dhënave zyrtare dhe pasurimi i tyre me të dhëna më të detajuara për viktimat dhe publikimi i tyre.	INSTAT, MD, PP, DPPSH, DPB		2027–2030
